



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 26 QERSHOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26. JUNA 2015. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Razmatranje Predlog-amandmana br. 24 u Ustavu Republike Kosova, predložen od Vlade Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër zoti Mustafa,
Zëvendëskryeministër, zoti Thaçi,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar ambasador,
Përfaqësues të organizatave joqeveritare,
Media të nderuara,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i propozim-amendamentit 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 144, paragrafi 1 të Kushtetutës, e ka propozuar amendamentin numër 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Amendamentin e propozuar, kryetari i Kuvendit ia ka adresuar Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse i njëjti pakëson ndonjë të drejtë dhe liri, të përcaktuara në Kapitullin 2 dhe 3 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se amendamenti numër 24 nuk i pakëson të drejtat dhe drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara në Kapitullin 2 dhe 3 të Kushtetutës.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar amendamentin numër 24 dhe ka propozuar për shqyrtim në seancë plenare.

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, që të marrë fjalën.

KREMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Përfaqësues diplomatikë dhe të mediave,

Në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, ju drejtohem me respekt sot për të paraqitur para jush propozimin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, obligim ky që derivon nga shkëmbimi i letrave ndërmjet presidentes së Republikës së Kosovës, zonjës Ahtifete Jahjaga, dhe përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri Baroneshës, Katri Eshton, i realizuar më 14 prill 2014.

Siç jeni në dijeni, ky shkëmbim letrash ishte ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, Ligji

numër 04/L-274, i datës 23 prill 2014, dhe i shpallur me dekreten e Presidentes së Republikës së Kosovës DL/022/2014, të datës 7 maj të vitit 2014.

Përballë kësaj situate, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte hartuar propozimin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të emërtuar si amendamenti numër 24 dhe me të njëjtin, në përputhje me procedurat, ia ka përcjellë Kuvendit të republikës së Kosovës për procedim të mëtutjeshëm.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 9 mars të vitit 2015, kishte referuar Gjykatën Kushtetuese propozime për vlerësimin e amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me qëllim që paraprakisht ta marrë opinionin lidhur me përshtatshmërinë kushtetuese të këtij amendamenti.

Gjykata Kushtetuese iu përgjigj kërkesës së Kuvendit më 15 prill 2015 me aktgjykimin 788/2015 dhe njëzëri kishte vendosur ta deklarojë të pranueshëm kërkesën e kryetarit të Kuvendit, dorëzuar më 9 mars 2015, për amendamentin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ka konfirmuar që amendamenti 24 nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara me Kapitullin 2 dhe 3 të Kushtetutës dhe me frymën e saj, siç është përcaktuar edhe në praktikën gjyqësore të kësaj gjykate.

Andaj, me qëllim të plotësimit të detyrimeve tona, edhe të brendshme, edhe ndërkombëtare, dhe duke qenë të bindur se formimi i dhomave të specializuara do t'i shërbejë forcimit të drejtësisë, duke qenë bindur po ashtu se Dhoma e Specializuar dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të merret me zbardhjen e dyshimeve për individë të caktuar për një periudhë të caktuar kohore dhe në asnjë rast pa vënë në sprovë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pastërtinë e kësaj lufte si tërësi, duke marrë parasysh se është konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese se ky amendament është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe nuk e cenon parimin e ndarjes së pushteteve, e në veçanti nuk e cenon sovranitetin e pushtetin gjyqësor, ju ftoj të gjithë juve që ta votoni amendamentin e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Në fakt, do të dëshiroja para se të vazhdojmë të procedojmë me materien, kemi në bazë të pranisë elektronike 110 deputetë në sallë, derisa prania fizike është 113, apo 114 deputetë. Kisha lutur deputetët të cilët nuk kanë kartelë të lajmërohen paraprakisht, në mënyrë që Administrata t'u bëjë kartelat t'i kenë këtu. Faleminderit!

E ftoj kryetaren e Komisionit për Legjislacion, deputeten Albulena Haxhiu, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Si kryetare e Komisionit për Legjislacion, refuzoj politikisht që ta lexoj një rekomandim politik të Komisionit për Legjislacion. Është thjesht e turpshme ajo se çfarë kanë bërë deputetët e pozitës në Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, pasi kryetarja e Komisionit për Legjislacion ka refuzuar, i nderuar zëvendëskryetar, zoti Armend Zemaj, e ke kërkuar fjalën. Zonja Selvije Halimi, si zëvendëskryetare e komisionit, për arsye se kemi qëndrim të komisionit, i cili ka qenë formalisht.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2015, e shqyrtoi amendamentin numër 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komisioni, pas debateve të ndryshme me qëndrime për dhe kundër, dhe shqetësimeve rreth këtij amendamenti, vendosi që amendamentin numër 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, t'ia procedojë për shqyrtim Kuvendit pa një rekomandim më tutje.

Si do që të jetë, me shumicë votash në Komisionin Parlamentar për Legjislacion është vendosur që amendamenti të përcillet në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani i ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Urdhëro Glauku, e dëshiron fjalën para se të procedojmë.

GLAUK KONJUFCA: Para se të hyjmë në trajtimin e kësaj teme, duam t'i themi disa fjalë.

Së pari, ju si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, që e keni për detyrë që të kujdeseni për ambientin se si zhvillohen punët në këtë institucion më të rëndësishëm për demokracinë e Kosovës, duhet të dilni me një deklaratë për tërheqjen e të gjitha forcave policore dhe Njesisë Speciale prej ambienteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Unë erdha në orën 8:00 të mëngjesit në këtë Kuvend dhe pashë së paku 15 apo 20 minibus të mbushur përplot me policë, me automjetet e Njesisë Speciale, të vendosur brenda ambienteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Shtrohet pyetja çfarë seance po mbajmë ne në Kosovën e lirë dhe demokratike?

E njëjta gjë pati ndodhur gjatë seancës për miratimin e marrëveshjes me Serbinë. Pse vetëm këto momente jepni urdhra politikë si Qeveri e Republikës së Kosovës për të zhvilluar seancë nën kërcënim dhe shantazh dhe frikë për deputetin e Republikës së Kosovës, i cili sipas Kushtetutës duhet të jetë i lirë dhe të vendosë sipas vullnetit të vet.

Ju si kryetar i Kuvendit duhet ta ndiqni shembullin e paraardhësit tuaj. Zoti Jakup Krasniqi pati bërë thirrje publike, e mbajmë në mend të gjithë, në seancën gjatë miratimit të marrëveshjes me Serbinë dhe i dha urdhër Policisë së Kosovës dhe njësive speciale që të tërhiqeshin nga ambientet e Kuvendit.

Një institucion i cili i thotë vetes tempulli i demokracisë, kur i mban punimet e veta nën masën kërcënuese të forcave të sigurisë, këtu ka vdekur dhe është varrosur vetë demokracia. Prandaj, po çuditë me të vërtetë dhe jam shumë i dëshpëruar që si kryetar nuk e morët fjalën dhe së pari ta rregulloni këtë gjë.

KRYETARI: Glauk, faleminderit! Ne bashkëbiseduam edhe më herët këtë çështje, e ngreha unë, realisht asnjë, kërkoj falje në qoftë se e them asnjë, polic në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është dhe nuk do të lejojmë në kuptimin që të ketë masa të shtuara.

Nën dy, ju e dini se ne nuk i urdhërojmë organet e Policisë, e kemi ministrin e Brendshëm këtu.

Nën tre, këtë vend dhe këta njerëz askush s'mund t'i mbrojë, veç popullit që i ka zgjedhur. Realisht, nuk kemi nevojë për asnjë masë sigurie, për arsye se këta policë që janë këtu janë njerëz të Kosovës, ata që mund të jenë jashtë janë njerëz të Kosovës, realisht nuk besoj se ka një situatë të rëndë, po thoni në oborr, por është ministri i Brendshëm, unë nuk mund të marr vendim, por në ndërtesën e Kuvendit nuk ka. Në ndërtesën e Kuvendit nuk ka, pos atyre që janë të zakonshëm, të cilët janë çdo herë. Kërkoj falje, por në qoftë se ka ndonjë ankesë që dikush është sjellë keq me deputetët, ja ku e kemi edhe ministrin e Brendshëm, të flasim lirisht. Urdhëro, Donikë!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,
Në vazhden e asaj çfarë tha edhe kolegu më herë, në vitin 1989, të gjithë ishim dëshmitarë të ndryshimeve kushtetuese të cilat u përcollën me një presion shtettrrethimi me tyta pushkëve e veprime si sot. Atëherë ka qenë regjim. Sot Kosova është shtet sovran i pavarur dhe demokratikë dhe ne kërkojmë që të na jepet shpjegim për çfarë këto ndryshime kushtetuese, të cilat po pretendoni të ndodhin sot, po i bënë nën trynininë e tytave të pushkës dhe në një shtettrrethim si Kuvend, si Prishtinë, si Kosovë. Kjo është krejt e padrejtë dhe është e paarsyeshme dhe kjo ka ndodhur në të kaluarën, u ka ndodhur qytetarëve të Kosovës, popullit shqiptar, nga një regjim. Ndërkaq sot ju po veproni pa asnjë dallim. Tërhiqini forcat, kërkon falje dhe shpjegoni për çfarë e keni bërë këtë shtettrrethim të Parlamentit të Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Faleminderit, Donikë! Edhe një herë të qartësoj. Valdete, a kam mundësi, pastaj e ke fjalën gjithsesi. Forca shtesë në Kuvend nuk ka, oborri është i menaxhuar nga Ministria, ta keni parasysh.

(Reagime nga salla)

O Ramush Haradinaj, oborrit nuk e udhëzoj unë, ja ku e keni ministrin e Brendshëm. Urdhëro, Valdete. Ramush, në qoftë se do të flasësh, urdhëro fol. Valdete, urdhëro, pastaj Ramush Haradinaj e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Kryetar, edhe pjesa e oborrit është pjesë e Kuvendit, kështu që ministri është këtu edhe duhet ta bëjë një thirrje publike që të largohen forcat e rendit, Njësia Speciale është jashtë, të nderuar kolegë deputetë, dhe ne kemi nevojë, si çdo herë që zhvillohen seancat normale, edhe kjo të mos dallojë nga seancat tjera. Kjo është dhunë psikologjike ndaj nesh, ose ju jeni duke bërë presion ndaj deputetëve tuaj. Pra, ndalini këto presione dhe bëni thirrje publike që të largohet Njësia Speciale.

KRYETARI: Ramush, urdhëro!

RAMUSH HARADINAJ: Në arritje sot në mëngjes, kemi parë disa kombibusë, kemi pa pjesëtarë të policisë, djem tanë, që thatë ju janë të Kosovë e dimë që janë të Kosovës, edhe ne jemi të Kosovës, pra s'kanë pse të na ruajnë pasi ata janë të Kosovës, ne të Kosovës, me pajisjet komplete sikur të nisen në luftë. Çfarë lypin në oborrin e Kuvendit? Pse unë duhet të vijë ardhur në Kuvend nëpër ta? Në rast se keni ndonjë problem ju, e frikoheni ose prej nesh, ose prej popullit, në rregull, por unë s'i kam kërkuar. Jam deputet, s'dua t'i shoh në oborr, janë djem tanë, sikur jemi edhe ne. Duhet të veproni në këtë drejtim. Por, nuk mund të thoni nuk janë. Dilni tash shihni përreth, plot keni, kombibusë, s'ke ku parkohesh prej tyre.

KRYETARI: Faleminderit! E thashë edhe një herë që në takim me kryetarët e grupeve parlamentare e kam ngrehur unë, janë të pranishëm kryetarët e grupeve parlamentare. Unë kisha kërkuar publikisht që në oborrin e Kuvendit të mos kemi forca, realisht nuk ka nevojë për asnjë forcë shtesë të policisë, për arsye se ne jemi të zgjedhur të këtij populli. Vazhdojmë!

Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Adem Grabovci, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeverisës,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jam shumë i vetëdijshëm se sot gjendemi para një sprove jashtëzakonisht të një vendimi tepër të rëndësishëm, për sotmen dhe të ardhmen e shtetit të Kosovës, të popullit të Kosovës. Pas shumë bisedave, analizave, konsultave të gjithanshme me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm të Partisë Demokratike të Kosovës, pas shumë takimeve edhe me miq e vërtetë të Kosovës, të popullit të Kosovës, të shtetit të Kosovës dhe lirisht mund të them me ata miq të cilët e kanë dhënë një kontribut të çmueshëm, të jashtëzakonshëm që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe sovranë, për mua dhe për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, për Partinë Demokratike të Kosovës, e ne nuk kemi hezitur për asnjë moment të vetëm për t'i paraqitur pakënaqësitë tona, argumentet tona, për të diskutua hapur me miqtë tanë, ashtu siç na takon si përfaqësues të popullit të Kosovës, për të shprehur pakënaqësinë tonë me një padrejtësi jashtëzakonisht të madhe që po i bëhet Kosovës, në rastin konkret, që po veçohet Kosova në këtë rast, por ne gjithsesi jemi të vetëdijshëm edhe para një sprove tjetër dhe një obligimi që, pa dëshirën tonë, pa dëshirën lirisht mund të them edhe të miqve tanë ka ndodhur dhe Kosova sot gjendet para këtij provimi të rëndësishëm.

Ne duhet ta kemi të gjithë para sysh se e kemi një raport të ashtuquajtur, apo të njohur si raporti i Dik Martit, që ka ngrehur pretendime absurde për ne, por që ka marrë mbështetjen nga një institucion ndërkombëtar - Këshilli i Evropës, që është caktuar edhe një prokuror nga një shtet mik, që së fundi është ardhur në përfundim se ne duhet ta pastrojmë vetveten nga ato pretendime.

Dhe, Partia Demokratike e Kosovës, personalisht si qytetar, si përfaqësues i popullit, në mënyrë absolute vlerësoj se ne nuk kemi nevojë të frikësohemi asnjëherë prej askujt dhe përkundrazi ne jemi ata të cilët jemi të thirrur që ta mbrojmë luftën tonë, t'i mbrojmë interesat e qytetarëve të Kosovës, ta mbrojmë shtetin e Kosovës dhe ta mbrojmë në mënyrë të argumentuar. Ne duhet të ballafaqohemi me pretendimet e kujtdo qofshin në mënyrë të argumentuar dhe ato pretendime t'i hedhim poshtë.

Prandaj, duke u mbështetur edhe në vendimin që nuk është vetëm ky debat që po zhvillohet sot, nuk është që po zhvillohet tash një muaj, por është edhe me vite t'u u diskutuar, unë po ju përkujtoj se për këtë çështje ka ndodhur një votim më 15 prill të vitit 2015, kur ky votim ka kaluar me 85 vota.

I kemi po ashtu edhe vendimet tjera, aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që konstaton se nuk cenohet interesat tona, nuk cenohet sovraniteti i shtetit tonë. Është e vërtetë apo s'është e vërtetë, e thua ti për veten tënde, unë e them atë çka unë mendoj, dhe unë besoj te miqtë se atë që ma kanë thënë deri më sot se do të ndodhë, ashtu edhe ka ndodhur, dhe me ta do ta vazhdojmë rrugën edhe më tutje për t'i hapur perspektivën vendit, për ta fuqizuar shtetin, për t'i fuqizuar institucionet e vendit.

Duke pasur parasysh që vendimi dhe qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës është i qartë publik, ne i kemi dhënë mbështetje këtij vendimi, edhe sot këtu, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i jep mbështetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar, në qoftë se mund të mos ndërhyjni, pastaj keni mundësi të gjithë të shprehëni. Melihate, të kemi mbetur borxh herën e kaluar, po e shoh që e ke tërhequr fjalën, dëshiron të flasësh, jashtë qëndrimit? Nuk e vërejtja. Ismet Beqiri e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kryetar i Kuvendit,

Duke marrë parasysh letërkëmbimin e presidentes Jahjaga dhe zonjës Eshton si dhe ratifikimin e të njëjtit dokument në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke pasur në konsideratë dhe duke marrë parasysh propozimet e dhëna nga Qeveria, përkatësisht vendimi i Gjykatës Kushtetuese se ky propozim i ndryshimit të këtij amendamenti në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është në harmoni me Kushtetutën dhe nuk i cenon liritë dhe të drejtat e njeriut, duke e analizuar gjithë situatën, rrethanat, dokumentet, konsultimet e vazhdueshme vërtetë disamujore në nivele të ndryshme, është e vërtetë edhe me ekspertë, edhe me, duhet thënë hapur përsëri me miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, së bashku me të gjithë ata që kanë luftuar, por edhe ata që s'kanë luftua edhe u kanë ndihmuar këtyre që të luftojnë, të jemi këtu ku jemi, duke i marrë parasysh po ashtu obligimet tona shtetërore dhe nivelin tonë të përgjegjësisë, duke qenë të bindur gjithmonë se zbulimi i së vërtetës asnjëherë nuk dëmton, e vërteta është shumë e qartë për të gjithë ne, se e kemi bërë një luftë të drejtë dhe se atë askush nuk mund ta njollojë, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës u japim mbështetje këtyre ndryshimeve, përkatësisht këtij amendamenti dhe do të votojmë për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, nga Lëvizja "Vetëvendosje", e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Këto 26 vjet më përpara, pikërisht në këto ambiente që suprimuar autonomia e Kosovës.

Sot, 26 vjet pas, po kërkohet nga ne një vendim për ta gjymtuar sovranitetin e Republikës së Kosovës. Situata e njëjtë, presioni dhe frika e trysnia e njëjtë, Isa Mustafa i njëjtë.

Qytetarë të nderuar të Republikës,

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Këta qeveritarë shpesh kanë ditur të na vendosin në situata të rënda, dhe ja tek ndodhemi sot përpara një momenti kritik e vendimtar për të ardhmen e vendit tonë. Nga ne po kërkohet që të krijohet një Gjykatë Speciale, e cila do t'i gjykojë ushtarët e UÇK-së për krimet e supozuara gjatë luftës në Kosovë.

Gjatë luftës në Kosovë ne ishim populli më i vuajtur e i përndjekur i Evropës, i shtypur e i masakruar.

E tërë bota demokratike po solidarizohet me golgotën shqiptare. Qytetarët e vendeve perëndimore i mbushnin sheshet nëpër demonstrata në shenjë përkrahje për popullin e Kosovës.

Dhe kjo çoi në mobilizimin e aleancës më të fuqishme ushtarake të botës për ta ndalur gjenocidin e Serbisë mbi shqiptarët.

Ne e krijuam një ushtri çlirimtare që bëri luftë të drejtë. Pas sa e sa dekadash, ne, më në fund, kishim shpresë, kishim vullnet të palëkundur, kishim krenari, kishim gatishmëri për ta dhënë jetën për atdheun. Mbi 2 500 dëshmorë e derdhën gjakun e tyre, e dhanë jetën për liri.

Më kujtohet si sot qershori i vitit 1999. Ne ishim populli me entuziazmin më të lartë në botë. Ne ishim feniksi që u ngrit prej hirit.

Mijëra ushtarë të UÇK-së marshonin me kokën lart nëpër qytetet tona, bashkë me 1 milion shqiptarë të dëbuar dhunshëm që po ktheheshin me lot gëzimi në Kosovën e çliruar.

Zoti kryeministër,

Zoti zëvendëskryeministër,

Kjo është më e vlefshmeja që mund ta ketë një komb. Kjo nuk krijohet bash lehtë. Duhet shekuj e shekuj të tërë për t'i krijuar këto themele. Ku mbetën këto vlera?

Ku u tretën këto shpresa dhe kjo krenari? Kush i shkatërroi? Pse na solli në këtë gjendje?

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mos e votoni Gjykatën Speciale!

Gjykata Speciale e përmbys realitetin historik. Nuk bëri gjenocid gjatë luftës populli shqiptar, por shteti serb. Serbia ishte agresori, ne u mbrojtëm. Po ne ishim nëpër shtëpitë tona kur u sulmuam.

Ne luftuam për çlirim, kurse Serbia luftoi për okupim. Ne luftuam për liri, Serbia luftoi për pushtim. Tash me Gjykatën Speciale të krijohet përshtypja se shqiptarët i paskan bërë krimet, ata paskan qenë agresori, ata duhet të gjykohen para të gjithëve.

Mos e votoni Gjykatën Speciale!

Gjykata Speciale e rrënon sovranitetin e sistemit tonë gjyqësor. Gjyqësia dhe integriteti i saj është shtyllë bazike e sovranitetit shtetëror. Gjykata Speciale e tkurr sovranitetin e Kosovës në 5 instanca - 3 nivelet e Gjyqësorit plus Avokati i Popullit të pavarur dhe një Gjykatë Kushtetuese, e cila është përmbi Gjykatën tonë Kushtetuese, e mirë e keqe, ajo që e kemi.

Kjo është një gjykatë selektive, kjo që po na krijohet, kjo Gjykata Speciale. Ajo nuk e trajton asnjë krim të Serbisë që ka ndodhur në Kosovë, merreni me mend.

274 masakra kanë ndodhur gjatë luftës së fundit në Kosovë. 550 varreza masive janë gjetur në Kosovë, 550 varreza masive me qytetarët tanë. Mbi 12 mijë qytetarë të vrarë e të masakruar e të pushkatuar. Mijëra femra të dhunuara.

Mbi 120 mijë prona e shtëpi të shkatërruara rrafsh me tokë. Dhe, asnjë nga këto që i përmenda nuk do të mund ta trajtonin Gjykatën Speciale. Kjo është e paprecedent në historinë e njerëzimit. Drejtësia është universale, e jo speciale.

Mbiemri 'speciale' e suspendon drejtësinë si të tillë. Drejtësia është e verbër. Ajo nuk privilegjon, as nuk përçmon krime. Drejtësia e pjesshme e suprimon vetë thelbin e drejtësisë.

Për drejtësinë nuk ka krime të rëndësishme, të cilat duhet të trajtohen, dhe krime të parëndësishme, të cilat nuk po bëka të trajtohen. Unë për vete nuk do ta votoj Gjykatën Speciale.

Sepse nuk do të kem fytyrë më t'i dal më kurrë përpara familjes Deliaj të Abrisë dhe mijëra e mijëra familjeve që i humbën të dashurit e tyre. Luljetë Deliajt, që ishte shtatzënë, ia çan barkun dhe e vranë. Diturie Deliaj e vogël gjashtë javë dhe u gjet e gjallë në krahun e nënës së masakruar. Por, vdiq një muaj më vonë për shkak të urisë dhe të sëmundjes. Antigona dhe Mihane Deliaj, që u dhunuan, e pastaj u masakruan.

Kjo është fotografia e Valmiri të vogël, është i masakruar prej forcave serbe dhe e ka të varur cuclën në qafë. Kjo fotografi e çoi botën në këmbë.

Çka t'u themi tash ne këtyre familjeve për gjakun e tyre të fëmijëve që qenka gjak i parëndësishëm, sipas Gjykatës Speciale. Nuk do të ketë drejtësi për këta njerëz. Në Gjykatën Speciale nuk ka drejtësi për këta njerëz.

Nëse e di që kjo gjykatë i përjashton më të dashurit tanë që i kemi humbur, si mund ta votoj unë këtë gjykatë?!

Mos e votoni Gjykatën Speciale, sepse të mos e votosh atë nuk do të thotë të jesh kundër drejtësisë.

Përkundrazi, ne edhe si opozitë edhe si deputetë të Kuvendit të Kosovës duhet të jemi për një gjykatë tjetër, domethënë nuk jemi kundër drejtësisë.

Ejani ta krijojmë një gjykatë tjetër. Çfarë gjykate tjetër? Një gjykatë e cila i trajton të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë dhe ne jemi plotësisht të gatshëm ta bëjmë këtë gjë. Le t'i renditim të gjitha krimet që ndodhën dhe le të gjykohen të gjitha, pa asnjë përjashtim.

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje”, edhe subjektet, të gjitha opozitare, mendoj që do të votonin për, do të votonin për një gjykatë e cila e trajton edhe rastin e Valmiri të vogël, po jo një Gjykatë Speciale e cila i trajton vetëm shqiptarët, sepse vetëm ata paskan bërë krime në Kosovë.

Por, mos e harroni një gjë, një gjykatë ku gjykohet vetëm Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk do ta votoja edhe po ta di që kjo do ta shkaktonte fundin e botës, tash po ta di që varet prej votës sime, që ka për t'i ardhur fundi botës, nuk mund ta jap atë votë, veç pse ka për t'u gjykuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Le të gjykohen të gjithë!

KRYETARI: Faleminderit! Ramush Haradinaj e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ambasadorë, qytetarë, media,

Para një kohe është menduar për ta gjetur një zgjidhje për raportin e zotit Marti. Ajo zgjidhje i është prezantuar Kosovës si një panel i veçantë, një dhomë e veçantë, me ligje të Kosovës, me rezidencë të veprimit në Kosovë, por edhe me mundësi që të operojë jashtë. Do të thotë, të ndodhur para presionit për ta gjetur një zgjidhje për këtë raport, për këto dyshime, për hetimet, si alternativë Kosovës i është ofruar një dhomë e veçantë me ligje të Kosovës, nga Kosova, por që ka të drejtë të operojë edhe jashtë, pra të shqyrtojë, të marrë në pyetje.

Ky është letërkëmbimi i Presidentes me zonjën Eshton. Kaq ka hyrë në obligime Kosova, nuk ka hyrë më shumë.

Në rast se flasim për obligimet e Kosovës, Kosova ka hyrë kaq në obligime. Pra, me ligje të Kosovës, një dhomë e veçantë, në Kosovë, që operon edhe jashtë. Nuk mund ta transformoni një obligim ndryshe. Kështu është prezantuar të paktën, ata që e kanë prezantuar aq sa e kanë ditur ta prezantojnë.

Çka jemi ka i ofrojmë sot Kosovës? Një monstrum ligjor. Pse është ky një monstrum?

E para, është një tip precedenti kjo gjykatë. Nuk po ndodh për ndonjërin nga republikat tjera të ish-Jugosllavisë. Nuk po ndodh për Serbinë dhe për asnjërin që ka qenë palë e luftimeve. Kijeni parasysh, pra - nuk po ndodh për asnjërin nga ato që kanë qenë palë e luftimeve.

Në fakt, Serbia e ka një gjykatë që i gjykon krimet e luftës dhe nuk e ka asnjë gjyqtarë të huaj. Një të tillë e kanë edhe palët tjera që kanë qenë në luftë dhe s'e kanë asnjë gjyqtar të huaj. E vetmja që ndodh janë vëzhguesit, profesionistët, zyrtarët ligjorë, që vëzhgojnë dhe raportojnë nëse është në bazë të ligjit. Po kjo ndodh edhe sot, e dini, i keni pa proceset. Kosova nuk e ka këtë trajtim, Kosovës po i thuhet 'jo'.

Një gjykatë e tillë për Kosovën, pa marrë parasysh qysh mundohen ta shpjegojnë, pa marrë parasysh nga çka nisemi ne, sa ia kem inat njëri-tjetrit edhe sa kem qejf ta shohim në ferr ndonjërin prej atyre që mund të jetë subjekt i saj, mos harroni se ferrin ia sjell Kosovës, e jo atyre njerëzve. Pse ia sjell ferrin? Për një kohë të gjatë, Kosova do ta bënë lajmin, jo të mediave kombëtare, por ndërkombëtare, të monstrumit të atyre që janë monstrum, të popullit, të njerëzve, të vendit, të shtetit, simboleve - monstrum. Gjithkund në botë Kosova do të trajtohet si monstrum.

Fëmija juaj, pa marrë parasysh të cilës parti jeni, nëse studiojnë diku, kur të prezantohet prej Kosove, të atij vendi monstrum, që po gjykohet për sende monstruoze që i ka bërë... Këtu jemi kah duam të hyjmë në rast se shkojmë në këtë drejtim. Nuk bëhet fjalë për individë, nuk bëhet fjalë për grupime, nuk bëhet fjalë për gjëra më të imëta, por jem kah hyjmë në një drejtim që do të jemi monstrum për më shumë se 10 vjet. Nuk e di nëse dikush e ka menduar këtë dimension ku po hyn Kosova.

Po thuhet që do të na ndihmojë në njohje, do të na ndihmojë në pozicioni ndërkombëtar, mos u habitni, se jo. Përkundrazi, qeveritë do ta kenë më vështirë të merren me këtë vend, në rast se pikërisht për këtë vend duhet krijuar një monstrum ligjor.

Zgjerimi i këtij monstrumi, duke shprehur mosbesim për cilindo nga institucionet ligjore të këtij vendi, a keni menduar çfarë domethënë për sovranitetin tonë? Çka po i ndodh Kosovës në afat të gjatë? Do të thotë Gjykata Kushtetuese nuk qenka e besueshme, kur ka vendosur kjo gjykatë që zotëriu që sot është kryeministër s'mund të shkojë përpara është respektuar, dhe të gjithë të tjerët e kanë respektuar, edhe miqtë ndërkombëtarë, por në këtë rast jo. As Ombudspersonit s'po i zihet besë në Kosovë.

Kolegë deputetë

Për bindjen time, sot është një ditë më ndryshe. Ne nuk i kemi thënë jo drejtësisë. Në rast se po flasim për pastrim, për ta hequr mjegullën, renë e zezë, se po i dëgjoj që po thonë është një re e zezë, mirë po retë e zeza nuk hiqen kur prej armiqve. Do të provojnë gjithnjë që t'i mbajnë përmbi, por duhet të dish çka po bën vetë. Re të zezë kemi hequr me OKB-në. Kur ka ardhur UNMIK-u në Kosovë janë qindra pjesëtarë të UÇK-së që janë trajtuar, janë mbajtur nëpër burgje për të bërat e për të pabërat. Unë jam dëshmitar që një herë e kam dërguar vëllain tim para një polici e gjykate. Për t'u pastruar, për ligj. Kur ka ardhur Tribunali Ndërkombëtar i Hagës na kanë thënë 'ju s'keni qenë palë bash e madhe në luftë, jeni viktimë, por më mirë të pastroheni' dhe jemi pastruar nëpërmjet Hagës. Ka ardhur EULEX-i. Kolegë këtu, e dini për pastrim. Sa na pastroi EULEX-i, në rast se na ka pastruar? Të vetmit shqiptarët, e vetmja Kosova, mbajeni në mend këtë që po e flasim, u dashka të kalojë edhe në të katërtën. E katërta është kjo që po hyjmë në të për pastrim. Aq të fëlliqtë qenkemi ne që po na u dashka edhe një rend i pastrimit? Aq shumë krime paskan bërë shqiptari e Kosova? Ndaluni pak, e mendoni një grim çfarë jemi duke bërë! Kush garanton që s'do të jetë edhe e peseta ndonjëherë, se jemi kah i mësojmë kështu.

Por, po dua të ju flas edhe për një dimension tjetër. Ne të gjithë jemi njerëz, të gjithë frikohemi nga pak për vete. Kush i garanton qytetarit të Kosovës, që kushdo që është vendimmarrës, nga frika e kësaj gjykate nuk do t'i bëjë dëme këtij vendi? Shumë lehtë është për t'i kontrolluar njerëzit atëherë. 'Shiko, nuk po të futim në listë, por dëgjona kah po shkojmë!'. Ato dëme s'do

t'i përjetojë veç i PDK-së, veç i LDK-së, veç i VV-së, por edhe ata që s'kanë parti. Do ta dërgojmë vendin gabim, do t'i bëjmë njerëzit tanë më të ndjeshëm, më të rrezikuar, më të dobët. Në vend që t'i forcojmë disa njerëz, t'u themi 'mos lësho pe, se e ke popullin prapa, jemi me ty', ne po i bëjmë edhe më të dobët sesa i kemi sot. Do t'i kemi për shkak të dosjeve të korrupsionit që i kanë 70 dosje në Komunë e i mbajnë, disa i bëjmë të dobët për shkak të dosjeve të caktuara që thonë 'supozova që ka ndodhur në luftë'. Çka po i bëjmë ne vetes në këtë mënyrë?

Po kthehem ku e fillova. Ne jemi për ligj, ne jemi për t'i shqyrtuar të gjitha dyshimet. Ne nuk kemi asgjë kundër hetimeve që kanë ndodhur, e që mund të ndodhin në të ardhmen dhe duam t'i ballafaqojmë krejt ata që kanë kryer çka do që i kanë krye kundër kujt do qoftë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, por nuk mund të vazhdojmë të jemi monstrum. Duhet të ndodhë në Kosovë, me ligj të Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të ishte dashur sot t'i ndalë këto amendamente, t'i marrë prapa, ta bëjë një ofertë për bashkësinë ndërkombëtare, të thotë 'urdhëroni, gjykatën do ta bëjmë në Kosovë, duam ta bëjmë vetë, edhe ndonjë ekspertë po ta sillni s'kemi gjë kundër, gjyqtarë, prokurorë, duam ta bëjmë në bazë të ligjeve, me procedura të rregullta t'i shqyrtojmë të gjitha krimet e supozuara'. A e dini që ende sot e kësaj dite ne shkojmë deri në Merdar për të pritur eshtra.

Si rezultat i kësaj, Aleanca nuk e voton këtë gjykatë, u bënë thirrje deputetëve të mos e votoni, pra nuk duhet votuar këtë gjykatë. Kjo nuk është që u themi miqve jo, lini këto deklarime. Kurrë shqiptari s'i ka thënë mikut jo, nuk e ka në traditë t'i thotë mikut jo. Shqiptari është mik për mik. Ne po u ndihmojmë miqve për ta gjetur një zgjidhje për plot probleme që i kemi si vend, e jo në mënyrë selektive.

Ne kemi probleme me ligjin, kemi probleme me Gjyqësorin, por jo në mënyrë selektive.

Njëkohësisht, qytetarët që protestojnë për këtë temë, mos harroni se ndoshta një pjesë e madhe e tyre e krahasojnë ndjenjën që e kanë sot me ndjenjën që e kanë pasur para '99-tës.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lista Serbe nuk e ka kërkuar fjalën askush. A dëshiron të prononcohet dikush? Jo! Valdete Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Para se ta marrë fjalën, e kam edhe një lutje kryetar, kryeministër, ministër.

Ashtu siç keni dhënë urdhër që sot të jetë Njësia Speciale në Kuvend dhe jashtë Kuvendit, a bëni thirrje prapë dhe jepni urdhër që sa më parë të largohen, se edhe në këto momente janë ende jashtë.

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Adresimin tim lidhur me një temë kaq të rëndësishme dhe kaq të ndjeshme për gjithë popullin tonë, siç është tema e krijimit të Gjykatës Speciale, do ta filloj duke u ndalur te bazamenti i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, periudha e luftës çlirimtare të viteve '98-'99. Në mënyrë të veçantë, tek intervenimi i botës perëndimore në mbështetjen e vlerave të civilizimit botëror në Kosovë, të cilat ishin të rrezikuara nga agresori i Serbisë dhe i Milosheviqit.

Sot dua ta parafrazoj ish-sekretaren amerikane të Shtetit, zonjën Ollbrajt, e cila, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes amerikane për çlirimin e Kosovës në vitin '99, pati thënë: “Kundërshtimi i pastrimit etnik në Kosovë dhe kudo tjetër në botë është në qendër të vlerave tona. Me intervenimin në Kosovë ne po i afirmojmë qëllimet qenësore të NATO-s si mbrojtëse e demokracisë, stabilitetit dhe mirësjelljes njerëzore në tokën evropiane”.

Pra, në vitet '98-'99, Kosova ishte në qendër të vëmendjes dhe mbështetjes së demokracive më të fuqishme të botës perëndimore dhe pikërisht kjo po ndodh për shkak të sakrificës dhe luftës çlirimtare të popullit të Kosovës dhe orientimit tonë të drejtë pro vlerave të civilizimit perëndimor.

Të nderuar qytetarë,

Ndërsa, tani 16 vjet pas luftës çlirimtare të ushtrisë sonë dhe bombardimeve të NATO-s dhe ë 7 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ky Kuvend, ju kolegë deputetë gjendeni para një sfide të rëndë historike, politike dhe legale, para themelimit të Gjykatës Speciale, një gjykatë e cila do të jetë selektive, një gjykatë e cila do t'i gjykojë vetëm shqiptarët dhe e cila e ka paragjykuar luftën çlirimtare tonë.

Duhet theksuar se që nga viti 2000 të gjithë jemi dëshmitarë të shumë proceseve gjyqësore kundër luftëtarëve të UÇK-së, të gjykuar fillimisht nga UNMIK-u dhe EULEX-i, të gjykimeve të tjera të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, ku komandantët tanë, si zoti Limaj dhe Haradinaj, e dëshmuar drejtësinë dhe pastërtinë e luftës çlirimtare, në të cilën ju po thirrreni, se kemi njolla në luftën tonë.

Dhe, tani, përsëri temë kryesore që synohet ta determinojë imazhin ndërkombëtar të Kosovës tentohet të jetë gjykimi i luftëtarëve të UÇK-së, kësaj radhe nëpërmjet një gjykate të re speciale, e cila e cenon rëndë rendin juridik dhe sovranitetin e vendit. Siç e theksova edhe më herët, të gjithë luftëtarët e UÇK-së gjithmonë kanë qenë të gatshëm dhe i janë përgjigjur çdo procesi gjyqësor kundër tyre dhe patjetër që sot dhe gjithmonë do të jenë të gatshëm t'i dalin zot mbrojtjes, sakrificës dhe luftës sonë, e të përgjigjemi para drejtësisë për të gjitha veprat tona, por unë dhe të gjithë ju, të nderuar kolegë deputetë, jam e bindur se duhet të jemi kundër çdo instrumenti juridik dhe politik të veçantë e special, që synon cenimin e rëndë të shtetësisë së Kosovës, që synon drejtësi selektive kundër shqiptarëve, që tenton barazimin e luftës tonë çlirimtare me agresorin e masakrave, pra me agresorin serb.

Një gjykim 'sui generis'. Jemi mësuar ta dëgjojmë këtë fjalë për Kosovën që nuk e themelojnë as Serbia, që madje ishte agresori në gjithë ish-Jugosllavinë, e që nuk e themeloi as Bosnja, as Kroacia si viktima të atij agresioni. Kosova që nga 17 shkurti 2008 është shtet i pavarur dhe sovran. Kosova e ka Kushtetutën e vet, i ka ligjet e veta, në bazë të të cilave mund të bëhen hetime dhe të mbahen procese gjyqësore për të gjitha çështjet që mund të ngrihen. Jemi të vetëdijshëm për vështirësitë dhe dështimet e sistemit kosovar të drejtësisë dhe për këtë dihet botërisht se përgjegjës janë sa vendorët, ashtu edhe ndërkombëtarët.

Por, në asnjë mënyrë nuk është zgjidhje që për dështimet e sistemit kosovar të drejtësisë tani të themelohet Gjykata e re Speciale jashtë juridiksionit të Republikës së Kosovës. Zgjidhje është funksionalizimi i këtij sistemi dhe assesi krijimi i një sistemi që e prek shtetësinë Kosovës. Për

këtë arsye, ne duhet të jemi të gatshëm si Kuvend dhe si institucione të Kosovës t'i japim mbështetjen e duhur dhe të dëshmojmë vullnetin politik të sistemit kosovar të drejtësisë, të funksionojë në baza të standardeve evropiane, me gjyqtarë dhe prokurorë të pakorruptuar, të pashantazhuar.

Ne kemi përgjegjësi ta bëjmë këtë sa më parë dhe sa më shpejt, e jo një Gjykatë Speciale. E jo për shkak të shantazhit kundër dikujt prej njerëzve në këtë sallë, e i çfarëdo meritave politike e historike të jetë ai, të cenohet rendi juridik dhe politik i Kosovës, të cenohet ligjshmëria e pavarësisë së Kosovës, e dëshmuar edhe me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Themelimi i Gjykatës Speciale për Kosovën po na servohet për diskutim në këtë Kuvend për shkak të paaftësive të njerëzve që kanë udhëhequr dhe po vazhdojnë ta udhëheqin Qeverinë e Kosovës për t'i ndërtuar kapacitetet e duhura për afirmimin dhe mbrojtjen e vlerave më kulmore të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Një Kosovë e çliruar me partneritet më të fuqishëm kosovar me botën ndërkombëtare demokratike, e cila shpalli pavarësinë e bazuar në këtë partneritet me Perëndimin gjithnjë, me një pavarësi të konfirmuar ligjërisht nga instancat më të larta të drejtësisë botërore, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, të bëhet temë botërore e gjykimeve tash në mënyrë speciale vetëm për shkak të një qeverisjeje të keqe, të dobët dhe të shantazhuar, për shkak të njerëzve që për të ruajtur vetveten e tyre janë të gatshëm ta lëndojnë, ta cenojnë madje dhe ta shesin Kosovën, këtë, të nderuar deputetë, nuk duhet ta lejojmë në asnjë mënyrë dhe me asnjë çmim, përndryshe do të na dënojë historia.

Dua të them se deri në këtë gjendje kemi ardhur për disa arsye që do t'i theksoj në vijim. Me një Ministri të Punëve të Jashtme, të udhëhequr më parë nga zoti Hoxhaj, një politikë konjunktive, servile dhe pa guxim intelektual, i cili nuk e ka ndërtuar asnjë strategji se si ta shfrytëzojë vendimin e GJND-së në favor të Kosovës dhe për ta afirmuar dhe për ta mbrojtur Kosovën në arenën ndërkombëtare, nuk ka dashur dhe nuk ka ditur se si kjo ministri ta ndërtojë strategjinë për ta diskredituar botërisht raportin e Dik Martit kundër Kosovës, kemi arritur në këtë gjendje të mjerë ku dikush tenton që ta vendosë në pozitë të barabartë me agresorin serb. Me një Ministri të Drejtësisë, të udhëhequr si nga Qeveria e kaluar, edhe e tanishme nga zoti Kuçi, që vetëm improvizon si shefi i vet, duke theksuar se kinse Instituti për Hulumtime të Krimeve të Luftës, i cili nuk jep asnjë rezultat konkret për ta dënuar gjenocidin serb në Kosovë, tani gjendemi në këtë pozitë, për shkak të paaftësisë së njerëzve të kësaj kategorie më të ulët njerëzore dhe intelektuale. Sot pas 16 vjetëve ende nuk është gjykuar masakra e Dubravës dhe të gjitha masakrat, të cilat i theksoi edhe Glauku.

Për të dalë nga kjo gjendje ka një zgjidhje. Ne duhet t'i funksionalizojmë gjykatat vendore kredibile me gjyqtarë dhe prokurorë kredibilë, profesionalë dhe të pastër, e të pashantazhuar. Të dëshmojmë përkushtimin tonë jetik për drejtësi, për funksionimin e shtetit ligjor dhe demokratik. Vetëm kështu mund të integrohemi në Bashkimin Evropian dhe të jemi miq të partnerëve të vërtetë të SHBA-ve, por me këtë qeverisje të dobët dhe të keqe, kjo nuk mund të arrihet, prandaj

duhet ndryshuar qeverisjen, e jo për shkak të qeverisjes së keqe të themelohen institucione të reja gjyqësore jashtë juridiksionit të shtetit tonë, që synojnë drejtësi selektive.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Forcimi i shtetit të Kosovës dhe i sistemit tonë të drejtësisë bëhet me reformë strukturore dhe substanciale, që duhet të fillojë në Kosovë. Nuk mund të forcohet Kosova duke ia vënë një barrë të re për shkak të udhëheqjes së saj të dështuar. Me mosvotimin e themelimit të Gjykatës Speciale, të nderuar kolegë, ne i hapim rrugë funksionalizimit të sistemit kosovar të drejtësisë, me mbështetjen ndërkombëtare. Ne duhet të ndërtojmë shtet funksional me institucione funksionale, e jo të improvizojmë.

Mjaft më me improvizime. Kosova nuk është lodër e askujt, me të cilën mund të eksperimentojë kush të dojë. Ky është mesazh që duhet ta dërgojë ky Kuvend, shteti ynë, një storie e përbashkët kosovare ndërkombëtare, është çliruar dhe pavarësuar në partneritet me SHBA-në dhe BE-në, prandaj ky investim i përbashkët për shtetin e Kosovës nuk duhet të lejohet me cenimin e themelimit të Gjykatës Speciale. Nuk duhet të kthehemi prapa, ngase kemi bërë shumë sakrifica për ta ndërtuar shtetin tonë, kemi derdhur shumë gjak, që sot ta gëzojmë këtë liri dhe ne të jemi këtu dhe të flasim për një Gjykatë Speciale është shumë e rëndë.

Po e përsëris, nëse është problematike qeverisja e korrumpuar dhe e shantazhuar, atëherë duhet të pësojnë ata njerëz, e jo të pësojë Kosova dhe qytetarët e saj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të kisha lutur, tash e pas asnjëherë mos ia ndalo askujt fjalën!

VALDETE BAJRAMI: Me këtë vizion ne e ruajmë dhe e forcojmë partneritetin e kosovarëve me të gjithë aleatët tanë, i ruajmë vlerat dhe qëllimet qenësore të qytetërimit perëndimor, mbrojtjen e lirisë, demokracisë, sundimit të barabartë të rendit dhe ligjit.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj sot t'i thoni 'jo' Gjykatës Speciale, jo gjykatës selektive, jo një gjykatë për shqiptarët. Të ketë gjykatë për të gjithë ata njerëz, të cilët kanë kryer krime, për të gjithë ata njerëz të cilët sot në njëfarë mënyre janë diku dhe na shikojnë ne duke diskutuar, jo të bëhet një gjykatë në cungim të shtetit dhe në cungim të sovranitetit të vendit tonë.

Andaj, "Nisma" nuk e përkrah dhe nuk do ta votojë këtë gjykatë dhe ju bëj thirrje edhe ju të mos e votoni.

KRYETARI: Faleminderit! Nga "6+" e dëshiron fjalën dikush? Jo! Atëherë, jemi te deputetët sipas radhës së paraqitjes dhe sipas partive politike, do të bëj kombinime. Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës dhe ministri i Punëve të Jashtme, zoti Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Veseli,

I nderuar kryeministër Mustafa,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar të gjithë ju mysafirë të pranishëm,
Ne sot jemi mbledhur për ta përfunduar një proces jo të lehtë, jo aq të dashur të themelimit të dhomave të posaçme në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës, që do të përfundonin njëherë e përgjithmonë akuzat nga raporti i Dik Martit.

Sot institucionet e Kosovës, shteti i Kosovës është para dy mundësive: një që ta themelojë vetë këtë gjykatë bashkërisht me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kjo çështje të përmbyllet njëherë e përgjithmonë në një periudhë të caktuar kohore 3 apo 5 vjet, apo në rast dështimi kjo çështje të shkojë në Këshillin e Sigurimit dhe kjo çështje të zgjasë 15 apo 20 vjet, e ngrehur prej oponentëve të pavarësisë së Kosovës.

Por, dëshiroj të theksoj se për të pastruar luftën tonë dhe për të dëshmuar se ne nuk kemi asgjë që të fshehim dhe për ta ruajtur aleancën historike dhe strategjike me partnerët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, NATO-në, ne duhet ta themelojmë këtë institucion të pavarur dhe ndërkombëtar. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që ndryshimet e Kushtetutës që mundësojnë themelimin e dhomave të posaçme do të jenë të vendosura në një shtet të tretë evropian. Pra, këto ndryshime janë konform Kushtetutës dhe Kuvendi i Kosovës sot duhet të votojë, pra ftohet që të votojë.

Jemi të vetëdijshëm se Serbia ka vrarë mbi 12 mijë qytetarë në Republikën e Kosovës, se ushtarët, policët, paramilitarët serbë kanë dhunuar rreth 20 mijë gra në Kosovë, se Serbia, shteti i Serbisë, ka larguar me dhunë dëbuar mbi 1 milion qytetarë nga Kosova në vitet '98-'99. Kosova ka ende 1 600 të zhdukur nga konflikti, shumica janë shqiptarë, por ka edhe serbë dhe minoritarë të tjerë. Ky numër është tragjik, por është 150 herë më i vogël se numri i viktimave në konfliktin e Sirisë, që çdo ditë po han viktima, prandaj jemi falënderues që bashkësia ndërkombëtare ka gjetur mjete të caktuara, 300 milionë euro, për t'i shpenzuar në dhomat e posaçme dhe për t'i hulumtuar rastet e dyshimit nga konflikti i Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Kabinet qeveritar,
E gjithë kjo po ndodh pas gjykimeve të gjyqeve të UNMIK-ut, pas gjykimit nga Tribunali i Hagës, pas gjykimeve nga EULEX-i dhe gjykatat lokale. Kjo është hera e pestë që po hulumtohet në rastet e krimeve të luftës nga individë në ish-Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

I nderuar kryetar Veseli,
I nderuar kryeministër Mustafa,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Disa nga ju këtu, por edhe publiku kosovar mund të pyesë se pse ka nevojë bashkësia ndërkombëtare të shpenzojë rreth 300 milionë euro për t'i hulumtuar disa raste individuale të krimeve të luftës në Kosovë? Më duhet të them se nevojë jona është që të pastrohemi nga ky

etiketim i panevojshëm dhe i padrejtë për emrin e luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që u përkrah nga e mbarë bota.

Ne e dimë që në të gjitha luftërat ka pasur edhe lëshime, ka pasur edhe krime. Prandaj, është me rëndësi, po ju them këtu se Republika e Kosovës dhe unë personalisht kurrë nuk do të lejojnë që dhomat e posaçme të krijuara për dyshimet e raportit të Dik Martit të përdoren për ta ridizajnuar historinë tonë. Prandaj, kot tentojnë disa ta përdorin këtë si instrument për ta ndryshuar historinë e luftërave në Ballkan dhe të gjithë janë të vetëdijshëm, dhe të gjithë e dinë se këto luftëra janë shkaktuar drejtpërdrejt nga Serbia.

Prandaj, Kosova duhet që të lirohet nga kjo të them “legjendë e zezë”, e krijuar padrejtësisht për ta dëmtuar imazhin e shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Askush në Ballkan, por as më gjerë, nuk do ta harrojë terrorin dhe gjenocidin e ushtruar nga Slobodan Milosheviqi dhe përkrahësit e shtetit të tij. Askush në Ballkan, por as në botë nuk do të harrojë se në Srebrenicë është kryer gjenocid nga forcat serbe. Askush nuk do të harrojë as verdiktin e Tribunalit të Hagës kundër lidershit të Serbisë që ka konstatuar pa mëdyshje që Qeveria Serbe është fajtores kryesore në luftën e Kosovës për pastrime etnike në baza raciste dhe për qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe.

Ju ftoj që ta lexoni verdiktin e Tribunalit të Hagës, të krijuar nga Kombet e Bashkuara kundër lidershit serb për ta kuptuar se sa e thellë dhe sa e keqe ka qenë Qeveria e Serbisë ndaj Kosovës gjatë një shekulli të tërë okupimi.

Të nderuar deputetë,

Pajtimi dhe stabiliteti nuk do të ruhen duke e harruar të kaluarën, e kemi bërë që gjeneratat e reja të të gjitha komuniteteve që të mos harrojnë të kaluarën, as të mos e harrojnë arsyen e agresionit. As ne në Ballkan nuk duhet harruar, ngase nacionalizmi i tipit të Slobodan Milosheviqit mund të kthehet, prandaj tash e disa vite kemi punuar për të dokumentuar krime dhe viktimat e luftës në Kosovë dhe shumë shpejt kosovarët, institucionet kosovare do të kërkojnë drejtësi në gjykata ndërkombëtare për tentativën e gjenocidit të shtetit serb në Kosovë. Do të kërkojmë edhe reparacionet e luftës dhe kjo kërkesë nuk i drejtohet Qeverisë së Serbisë, por i drejtohet historisë që kurrë të mos harrohet ajo çfarë ka ndodhur në Kosovë.

Më lejoni të përfundoj, me një thirrje që Kuvendi sot t’i votojë amendamentet dhe Ligjin për dhomat e veçanta, ashtu që të shkojmë përpara në mbrojtje të historisë sonë, në afirmim të vlerave tona, në mbrojtje të së vërtetës, në mbrojtje të luftës çlirimtare. Fëmijët tanë duhet të krenohen me të arriturat më sublime në historinë moderne shqiptare, që është lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e Kosovës, vlera më sublime në historinë e kombit shqiptar.

Të nderuar deputetë,

Prandaj, nuk duhet të ketë çmim apo sakrificë që duhet ta vonojë apo ta bllokojë përparimin dhe integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, në NATO dhe thellimin e partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve,

Në fakt, unë ndjeva një nevojë edhe morale, por edhe politike t'i jap disa sqarime si protagonistja e vetme nga ky Kuvend i Kosovës e periudhës së vitit 1989 kur janë bërë ndryshimet kushtetuese dhe meqë u bë këtu njëlloj paralelizmi këtu, i cili absolutisht nuk shkon dhe është mirë të sqarohet. Është mirë ta dinë qytetarët e Kosovës, që të merret nga njerëz këtu me mashtrime dhe me spekulime.

Unë absolutisht jam për atë që nuk ka asnjë nevojë që ta kemi këtu asnjë forcë, as policore, as tjera, nuk kemi asnjë arsye që të ketë. Nëse Policia e Kosovës ka vendos që ta bëjë sigurinë e ta vlerësojë si çështje të sigurisë, jo ka protesta, jo s'ka, nuk e di, ajo është çështje tjetër, por të mos bëjmë paralelizma. Këtu u bë përpjeke për të bërë paralelizëm në substancë, jo në formë.

Në vitin '89, në ndryshime kushtetuese është suprimuar statusi i Kosovës. Me këtë çka po e bëjmë sot, nuk po e suprimojmë pavarësinë e Kosovës. Nëse sot do të shtrohej këtu për ta suprimuar pavarësinë e Kosovës, edhe të ngrihem ne të bëhemi me Serbinë, atëherë ndoshta mund ta bëjmë një barazim, por ju lutem mos spekuloni. Ju lutem shumë, mos spekuloni! Më falni, lini përrallat, lini pallavrat! Cili sovranitet? Po flitni ju për sovranitetin! Më fal, ti po flet për sovranitetin, për shtetin, të cilin ti nuk e njeh, njësoj si Serbia. Pra më fal! Lini këto përralla!

Këtu nuk ka heqje dorë nga pavarësia. Nëse dikush është i disponuar të heqë dorë nga pavarësia dhe të bëhet me Serbinë, atëherë është muhabet tjetër. Me Serbinë nuk po duam të bëhemi dhe po më vjen shumë keq se jeni jashtë orbitës së realitetit në Kosovë.

Pasi veç dola, po dua t'i them edhe dy fjalë, se unë desha ta bëj këtë sqarim: mos spekuloni me ato çështje! Jam e vetmja protagoniste këtu që kam qenë direkt në atë periudhë kohore. E di shumë mirë çka ka ndodhur, e di shumë mirë sot çka po ndodh. Pasi dola, po e them edhe një fjalë: sot është vendimi, doni Lindje apo doni Perëndim? Sot është vendimi, doni drejtësi, apo doni krim, qoftë edhe të supozuar.

Jam e bindur që qytetarët e Kosovës, shumica dërrmuese, janë me Perëndimin dhe janë me drejtësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Aida Dërguti. S'qenka këtu. Atëherë Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qytetarë të nderuar të po kësaj Republike,

U theksua këtu disa herë që në hapësirën e Kuvendit dhe kjo po e përsëris tash edhe në mikrofon, është përgjegjësi ekskluzive e kryetarit të Kuvendit, i kemi Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës, të cilat kanë ardhur këtu, jo pse e kanë vendin këtu, por për shkak se janë thirrur që të vijnë këtu. E, tash unë e kam një pyetje shumë të thjeshtë: çfarë bëjnë këta policë këtu? Pra, pse kanë ardhur këtu? A kanë ardhur t'i mbrojnë deputetët nga vetvetja, apo kanë ardhur t'i mbrojnë deputetët nga protesta, që i bie ta mbrojnë Kuvendin nga protesta.

Por, tash edhe një pyetje tjetër del këtu, e kjo natyrisht u drejtohet vetëm disa prej personave që janë tashmë në sallë, sepse ata që po protestojnë aty janë ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës dhe tani a s'më thoni deputetë nëse paska ardhur puna deri këtu sa këto institucione të Republikës së Kosovës po vepruakan në kundërshtim me vullnetin e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Pra, kaq keq është puna?!” Apo, a s'më thoni Kadri Veseli e Hashim Thaçi, që thoni që keni dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që paska nevojë tash Policia t'u mbrojtë nga ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse kështu po i bie. Pra, kënd po e mbron kjo Polici. Për Isa Mustafën nuk po flas. U dëshmuua që këtë duhet mbrojtur edhe nga anëtarësia e vet. E kemi pa në Kuvendin që duhej ndalë me policë anëtarët për të hyrë në Kuvend.

Sepse, ky amendament kushtetues që e kemi tash përpara, që e ka sjellë natyrisht kjo Qeveri, e përmbytur të tërë sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Përmbajtja e këtij amendamenti, për ata që e kanë lexuar, është në kundërshtim të plotë me karakterin, por edhe me subjektivitetin e Republikës së Kosovës. Në Kushtetutën tonë parashikohet organizimi i sistemit gjyqësor, dhe kjo zonë e Kushtetutës është nga të paktat që ka mbetur deri tash pa u rrënuar në vendin tonë. Mos më keqkuptoni, nuk është e paprekur, është ende e parrënuar.

Në paragrafin e parë të këtij amendamenti të pretenduar flitet për obligimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës kundrejt raportit të Asamblesë së Përgjithshme Parlamentare të Këshillit të Evropës, që daton më 7 janar 2011. Nuk ekziston, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, asnjë obligim ndërkombëtar i këtij lloji për një shtet të shpallur e sovran. Këso tekstesh u shkruhen vetëm protektorateve ndërkombëtare, ku sovraniteti ndahet ndërmjet vendësve dhe zotëve. Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës. Qindra rezoluta të Këshillit të Evropës kanë dalë si rezultat i një shumice të atij aktualiteti kur janë votuar. Respektimi ose pajtimi me to varet kryekëput nga vullneti dhe gjykimi i brendshëm i një shteti të pavarur dhe i një shteti sovran, edhe kur është anëtar, e lëre më kur nuk është anëtarë fare, siç është rasti me Kosovën.

Në një premisë të rreme, pra obligimi ndërkombëtar, po tentohet të krijohet baza kushtetuese për ta themeluar një organizëm paralel të gjyqësisë. Praktikisht, teksti i të ashtuquajturit amendament na thotë: “Ju nuk jeni të denjë për të qenë shtet sovran”. Përveç rrënimit të brendshëm të sistemit tonë, edhe në raport të së drejtës ndërkombëtare, ky lloj i kërkesës për këtë lloj gjykate është jashtë çdo rendi të pranuar nga ku buron e drejta dhe marrëveshjet e këtij lloji. Kjo edhe në planin e të drejtës ndërkombëtare publike, por edhe të asaj penale. Sipas paragrafit 4, dhomat dhe zyrat e prokurorit japin kompetenca për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare në emër të Kosovës.

Praktikisht, kjo e rrënon sovranitetin e jashtëm që është themeltar, sidomos për rastin e Republikës sonë. Kjo dispozitë e përjashton organin kryesor më të rëndësishmin, Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili si rregull ka për kompetencë kontrollin e sovranitetit të jashtëm. Me përjashtimin e nenit 18 të Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës është përjashtuar nga ratifikimi apo dhënia e instrumentit të brendshëm për lidhjen e këtyre marrëveshjeve me karakter ndërkombëtar. Kështu, ky Kuvend, si emri dhe realiteti i këtij sovraniteti që buron nga përfaqësimi i vullnetit të popullit, e humb një pjesë të pushtetit kushtetues në raport me marrëdhëniet që do të krijohen si pasojë e kompetencës që organet e Gjykatës Speciale kërkojnë të kenë në rrafshin ndërkombëtar.

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Kuvendi i Republikës nënkupton gatishmërinë ose jo të qytetarëve të asaj republike. Si ta dyfishosh këtë kompetencë të Kuvendit, e ke dyfishuar popullimin e Republikës sonë. Cilët qenkan këta qytetarë të tjerë të specializuar që do të kenë të drejtë të lidhin marrëveshje ndërkombëtare në emrin tonë? Gjyqtarët dhe prokurorët të Gjykatës Speciale, të cilët emërohen nga shefi i EULEX-it, pra këta janë ata?! Këta qenkan qytetarë më të denjë se të gjithë ne dhe se çdo qytetar që voton në këtë vend për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare për çështje kaq të rëndësishme, siç janë pretendimet për krimet në vendin tonë.

Ky amendament dhe ju që do ta votoni atë amendament, e thoni pikërisht këtë. Ky i ashtuquajtur amendament, i cili është sjellë këtu nga Hashim Thaçi, Isa Mustafa e Kadri Veseli, i redukton drejt zeros të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin 2 të Kushtetutës së Republikës sonë. Këto liri nuk janë abstrakte. Ato garantojnë që ne si popull i Kosovës jemi të barabartë ndërmjet popujve tjerë dhe kemi mundësi e aftësi të jemi të organizuar më vete sipas rregullave tona, pa na ndërhyrë askush dhe pa kërkuar leje nga ata.

Ky ndryshim i Kushtetutës për Gjykatën Speciale e kthen Kosovën në një hamendje të themelimit. Në vend se ta amendamentoni Kushtetutën për ta vënë në krye të saj luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të drejtën për referendum, ju po na kërkon që edhe këto pak të drejta që i kemi fituar me kaq shumë mund dhe sakrificë t'i dorëzojmë, pra të heqim dorë nga ato.

Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Amendamenti për Gjykatën Speciale i shkatërron këto: përkufizimin e shtetit, barazinë para ligjit, gëzimin e të drejtave nga deklarata universale për të drejtat e njeriut, kompetencat e Kuvendit, parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, organizimin dhe juridiksionin e gjykatave, emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve, përbërjen dhe mandatin e Gjykatës Kushtetuese, institucionin e Avokatit të Popullit dhe tjera çështje si këto.

Por, më shumë se kaq, ky amendament, në fakt, e thotë këtë që për të ushtruar drejtësi në Republikën e Kosovës duhet domosdoshmërisht ta shkatërrojmë sovranitetin e kësaj republike, që i bie që në momentin që këtë republikë e lëmë në duart e qytetarëve të Kosovës, atëherë aty drejtësi nuk mund të presim; që i bie që këta qytetarë të Republikës nuk dinë, nuk mund dhe nuk duan të ndërtojnë shtet; që i bie pikërisht ajo që e ka thënë Serbia vazhdimisht për ne; që këta nuk kanë aftësi për të prodhuar shtet; sepse një popull që s'ka aftësi për të prodhuar drejtësi autentike, ai natyrisht që s'ka aftësi për të prodhuar as shtet të vetin. Dhe, ky amendament e thotë pikërisht këtë, atë që e ka thënë Serbia historikisht për ne.

Po, është i përdorur në gjuhë tjetër, tash është në gjuhën shqipe. Po, e ka formën tjetër, mirëpo në thelb - kjo është e vërteta. Dhe, ju deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që e paskeni ndarë mendjen për ta votuar këtë amendament, ta kini parasysh që ju po i thoni këtij populli, por edhe vetes, por edhe gjeneratave që do të vijnë, që në fakt ne si popull nuk mund të ndërtojmë shtet, sepse nuk mund të prodhojmë drejtësi autentike, dhe si të tillë ne nuk e meritojmë këtë, e meqenëse nuk e meritojmë, duhet të heqim dorë nga kjo.

Pak a shumë, kjo është çka ju do të thoni me votën tuaj, por kur flasim për drejtësi, ne po themi që në fakt Dik Marti me raportin me tij paska potencial për të prodhuar drejtësi, sepse të mos e gënjejmë veten - kjo gjykatë po themelohet duke u bazuar në ato aludimet për krimet që kanë dalë nga raportin e Dik Martit, të cilat pastaj janë materializuar në raportin hetimor të prokurorit Uiliamson. Kjo është e vërteta për këtë gjykatë, e nuk po flasim këtu për kurrfarë drejtësie, si të them hyjnore, sublime, që po na vjen nga jashtë, por po flasim për këtë raportin e cili i përmban disa aludime për krime që shkruhen aty.

Dhe, tash, edhe këtu u përmend se si ky raport është i padrejtë, madje-madje u përmend edhe nga zëvendëskryeministri Hashim Thaçi, i cili tha që ky raport është i padrejtë, është dëm ndaj Kosovës e tjera, gjëra këto që i ka thënë për të qenë korrekt edhe në vitin 2011. Mirëpo, atëherë e ka thënë edhe një gjë, ju kujtohet të gjithëve. Ka premtuar publikisht që do ta padisë Dik Martin për shpifje në raportin e tij. Sot jemi në 2015, e ende nuk ka padi për Dik Martin nga Hashim Thaçi. A thua pse? A ka ndryshuar raportin e Dik Martit? Nuk qenka më i padrejtë, apo paska ndryshuar Hashim Thaçi? Edhe këtë të vërtetë e dimë. Hashim Thaçi ka ndryshuar, se ai në vitin 2013 tha 'unë nuk kam qenë në frontet e luftës'. Pra, Hashim Thaçi i UÇK-së i vitit 2011 që thoshte Dik Marti po na bën padrejtësi, tash tha që 'unë në fakt nuk kam qenë bash i UÇK-së, se s'kam qenë në front të luftës'. E di çka i bie kjo? Kjo i bie që 'unë nuk kam kryer krime. Krejt këta tjerët që kanë qenë në front kanë kryer krime. Pra, merrini krejt, përveç meje'. Këtë po e thotë Hashim Thaçi.

E në këtë po i ndihmojnë edhe tjerët, Kadri Veseli e shokët e tij të Grupit Parlamentar, që po thonë që janë të UÇK-së. Pra, këta tash po punojnë kundër UÇK-së, sepse po shpresojnë që kanë për ta shpëtuar veten. Kjo është e vërteta për dhomat e specializuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,
Po e filloj me Prekazin, Abria, Izbica, Reçaku, Suhareka, Pokleku, Çirezi, Likoshani, Kralani, Rahoveci, Pastaseli, Krusha, Rezalla, Gjakova, Meha, Korenica, Çabrat, Belegu, Lubeniqi, Çyshku, Studimja, Skënderaj, Kaçaniku, Kosova mbarë, ashtu siç e dimë të gjithë në vitet 1998-99 nga veriu në jug dhe nga perëndimi në lindje, u bë një vend masakrash dhe kjo ndodhi në zemër të Evropës.

Derisa këtu sot dikush po pretendon që kjo gjykatë është sjellë për të vënë drejtësi në vend, në memorien kolektive të shqiptarëve dhe të qytetarëve të vendit tonë sigurisht që vazhdojnë të jetojnë masakrat, pamjet dhe tmerret, të cilat i kemi përjetuar, qoftë si individë, qoftë si dëshmitarë dhe për të cilat asnjëherë s'është vënë drejtësi në vend.

Mua sot më kujtohet 24 marsi i vitit 1999, më kujtohet fshati im i tëri në flakë, më kujtohet Bajrami një fëmijë asokohe 6-vjeçar, i cili pasi që u plagos rëndë nga forcat serbe për shkak se i tërë fshati ishte tërhequr në mal, ai qëndronte vetëm dhe kërkonte ujë. Edhe aty s'ishte askush për t'ia sjellë një gotë ujë. Edhe sot, 15 vjet pas, për fatin e tij nuk di askush asgjë, prindi i tij ka vdekur dy javë më parë dhe ai nuk e ka ditur se çka ka ndodhur me djalin e tij, asokohe 6 vjeç. Në po të njëjtën ditë kur ne që kishim mundësi të iknim maleve, ikëm, ndërkaq ata të tjerët ishin pleq, të vjetër dhe të paralizuar, 11 prej tyre që u zunë të gjallë në një shtëpi të fshatit tim u

kallën, u dogjën për së gjalli dhe ne pas kthimit i gjetëm trupat e tyre të karbonizuar. Përsëri për asnjërin prej tyre dhe për të gjithë ata bashkë nuk është vënë kurrë drejtësi. Askush nuk ka dhënë llogari. Kriminelët kurrë s'kanë dalë para gjyqit.

Pak kilometra më larg, në fshatin Vrellë, dy vajza të moshës sa sot është vajza ime, diku 13-14 vjeç, të familjes Lipaj, u kthyen nga mali bashkë me gjyshen e vet për t'u furnizuar me miell, sepse aty ku ne ishim filloi të mbaronte mielli, dhe të tria: plaka, gjyshja dhe dy mbesat u zunë të gjalla dhe se çfarë u ka ndodhur mund ta paramendoni të gjithë, ndërkaq kur ne u kthyem pas luftës trupat e tyre të bërë copë-copë u gjetën në bunar. Dhe, prapë askush për këto vajza dhe për këtë gjyshe të tyre, të cilat u kthyen për t'u furnizuar me miell, nuk dha asnjë llogari. Kurrkush kurrë nuk u burgos, kurrkush kurrë nuk u ndoq, kurrkush nuk doli para gjyqit për të dhënë llogari për këto krime, të cilat u bënë ndaj civilëve.

Dhe, e di që çdonjëri, çdo deputetë këtu, sot, e ka një tregim të tillë, e ka një rrëfim, por unë konsideroj që sot nëse ne marrim një vendim të gabuar, atëherë ne me votën tonë për do t'i amnistojmë këta kriminelë, do ta amnistojmë një regjim të tërë, i cili ka kryer krime në Kosovë në vitet '98-'99.

Me votën tonë për sot ne e ndërrojmë adresën e krimit të vërtetë në Ballkan, e të gjithë e dimë kush janë viktimat, sepse kanë qenë të shumta, e vazhdojnë të jenë. Sot askush nuk e dha një përgjigje për të gjithë ata trupa që u gjetën në Bajtanicë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës u pretendua, u supozua që ka nevojë edhe më tutje të pastrohet, por le të na thotë dikush a kanë nevojë të japin llogari ata, të cilët në mënyrë të organizuar me frigorifer i morën trupat e shqiptarëve, të civilëve, të grave e fëmijëve. Për çka i morën ata trupa? Për çka i futën në frigorifer? Dhe, për çfarë u rrokullisën në Batajnicë?

Bëhet fjalë për një shtet dhe një krim të organizuar nga shteti, dhe askush nuk kërkoi gjykatë speciale për askënd, dhe askush nuk dha llogari për krime. Po dua ta sqaroj se asnjë subjekt opozitar në këtë Kuvend nuk është refuzues i drejtësisë, dhe është krejt e padrejtë që cilido prej deputetëve të pretendojë që këtu do të vihet drejtësi, sepse nuk ka shtet në Bashkimin Evropian i cili e bën drejtësinë në baza etnike. Ne jemi për sundim të ligjit dhe jemi pikërisht për vënien e drejtësisë në vend, mirëpo nuk mund të ketë drejtësi në këtë vend, nëse kjo drejtësi bazohet mbi një gjyq special, mbi një gjykatë speciale, e cila është e themeluar në baza etnike. Kështu nuk ndodh në asnjë vend demokratik, nuk duhet të ndodhë as në Kosovë.

Po kthehem te Kushtetuta dhe te çështja e sovranitetit të vendit tonë. Duke filluar nga Presidentja, nga Qeveria dhe nga deputetët, veç e veç, asnjëri nuk e ka të drejtën që ta ngrejë dorën për heqjen e sovranitetit, sepse asnjëri nga ne nuk e solli si individ këtë sovranitet. Janë gjenerata të tëra, qoftë të rezistencës, qoftë të gjitha ato viktimat, qoftë lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, qoftë përpjekjet për ndërtimin e shtetit pas luftës që na sollën këtu ku jemi ne sot, dhe ky Kuvend nuk e ka të drejtën të votojë për heqjen e këtij sovraniteti. Dhe, kjo çka po kërkohet nga ne sot është pikërisht që ta themelojmë një gjykatë të veçantë kushtetuese, supreme, të të gjitha niveleve deri tek Ombudspersoni. A mendoni që kjo është e drejtë dhe a mendoni që cilido prej nesh si individ dhe si kolektivitet, ky Kuvend ka të drejtë të votojë për heqjen e sovranitetit të vendit tonë.

Unë mendoj që s'kemi të drejtë dhe që nëse gabojmë do të skuqemi dhe do të turpërohemi para fëmijëve tanë dhe para brezave të ardhshëm, sepse në këtë shtet sovran me një sovranitet edhe kështu të brishtë, me këtë projektligj që ka ardhur në mënyrë jokushtetuese, na është thënë, po e theksoj, kolegë deputetë, ju si deputetë të zgjedhur, të cilët përfaqësoni dikush me më shumë e dikush me më pak vota, por kjo s'ka fare rëndësi sot, sepse ne sot i përfaqësojmë qytetarët e vendit tonë, nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë, të amendamentojmë, nuk kemi të drejtë ta shqyrtojmë një projektligj, por vetëm duhet ta votojmë. A është kjo demokraci?

Le të na thotë dikush në këtë vend që ne mund ose kemi të drejtë që, pa pasur fare të drejtë, t'i japim qëndrimet tona për një projektligj të tillë antikushtetues dhe domosdo të votojmë për. Unë konsideroj që është e kundërta. Konsideroj që ky projektligj, si i tillë, edhe këtu po u drejtohem kolegeve dhe mikeve të mia, grave deputete, kemi punuar bashkë në tri mandate dhe përtej punëve të cilat kanë qenë në interes të partive tona politike, ne shumë shpesh kemi dalë mbi interesat e ngushta, jemi mburrur dhe qytetarët e kanë pëlqyer gatishmërinë dhe vullnetin që të dalim përtej vijave partiake dhe të bëhemi bashkë në interes të shtetit.

Unë ju thërras sot që të bëhemi bashkë për interesin e 20 mijë grave të dhunuara, sepse ashtu siç kemi mbledhur fustane, e kjo nuk mjafton, ne duhet ta gjejmë fuqinë që të votojmë kundër këtij projektligji, i cili nëse kalon sot, e unë shpresoj që ky Kuvend nuk do ta bëjë këtë gabim, do ta mohojë të drejtën e 20 mijë grave, të cilat u dhunuan në sytë e fëmijëve të tyre, në sytë e burrave të tyre, të vëllezërve të tyre, të baballarëve të tyre, që të kërkojnë drejtësi. Dhe, mendoj që duke ia mohuar drejtësinë njëres palë, ne nuk mund të vëmë drejtësi për palën tjetër. Prandaj, ju thërras që të jemi bashkë, që të kërkojmë drejtësi për të gjitha viktimat nëpërmjet ligjeve dhe gjykatave në Kosovë, brenda Kosovës, për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim.

Por, kjo çka po ndodh, është e kundërta. Kjo çka po ndodh, në fakt, është në kundërshtim me të gjitha parimet demokratike, të cilitdo vend në Perëndim, cilitdo qoftë ai, është në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Motrat Lipaj atje, familjet e tyre, kanë të drejtë që të kërkojnë drejtësi dhe nëse ne e kalojmë këtë projektligj atyre do t'u mohohet kjo e drejtë, familjeve të tyre do t'u mohohet kjo e drejtë.

Unë ju thërras që, për hir të vërtetës, të asaj që e kemi kaluar bashkë, të përpjekjeve dhe angazhimeve të shumta, të luftës së Ushtrisë Çlirimtare, të kërkojmë drejtësi për këtë vend dhe drejtësi do të nënkuptojë që të ketë drejtësi për të gjithë, jo drejtësi në baza etnike, jo drejtësi të pjesshme dhe jo ikje dhe heqje dorë dhe cenim nga sovraniteti i vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Kosovës,

KRYETARI: Zafir, kërkoj falje dy sekonda. Më fal Albulenë, unë jam duke e udhëheq seancën. Do të flasim të gjithë deputetët në kohën të pakufizuar. Unë do të mundohem ta bëj renditjen vetëm në bazë të partive. Vetëm ju kisha lutur, ruajeni veten secili për hir të njerëzve, të cilët janë jashtë. Urdhëro, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Sot është një moment historik, njeriu si individ, por edhe institucionet nuk ndodh shpesh të gjenden në momente, siç gjendemi ne sot, edhe si deputetë, edhe si qytetarë, edhe si Kuvend.

Jemi para një momenti që ta vulosim tradhtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të vazhdojmë t'u qëndrojmë besnikë ideve për liri që i ka pasur me shekuj qytetari i Kosovës, ideve për perspektivë evropiane. Ndryshimet kushtetuese në fakt e rrezikojnë perspektivën e vendit dhe këto besoj se e dini të gjithë, nuk e dinë vetëm ata që janë të shantazhuar dhe e dinë vetë se janë të shantazhuar.

Themelimi i gjykatës është një atak për luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Njëherësh, është edhe përpjekja e fundit e tendencës që luftën e lavdishme të UÇK-së dhe të qytetarëve të Kosovës ta barazojnë me luftën kriminale të regjimit fashist të Serbisë. Për këtë besoj se ata që kanë qenë të interesuar e dinë, sepse mekanizmat, të cilët e kanë përgatitur raportin e Dik Martit dhe janë duke i përgatitur dosjet për të akuzuarit potencialë me pyetjet që i marrin njerëzit, domethënë nuk ka dilemë se jemi duke rrëshqitur në atë drejtim.

Mendoj se pas luftës, dështimi i drejtësisë nga ndërkombëtarët me një pjesë edhe të vendorëve, është i qëllimshëm. Ne e dimë pas luftës se këtu drejtësinë e ka pasur në dorë UNMIK-u, një okupator modern, i cili është munduar të degjenerojë çdo gjë që ka qenë me vlerë në këtë vend, pastaj ka vazhduar edhe EULEX-i, dhe nuk ka bërë gjë. E ju i dini skandalet e EULEX-it dhe unë kam një përgjigje për këtë dështim, kuptohet jo veç i ndërkombëtarëve, por me aleatë të disa vasalëve politikë të vendit. Kjo bëhet me qëllim që marrëveshjet e fshehura në dëm të Kosovës, të cilat e kanë për qëllim copëtimin e vendit, domethënë të realizohen më lehtë duke themeluar një gjykatë, e cila do t'i atakojë njerëzit të cilët nuk pajtohen me realizimin e një skenari të fshehur për Kosovën.

Unë mendoj se kjo gjykatë do të ketë edhe eliminime politike për ta realizuar qëllimin që e thashë, prandaj, të nderuar kolegë deputetë, para se të votoni kujtojeni Prekazin, kujtojeni Rezallën, Obrinë, Reçakun, Mejën, Lezin, Jeshkovën, Krushën, Hasin, Tërnjën, kujtojeni gjithë Kosovën e viteve '98-'99. Dhe, kur t'i kujtoni ato ngjarje që kanë ndodhur në Kosovë, atëherë thirrini mendjes se çka jeni duke votuar.

Unë jam pjesëmarrës i luftës dhe mburrem për atë dhe asnjë sekondë dhe milimetër nuk ia heq së kaluarës sime, por më duhet të them dhe t'u drejtohem dy personave: Azem Syla nga sot, në rast se voton, nuk je "Daja" i luftës, as ti Xhavit Haliti nuk je më "Zeka". Se për disa s'po them, sepse edhe atëherë s'kanë qenë pale farë burra. Unë po kujtoj se ne duke i thënë 'jo' kësaj gjykate, ne u themi jo disa pretendimeve. Jo miqtë janë të interesuar të kalojnë kjo gjykatë dhe kërcënimin me OKB-në, e kam thënë edhe në një rast, është si çështja e atij gogolit. Në fakt, ajo që pretendohet që nëpërmjet këtyre fjalëve t'ia mbushë mendjen dikujt se do ta votojë, do të dalë edhe në dorë të Rusisë, ju e dini se Rusia ka mundësi nëpërmjet Listës serbe edhe këtu të votojë në rast se ka ndonjë interes.

Mua më vjen keq që nga deklaratimet e deritashme disa deputetë, jo me dorë, por po të kenë mundësi edhe me këmbë votojnë, jo pse duhet të votohet gjykata, por pse kanë interesa mesquine e politike për karrierë të caktuar në pretendimet e tyre.

Unë mendoj se duhet të lihen anash interesat personale. Është në pyetje Kosova, është në pyetje e kaluara e lavdishme dhe duhet ta përsëris atë që e thanë shumë kolegë në fund - nuk jemi kundër drejtësisë, por jemi kundër drejtësisë selektive dhe kundër atakimit që dëshiron dikush t'i bëjë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Të nderuar deputetë,
Zoti kryeministër,

Ne si deputetë sot vërtet jemi në një pozitë tepër të vështirë. Para nesh është një përgjegjësi tepër e madhe, të bëjmë ose të mos bëjmë një veprim i cili kërkohet nga ne.

Ne dëgjuam me vëmendje, por s'është një gjë e re ato që u thanë këtu sot. Në Kosovë janë bërë masakra, jo vetëm në luftën e fundit, por me shekuj. Ne kemi qenë cak dhe viktimë gjithmonë dhe unë mendoj që e njëjta gjë po ndodh edhe sot. Edhe sot jemi cak dhe viktimë. Dhe, është përgjegjësia jonë se cilin veprim ta bëjmë, të themi 'po' ose 'jo'. Nuk ka asnjë dilemë se Serbia shumëfish me qindra herë ka bërë masakra më të mëdha në Kosovë sesa cilido pjesëtar i UÇK-së që pretendohet se ka kryer ndonjë krim, çfarëdo qoftë ai.

Pra, nuk ka dilema në këtë drejtim dhe ne jemi shumë të vetëdijshëm se të gjitha këto kanë ndodhur. Tash çështja këtu po shtrihet, kush është patriot dhe kush nuk është patriot? Ai që nuk është patriot është tradhtar, do ta votojë themelimin e një gjykate, e cila do t'i gjykojë krimet që kanë kryer pjesëtarët e UÇK-së, respektivisht shqiptarët ndaj serbëve, që është plotësisht e saktë. Ne nuk e mohojmë këtë. Kjo po ndodh. Pikërisht kjo po ndodh dhe nuk po formohet një gjykatë e drejtë e drejtësisë që do t'i gjykojë të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë. Dhe, çështja nuk është me dilema këtu, problemi është diku krejt tjetër. Tash këtu vërtet mund të jemi patriotë dhe jo patriotë. Vërtet disa do të votojnë për një opsion, po ata që s'do të votojnë për atë opsion do të votojnë për një opsion tjetër. Të mos mendojë dikush që shpërlahet nga përgjegjësia, sepse nuk e voton një opsion që është para nesh.

Ne i kemi dy opsione para nesh, nuk e kemi vetëm një. Është një opsion ta formojmë ne, përkundër dëshirës sonë, ta formojmë një gjykatë, e cila do t'i gjykojë disa krime që pretendohet se janë kryer. Është një gjykatë që e bën një padrejtësi të madhe ndaj shqiptarëve apo të mos votojmë për këtë, por në fakt të votojmë për një gjykatë tjetër që e formon Këshilli i Sigurimit dhe është shumëfish, njëqind herë më e rëndë se kjo.

Pra, i kemi dy opsione. Secili mund ta zgjedh opsionin e tij dhe të votojë, por nuk duhet të mendojë askush që këtu po bëhet patriot, ose tradhtar ose po e shpëton Kosovën ose s'po e shpëton. Këtë dilemë duhet ta heqim, është një iluzion, nëse dikush mendon se me mosvotimin e këtij ndryshimi të Kushtetutës, bëhet patriot dhe e shpëton Kosovën, unë mendoj se do të ndodhë e kundërta dhe secili duhet ta mendojë përgjegjësinë e tij për këtë çështje.

Çështja tjetër është, “unë s’e votoj edhe po të shembet bota dhe po të jetë fundi i botës, unë nuk e votoj këtë ndryshim edhe po të shkatërrohet Kosova.” Unë mendoj që është gabim, është një koncept i gabueshëm. Populli ynë e ka një fjalë të mençme, thotë: “edhe nga të këqijat, zgjidhe të keqen më të vogël, mos e zgjidh më të rëndën”, sepse ajo mund të vijë nesër. Nëse ju më garantoni që nuk do të formohet kjo gjykatë nga Këshilli i Sigurimit, unë këtu para të gjithëve ju premtoj që unë do të votoj kundër, sot. Por, nuk ka askush një garanci dhe ta dini që përkrahësi ynë më i madh ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ka thënë në mënyrë shumë të qartë që nëse s’e formoni ju, do të formohet kjo tjetra. Dhe, ne s’kemi arsye të dyshojmë në këtë, sepse unë mendoj se do të ndodhë kjo.

Prandaj, unë mendoj që secili e ka para vetes alternativën, e ka opsionin, mund të votojë, por, desha të them që mos të pretendojë dikush se duke votuar ose mos votuar, do të jetë patriot. Patriot do të jetë ai që e zgjedh të keqen më të vogël, sepse një padrejtësi do t’i bëhet Kosovës, vetëm varet cilin opsion e zgjedhim ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar ambasadorë të vendeve partnere të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Më lejoni të filloj fjalimin tim duke shprehur respektin dhe nderin më të thellë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për aktorët kryesorë të lirisë sonë.

Jam këtu për të përfaqësuar dhe ruajtur të drejtat dhe interesat e qytetarëve drejt një perspektive të sigurt për një mirëqenie dhe jetë sa më të devotshme, po ashtu edhe me dinjitet të plotë. Pa dashur të tingëllojë subjektive dhe patriote, rrjedh nga një familje e dëshmorit të kombit. Duke iu falënderuar idealeve dhe veprës së tyre të shenjtë, ne jemi këtu duke gëzuar lirinë tonë dhe falë gjakut e sakrificës së tyre ne gëzojmë pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte kapitull i fundit i betejës sonë shekullore për liri. Heroi Adem Jashari, me gjithë bashkëluftëtarët e tij, është vlera më sublime për çka jemi krenarë të inspiruar e të obliguar për të punuar drejt një ardhmërie, bazuar në amanetin e tyre.

Për këto 16 vjet me radhë të pasluftës, kemi përjetuar ndër zhvillimet më të paparashikueshme, sa i përket cenimit të integritetit të të drejtave njerëzore. Të hetohet lufta e pastër e çlirimtarëve për çlirim të popullit dhe vendit, të anashkalohet dhe mos gjykohet gjenocidi i ushtruar nga një armatë e një regjimi diktatorial, për çka edhe sot janë faktet dhe dëshmitë e gjalla, jemi atakuar, nënçmuar me dinjitetin dhe karakterin personal familjar dhe shoqëror, ku ende nuk dihet fati i 1 600 personave të pagjetur, ende motrat, nënat tona, rënkojnë nga abuzimet e luftës së fundit, ndërsa kriminelët apo kryerësit e këtyre veprimeve jetojnë të lirë në Serbi dhe gjetiu, në Evropë dhe botë.

Çfarë drejtësie po kërkohet këtu? Ku është drejtësia që po kërkon Evropa? Kjo është botë e shekullit XXI.

Në të gjitha proceset gjyqësore, të cilat u zhvilluan në Hagë, çdoherë u vërtetua se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, udhëheqësit dhe ushtarët e saj kanë qenë të udhëhequr nga ndjenja e barazisë për liri, për çka u dëshmuar dhe u vërtetua. A nuk qe e mjaftueshme kjo? Apo, ndoshta kjo po suprimon dhe konteston drejtësinë tuaj.

Aktgjykimet e shpallura ndaj grupit të Drenicës, jo vetëm që janë shumë shqetësuese dhe të dëmshme për Kosovën, por po thyjnë edhe motivin më të vogël për një jetë normale, një jetë me shpresë drejt mirëqenies së shoqërisë sonë dhe vendit tonë.

Lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë dhe luftë e pastër. Nisur nga funksioni dhe qëllimi, institucionet gjyqësore, qofshin vendore apo ndërkombëtare, bëjnë drejtësi mbi bazën e fakteve dhe dëshmive të vërtetuara, por jo të ndikuara nga dëshmitë armiqësore e të fabrikuar me motive politike, ndaj luftës së pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo na bën të ndjehemi të pasigurt për lirinë tonë, për çlirimtarët tanë.

Që nga fillimi i diskutimit për këtë çështje, nga vitet paraprake, kam bindjen se të gjitha familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjithë bashkëkombësit nuk kanë hasur në ndonjë sfidë më të madhe, më të ndjeshme, që nga paslufta, se sa sot për të gjykuar padrejtësisht mundin, sakrificën e tyre, gjakun e derdhur për luftën çlirimtare të Kosovës.

Falënderoj miqtë tanë ndërkombëtarë për ndihmën që na dhanë për të forcuar këtë liri dhe për të konsoliduar shtetin tonë. Dëshiroj të qëndroj besnik bindjes sime ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve tanë, të cilët synojnë më të mirën për të ardhmen e popullit tim, për të ardhmen e dinjitetshme të shtetit të Kosovës.

Të jeni të bindur, se edhe pa ndërhyrjen e NATO-s, lufta e drejtë për liri nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nuk do të ndalej. Të gjithë e kemi parasysh se si rezultat i luftës së UÇK-së i gjithë populli shqiptar erdhi edhe intervenimi i NATO-s, që është e pakontestueshme se kjo ndërhyrje ka një veprim human dhe strategjik.

Kjo re e zezë që sot ra mbi Kosovë, kjo hije e zezë që po na rri mbi kokë, tani po kërkon një orientim. Para se të nisem nga shtëpia drejt sallës së Kuvendit, paraprakisht kam komunikuar me fotografinë e çlirimtarit, fotografinë e dëshmorit tim, të varur në mur duke i kërkuar falje, njëkohësisht dhe leje për atë që më solli sot koha padrejtësisht nga njerëzit dashakëqij, nga armiqtë e lirisë së popullit tim, të reflektoj për çlirimtarët që sollën lirinë dhe nëse reflektimi të drejtës sime në këtë Kuvend, sot dhe nesër do të gjykohej për të mirë a për të keq. Pra, sido që të jetë, qëllim e kam rrugëtimin drejt forcimit dhe konsolidimit të shtetit tonë, duke i treguar botës se lufta për liri për shoqërinë e vendit tim ka qenë luftë e pastër, ka qenë luftë e drejtë në rrugën e drejtë prosperitetit integruar në instancat euroatlantike, për atë që sakrifikuan edhe ata që flijuan për vend.

Gjithnjë lavdia, krenaria dhe mirënjohja ju takon ju, o çlirimtarë, që jeni këtu në këtë sallë të Kuvendit dhe ata të cilët janë duke na përcjellë. Këtë e them dhe e ndjej me plotë besim, unë dhe gjithë populli im. Nderim, respekt dhe mirënjohje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ! Tani fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë,
Nuk di parafolësja ime e ka harruar një letër këtu në foltore, ku thotë se lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër. Kolege, e ke harruar një fletë.

Unë do të filloj nga kjo. Nëse lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër, pse paska nevojë ta pastrojmë?

Por, të nderuar deputetë, do të them edhe diçka. Nga parafolësit tjerë të cilët mbrojnë qëndrim të ndryshëm prej asaj çfarë do të duhej të mbronte një i zgjedhur i qytetarëve të këtij vendi, tha që në mes dy të këqijave, duhet ta zgjedhim të keqen më të vogël. Jo. Nuk kemi jemi ne këtu që të zgjedhim në mes një të keqe më të vogël apo një të keqe më të madhe. Në mes dy të këqijave për qytetarët, duhet t'i refuzojmë të dyja. Apo, keni harruar që ka edhe refuzim.

Por, meqë jemi sot në seancë, nuk mund të mos e përshkruajmë ose ta bëjmë një udhëpërshkrim, se si kemi ardhur deri te kjo seancë. Më lejoni t'ua kujtoj edhe njëherë. Deri te kjo seancë kemi ardhur nga pretendimet e Serbisë në vazhdimësi, se UÇK-ja është organizatë kriminele. Deri këtu kemi ardhur me vazhdimësi, pasi që Serbia gjithmonë i ka akuzuar shqiptarët si terroristë dhe këtë ju e dini shumë mirë. Madje, shumë prej jush këtu e në mesin e tyre edhe unë, jemi dënuar nga gjykata serbe për terrorizëm, sipas ligjeve të tyre. Po, deri këtu kemi ardhur edhe në bazë të pretendimeve të Dik Martit, të cilat shumë protagonistë si sot akoma nuk kanë vendosur se si ta votojnë këtë gjykatë, dikur e quanin si e keqja më e madhe e këtij vendi raportin e tij. E pas raportit të Dik Martit është ngritur edhe një kryeprokuror, është ngarkuar një prokuror, pra është ngritur një task-forcë hetimore speciale dhe është ngarkuar një kryeprokuror, i cili për ironi këtu del të jetë më transparenti, prokurori Viliamson, i cili e bën shumë të qartë qëllimin e kësaj task-force.

Më lejoni t'i ndaj nga dy tre rreshta nga ky raport bashkë me ju, që ne të dimë pastaj se çka po votojmë. Ky prokuror në të gjeturat e tij i referohet raportit të Dik Martit, të cilin raport për asnjë herë nuk e mohon, raportet dhe pretendimet e të cilit ky i pohon e i çon edhe më tutje dhe ngarkon Ushtrinë Çlirimtare, me përgjegjësi, siç thotë ky, për fushatën e persekutimit që është drejtuar kundër popullsisë serbe, rome dhe pakicave tjera në Kosovë.

A kemi bërë ne si qytetarë, si Kosovë, si shqiptarë, një fushatë të tillë? Ai edhe më tepër e qartëson në mënyrë shumë transparente qëllimin për të cilin kërkohet vota jonë. Pas të gjeturave që ai u referohet, thotë: "Kjo në efekt rezultoi në spastrim etnik të sasive të mëdha të popullsisë serbe dhe rome nga ato rrethina në anën jugore të lumit Ibër në Kosovë". Që çka po kërkohet nga ne të votojmë dhe ta miratojmë.

Kam dëgjuar shpeshherë, që për ta kamufluar këtë çfarë kërkohet prej nesh, thuhet që këto pretendime nuk kanë të bëjnë me luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në përgjithësi, me popullin shqiptar, por kanë të bëjnë diçka me individët, pra me individë të caktuar. Më lejoni, t'ua lexoj vetëm një paragraf të shkurtër nga ky raport, i cili e demanton këtë. Ai thotë: "Ne besojmë, se provat janë bindëse, që këto vepra nuk ishin

vepra të individëve bataçin që kanë vepruar me dëshirën e vetë, për përkundrazi, ato janë kryer në mënyrë të organizuar.” Që çka kërkojnë prej nesh të votojmë.

Pra, ja disa nga arsyet, jo të vetmet, pse ne kundërshtojmë formimin e një gjykate të tillë dhe kundërshtimi ynë për një gjykatë të tillë, e theksojmë edhe njëherë, nuk është kundërshtim ndaj drejtësisë, por është kundërshtim ndaj padrejtësisë. E kjo çfarë këta po kërkojnë, është e padrejtë. Kjo gjykatë, pra, po kërkon t’ia ngarkojë Kosovës dhe qytetarëve të saj, në përgjithësi shqiptarëve, spastrimin etnik.

A kemi bërë ne spastrim etnik? Të gjithë ata që mendojnë që ne kemi bërë spastrim etnik, le ta votojnë. Por, ata që dinë se në Kosovë shqiptarët nuk kanë bërë spastrim etnik e aq më tepër, pas luftës, ku i referohet këtu në anën jugore të lumit Ibër, duhet të dimë se çfarë po veprojmë.

Në anën tjetër, duke ditur se kjo gjykatë po i referohet një spastrimi etnik që ka ndodhur pasluftës, atëherë edhe vetë shtetin e Kosovës e bën t’i ketë themelet mbi ndërmarrje dhe organizime kriminele, siç ata thonë këtu. Prandaj, nuk po e lëdojmë vetëm UÇK-në, aq më tepër njerëzit e UÇK-së, po e lëdojmë luftën tonë të drejtë, po e lëdojmë vendin tonë dhe mbi të gjitha, jo vetëm ne, po e lëdojmë edhe të ardhmen e këtij shteti dhe të ardhmen e fëmijëve tanë, për shkak se ata do të rriten në një shtet, i cili sipas këtij raporti, i paska themelet në organizim të përbashkët kriminal. I paska themelet në spastrim etnik. A i ka ky shtet themelet në spastrim etnik? Thuaje me votën tuaj.

Po të isha unë njëri prej tyre, i cili eventualisht do të votoja për themelimin e kësaj gjykate, ju them se nuk kisha pasur çka lyp në Prekaz, më, as në Reçak, as në Orllan, as në Koshare. Nuk kisha pasur çka u them shokëve të mi të luftës. Nuk kisha pasur çka u them, as fëmijëve të tyre. S’kisha pasur mundësi dhe fuqi t’ua lëmoj flokët fëmijëve të dëshmorit, kur ti e bën një gjë të tillë për idealin e baballarëve të tyre.

Sa i përket, a është e pastër Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ose jo, është mirë që nuk është në dorën tonë, as në mundësinë tonë që ta njollosim. Ajo ka qenë luftë e pastër, mbi të gjitha ka qenë luftë e drejtë. Edhe po të donim, ne nuk mund ta njollosim atë. E shumta çfarë mund të bëjmë, mund ta njollosim emrin tonë me përcaktimin tonë, kundrejt kësaj lufte të drejtë kundrejt të tashmes, historisë dhe të së ardhmes së këtij vendi.

Pra, ne nuk mund ta njollosim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, eventualisht mund ta njollosim vetveten. Por, meqë u përmend Adem Jashari, këtu, a ju ka shkuar ndonjëherë ndërmend çfarë do të thoshte Adem Jashari po t’ia kërkonim një gjë të tillë, se ai po të ishte i gjallë, do të ishte njëri prej nesh, qoftë këtu, qoftë diku tjetër. Prandaj, nuk është mirë që përmes emrit të dëshmorëve, të Adem Jasharit, përmes fotografisë së dëshmorëve, të kërkojmë diçka që të bëjmë kundër idealit të tyre, kundër qëllimit të tyre e mbi të gjitha, kundër vendit për të cilin ata ranë.

Prandaj, prej nesh sot këtu vërtet kërkohet trimëri. Por jo, nuk kërkohet trimëri për ta shtrirë qafën, por kërkohet trimëri që t’i themi jo çfarëdo të keqe, qoftë e vogël, qoftë e madhe, që i vjen vendit tonë. Ne jemi të zgjedhur këtu për të bërë mirë, jo për të zgjedhur në mes një të keqeje dhe një të keqeje tjetër. Dhe, nëse duam të thirrmi me respekt ndaj miqve, ne i respektojmë edhe

miqtë, kur dimë të jemi dinjitoz. Nuk u duhemi gjë miqve, kur dimë të jemi të nënshtruar dhe të poshtëruar dhe të themi, pa pyetur fare pse, na kanë thënë ata, apo s'na kanë thënë ata.

Dua t'u them edhe një gjë tjetër, ka pasur momente historike, kur unë bashkë me shumë të tjerë, që qoftë janë këtu, qoftë janë prapa nesh, kemi ditur të themi jo, për të mirën e vendit. Kemi ditur t'i kundërshtojmë miqtë tanë, për të mirën e vendit, me të cilët pas një viti që kemi kundërshtuar, kemi qenë partnerë në luftë. Ju kujtohet shumë mirë edhe raporti i veprimeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se si është cilësuar më '97, si më '98 dhe si më '99. Miqtë tanë duan partnerë dinjitozë, jo partnerë të nënshtruar, të cilët as nuk pyesin për veprimet e veta, se çfarë duhet të bëjnë.

Dhe, në fund, zonja dhe zotërinj, të nderuar qytetarë, po besoj që ne jemi duke bërë një punë shumë të rëndësishme, sepse kjo seancë është ndër seancat më të rëndësishme, nëse jomë e rëndësishmja në mandatet tona, që jemi këtu si deputetë, qoftë në këtë mandat, qoftë në mandatet tjera. Këtu ndahemi, ata që votojnë për dhe ata që votojnë kundër. E në vartësi të votimit tonë, kur të kthehemi në shtëpi do të duhet të dimë, çfarë t'u themi bashkëluftëtarëve tanë, çfarë t'u themi fëmijëve tyre, çfarë t'u themi fëmijëve tanë dhe familjarëve tanë, tek e fundit, çfarë t'u themi edhe atyre fotografive, që i mbajmë në mur. Kur të kthehemi prej këtu, dijeni që në dorën tuaj, qoftë me të drejtë, qoftë padrejtësisht, është të vendosni jo vetëm për të kaluarën, jo për njerëzit, po për të tashmen dhe për të ardhmen e këtij vendi, do të vendosni për të tashmen dhe të ardhmen e fëmijëve tanë dhe ne nuk kemi të drejtë, as kushtetuese, as morale, as njerëzore, që të vendosim ndryshe prej interesave të vendit, ndryshe prej interesave të atdheut, ndryshe prej interesave të fëmijëve dhe familjeve tona.

Prandaj, kërkoj edhe njëherë që vota kundër t'ju rreshtojë në anën e duhur, në anën e familjeve tuaja, bashkëluftëtarëve tuaj, në anën e dëshmorëve të lirisë, në anën e Kosovës. Asnjë version tjetër nuk na shpie në asnjë lloj shpëtimi. Edhe njëherë, kundërshtimi jonë është kundërshtim ndaj padrejtësisë, jo ndaj drejtësisë dhe në mesin e dy të këqijave duhet t'i refuzojmë të dyja.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës gjenden para një vendimi të vështirë, si rezultat i qeverisjes së dështuar dhe të komprometuar. Për fatin tonë të keq, po përsëritet historia e votimeve të imponuara e të dëmshme për vendin dhe qytetarët tanë.

Sot nëpërmes këtij amendamenti po atakohet rëndë sistemi i drejtësisë, në fakt, sot po ndodh suspendimi komplet i sistemit të drejtësisë dhe ju zotërinj të nderuar të Qeverisë, po hiqni dorë nga sovraniteti i gjyqësorit vendor.

Si çdo e keqe edhe kjo e ka burimin dhe aktorët e vet. Burim kryesor i kësaj gjykate speciale janë shpifjet e Serbisë, dokumenti i Dik Martit dhe bisedimet e dështuara në Bruksel.

Të nderuar, ju rrëshqitët në terrenin e lakmisë për pushtet dhe për pasuri, prandaj humbët kredibilitetin për të vendosur rend, ligj dhe për të mbrojtur vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Siç duket, dikujt i ka ndodhur diku diçka, por edhe kjo le të definohet me kohë.

Themelimi i Gjykatës Speciale është tërësisht politik, sepse nëpërmes kësaj gjykate po goditet platforma e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të përdoret për eliminimin e shumë figurave nga skena politike. Kjo gjykatë do ta dëmtojë rënd imazhin e vendit, sepse këtu nuk flitet për krimet që kanë ndodhur në Kosovë, por vetëm për krimet gjoja që i ka bërë UÇK-ja, e kjo është tërësisht e pabazë dhe e pavërtetë. Krimi dhe masakra këtu janë kryer në mënyrë të komanduar, strukturuar dhe sistematike nga forcat serbe, ku kemi mbi 12 civilë të vrarë e masakruar, mbi 2500 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të rënë dëshmorë për këtë vend, por jo për themelimin e kësaj gjykate, mbi 1 milionë shqiptarë të dëbuar nga vatrat e tyre.

E kush po i ndëshkon ata kriminelë serbë sot? Askush. Jo vetëm përmbajtja e gjykatës, por edhe koha dhe përmasa në të cilën do të shtrihet kjo gjykatë, do të jenë armik shtesë për të ardhmen e vendit tonë. Prandaj, e gjithë kjo e ka qëllimin e vetëm për të dëmtuar e penguar vendin sa më gjatë.

Të nderuar deputetë, për të votuar sot për këtë amendament është dënimi më i madh, që mund t'i bëjmë me anën e votës sonë historisë së lavdishme të popullit tonë. Është dënimi më i madh, që mund t'i bëjmë të sotmes, është dënimi më i paparashikueshëm për të ardhmen e vendit tonë, po ashtu do të njollosim veten dhe familjet tona.

Andaj, të nderuar deputetë, të mos biem viktimë e mashtrimit dhe presionit për të votuar, por të marrim kurajën e t'i themi jo kësaj të keqe, veçmas ju që dje guxuat të luftoni për Kosovën, sot nëpërmes guximit të votës thuani jo kësaj gjykate krejtësisht të pabazë e të dëmshme për vendin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar, kryetar i Kuvendit,

Qeveri,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, ju drejtohem si qytetar, si deputet dhe pa ngjyrimë politike, sepse sot kërkohet që të ulen flamujt partiakë, por të vendosim për interesin e vendit, për interesin e qytetarëve dhe të mos e atakojmë me votën tonë rendin kushtetues dhe të ardhmen, që quhet shtet i Kosovës.

Po ju drejtohem si qytetar i Gjakovës, i një qyteti që ka përjetuar tmerr, ka përjetuar atë që, dhashtë Zoti, kurrë mos të përsëritet në trojet tona, as në Gjakovë, as në Drenicë, as në Llap, as në ndonjë hapësirë të Kosovës. Janë 1870 të vrarë, të sakatosur, të djegur dhe pothuajse të

shfarosur, janë shumë familje sot nga Gjakova dhe krejt Kosova, që kërkojnë më të dashurit e tyre, janë njerëzit që gjatë luftës vetë i kam trajtuar dhe para vdekjes kanë kërkuar nga unë si mjek, të lutem na shpëto jetën dhe ta përfetojmë ne ato synimet tona, shtetin tonë dhe, kanë shkuar me një amanet, që ky shtet të jetë i fortë, të jetë i vendosur dhe të përparojë në të mirën e qytetarëve, pa dallime.

Të nderuar deputetë,

E di që çdonjëri prej jush e thërret zërin e arsyes, pa dallime partiake, pa interesa individuale, por për të mirën e gjithë atyre qytetarëve, që presin që ne të votojmë drejt. Dhe, votimi më i drejtë që i bëhet për qytetarët, për ata që sot nuk janë në mesin tonë, për ata që kanë rënë në altarin e lirisë, për ato familje që sot nuk i dinë më të dashurit e tyre, për Çabratin, për Mejen, për nënën që ka mbetur e vetmuar në Gjakovë, që i ka humbur katër djem dhe sot është e vetmuar, na thërret që të votojmë drejtë dhe mos ta votojmë këtë gjykatë, që është dëmi më i madh që i bëhet rendit kushtetues dhe rendit juridik. Ajo që ne duhet sot të themi, është kështu të bashkuar, që me të vërtetë ta thërrasim mendjen tonë dhe t'i përkujtojmë gjithë ato shkatërrime që kanë ndodhur në Kosovë e në Gjakovë, çdo kund nëpër çdo qytet, nëpër çdo fshat, gjithë ato shkatërrime, po ju them, 5870 shtëpi janë të djegura vetëm në Gjakovë.

Dhe sot, të na vënë para një aktit të kryer, a është e drejtë kjo? Ne jemi për drejtësi, por ajo drejtësi të zhvendoset në institucionet tona, që shumë bijë tanë kanë rënë në altarin e lirisë, që ne të jemi të zot e vetes. A është kjo, ju pyes, e padrejtë që po i bëhet? A është kjo një e keqe që po i bëhet Kosovës?

E di që në mendjen e juaj thoni zëshëm, po. Atëherë, deputetë të nderuar, nuk jemi të thirrur sot që ta votojmë të keqen. Sot jemi të thirrur që ta votojmë të mirën dhe ta forcojmë shtetin tonë, Kushtetutën tonë dhe jo t'i merret mëvetësia e Kushtetutës dhe e gjyqësisë, një segment që është thelbësor për të ndërtuar një shtet. Dhe, sot po ju ftoj si qytetar i Kosovës, si deputet, pa flamur partiak, prapë po e përsëris, që të votojmë kundër kësaj të keqeje që po i ndodh Kosovës. Dhe, ajo që mund t'ua përkujtoj, më kujtohet, e kam trajtuar një nënë në Gjakovë, në vitin 1999, në gusht. Dhe, kjo nënë më është drejtuar kështu, thotë: "I nderuar doktor, si mund të pajtohem me këtë jetë, kur mua ma kanë marrë vajzën 13 vjeçare prej dore dhe më ka shkuar vajza duk më thënë - Nënë, të lutem, mos më lësho! - thotë, s'kam pasur tjetër çka t'i bëj por, ia kam ngjitur për flokë dhe ia kam shkukur flokët, sepse ma kanë marrë me zor ata që kurrë të mos jenë në Kosovë, që mos t'ua përmend emrin. Edhe sot i ruaj flokët dhe kurrë më nuk e kam parë këtë vajzë."

Kush është këtu, që ka kryer krim? Kush është këtu, që i ka mbytur 13 000 qytetarë të Kosovës? A jemi ne, apo është dikush tjetër?

Dhe, sot ne të votojmë këtu për atë që kurrë s'më ka rënë ndërmend edhe si qytetar, edhe si mjek, edhe si deputet, që të ngre dorën që është kundër vullnetit të popullit tim.

Lus kryetarin e Kuvendit, e lus Qeverinë e Kosovës, ministrat, që me të vërtetë, nëse pak mendojnë që t'i tërheqin këto amendamente dhe ne të bashkuar kështu t'i themi po miqve tanë ndërkombëtare, se jemi që të luftojmë të gjithë krimin, çka ka ndodhur në Kosovë, por atë ta bëjmë në institucionet tona, kështu u ndihmojmë edhe miqve tanë, kështu u ndihmojmë edhe

atyre, që ndoshta mendojnë e kanë supozime që është bërë krim. Por, krimi nuk është etnik. Gjenocidin e kanë kryer ata që nuk janë më këtu dhe jo ne.

Prandaj, prapë po e them, pa patriotizëm, por si qytetar i thjesht, ju lutem që të mos votojmë për një të keqe për vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Agim Çeku e ka fjalën.

AGIM ÇEKU: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Si njëri nga ish-shefat e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e ndjej për obligim edhe unë t'i them disa fjalë lidhur me temën, për të cilën bisedojmë dhe do ta them atë që mendoj unë, çka e ndjej unë e jo atë që ma ka thënë dikush apo që ka ndikuar dikush.

Dua të them më së pari, që pavarësisht se cili do të jetë epilogu i seancës së sotme, UÇK-ja është dhe do të mbetet vlera më e madhe që ka krijuar populli ynë, është liria dhe pavarësia e saj. Nuk ka proces gjyqësor, as të rëndomtë, as special, që mund ta zbehin kontributin historik që ka UÇK-ja, që tashmë është pjesë e lavdishme jo vetëm e historisë së Kosovës, por e të gjithë historisë së lëvizjeve për liri dhe pavarësi dhe drejtësi.

UÇK-ja është vlerë e paprekshme, sepse popullit tonë ia ktheu dinjitetin, popullit i dha kurajë, Kosovës i dha imazh, Kosovës i solli miq, partneritet të shumtë, Kosovës i solli lirinë dhe pavarësinë e saj. UÇK-ja është vlerë, sepse u tha edhe shumë herë, por dua ta përsëris, zhvilloi luftë të pastër dhe të drejtë. Të pastër, sepse luftoi vetëm kundër regjimit, luftoi vetëm kundër forcave ushtarake, paraushtarake, forcave policore të Serbisë dhe asnjëherë dhe në asnjë moment kundër qytetarëve civilë apo qytetarëve serbë të Kosovës.

UÇK-ja është e vetmja ushtri e luftërave të viteve të '90-ta që kanë ndodhur në këto treva, të cilës askush s'ka mundur t'ia mëveshti se ka kryer ndonjë masakër, që ka masakruar ndonjë familje civile, që ka djegur ndonjë fshat, e tjerë, e tjerë... bile, ua rikujtoj duke e ditur, duke e parë këtë karakter të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Serbia e bëri vrasjen e civilëve serb, të rinjve serb në "Kafe Barin" në Pejë dhe ia mëveshti kinse UÇK-ja "shihni karakterin e UÇK-së". Në fund doli se me këtë vrasje tregoi karakterin e vet, karakterin e luftërave të veta, se çfarë i ka bërë.

Me ushtrinë e UÇK-së nuk lidhet asnjë masakër. Me ushtrinë serbe lidhen shumë e shumë masakra. U përmendën të gjitha këtu, mos t'i përsëris, por kanë mbetur edhe shumë pa u përmendur. Andaj, askush nuk mund ta mohojë rolin kyç që ka pasur UÇK-ja në luftë, por edhe në ndërtimin e paqes, stabilitetit, demokracisë edhe në Kosovë edhe në rajon. Por fatkeqësisht, jo gjithmonë dhe jo nga të gjithë është vlerësuar si duhet dhe sa duhet ky rol i UÇK-së.

Kur po diskutojmë sot këtu për relacionin e UÇK-së dhe Gjykatës Speciale, më lejoni të them, që i gjithë relacioni i drejtësisë ndërkombëtare me UÇK-në, pas luftës ka qenë special dhe asnjëherë real, gjithmonë ka qenë special, gjithmonë ka qenë i nxitur, i ndikuar, i influencuar dhe i manipuluar nga Serbia. Këtë e dimë të gjithë dhe ky është fakt, me të cilin edhe sot po

ballafaqohemi. Edhe raporti i drejtësisë së UNMIK-ut ndaj UÇK-së edhe njerëzve të saj, nuk ka qenë krejt raport drejtësie. Të gjithë jemi dëshmitarë të proceseve të shumta të UNMIK-ut ndaj UÇK-së, produkt i të cilëve nuk ka qenë gjithmonë drejtësia.

Kosova asnjëherë dhe as sot nuk ka kërkuar privilegj dhe trajtim të veçantë nga drejtësia ndërkombëtare. Kosova vetëm ka kërkuar dhe do të kërkojë drejtësi të vërtetë, drejtësi reale dhe jo drejtësi speciale. Fatkeqësisht, as EULEX-i për të cilin kemi besuar se do të jetë më profesional dhe më real, nuk ka ndryshuar shumë në raport me qasjen dhe perceptimin ndaj UÇK-së dhe njerëzve të UÇK-së.

Aktgjykimi i para disa javëve, ku në shkallën e parë u dënua gjeneral Sylejman Selimi, komandanti i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjeneral Lushtaku, komandant i Zonës, dhe figura të tjera të UÇK-së na e provoi edhe një herë se raporti i drejtësisë ndërkombëtare me UÇK-në, vazhdon të mbetet special, siç ishin speciale dhe të çuditshme dënimet ndaj tyre.

Të nderuar deputetë,

Nga mënyra si janë zhvilluar ngjarjet, po shihet qartë se ky proces është më shumë politik, se sa i drejtësisë. Është edhe një çmim tjetër dhe një sakrificë tjetër, që po i kërkohet ta bëjë Kosova. A e meriton Kosova të paguajë këtë çmim të padrejtë dhe a është e gatshme ta bëjë këtë sakrificë? Kjo është çështje që shtrohet sot këtu.

Të gjithë po pajtohemi, edhe unë po pajtohem dhe po e them, se kjo gjykatë është e padrejtë dhe e panevojshme. E padrejtë, se një gjë e tillë nuk i është kërkuar asnjë populli dhe asnjë shteti në rajon dhe e panevojshme, sepse ne kemi sistemin tonë të drejtësisë, e kemi EULEX-in këtu që e ka mandat dhe ka përgjegjësi për trajtimin e të gjitha pretendimeve për krime lufte. Këtu po pajtohem. U tha sot edhe këtu, se ku po hyn Kosova, në qoftë se e votojmë këtë gjykatë. Dhe ishin shumë argumentuese ato të drejta, por ajo që mua po më brengos dhe ajo çka mungoi sot nga disa deputetë, nuk u tha se ku po mbetet Kosova, po që se nuk e votojmë këtë gjykatë. Ku po mbetet Kosova? Të gjitha këto që u thanë janë të sakta, po mungon përgjigja ku po mbetet Kosova, nëse nuk e votojmë. Dhe, kjo është ajo analizë, që unë e kam bërë vetë më vete dhe llogarinë që e kam bërë vetë me vete dhe, po del kështu.

Fatkeqësisht, jemi para një realiteti të krijuar politik, që jemi para një vendimi. A kemi mundur më mirë ta menaxhojmë? A kemi mundur të gjejmë kompromise? A kemi mundur ndryshe të bëjmë? A kemi mundur më shumë të bëjmë? Ajo është pyetje tjetër dhe pajtohem me shumë ata që thonë, se kemi mundur ndryshe ta bëjmë. Por, është fakt që jemi para një vendimi, është fakt që pretendimet e raportuara janë të rënda dhe janë bërë hipotekë dhe barrë e rëndë për Kosovën.

Mënyra e vetme për ta hequr këtë hipotekë është ballafaqimi me këto akuza të padrejta. Kjo hipotekë, fatkeqësisht, dhe këto akuza nuk mund të hiqen as me diplomaci, as me politikë, as me emocione, që u shfaqën këtu shumë reale dhe shumë të drejta dhe shumë të kuptueshme, as me fakte shumë bindëse, që u thanë këtu në seancë, por këto akuza mund të hiqen vetëm duke u ballafaquar me gjykatë dhe vetëm duke i sjell këto fakte, jo emocione, por fakte para kësaj gjykate.

Nëse, prapë po them, nëse nuk ka rrugë tjetër dhe nëse opsionet tjera janë më të rrezikshme, se sa kjo rrugë që e tha Ramushi, ku po hyjmë nëse e votojmë dhe, më të paqarta se kjo që kemi përpara, unë mendoj që nëse nuk e votojmë, pajtohem se ku po hyjmë nëse e votojmë, por jam i bindur, jam bindur vetë, jo që më ka bindur kryetari i partisë sime, apo kryetari i Parlamentit, jam bindur vetë, se nëse nuk e votojmë sot, Kosova ndalet. Ndoshta nuk kam të drejtë. Do ta dëshmojë koha a kam të drejtë, unë jam bindur. Kosova ndalet.

Për atë arsye, ne jemi të thirrur këtu që Kosova të eci përpara, të sakrifikojmë, në qoftë se jam edhe unë njëri prej tyre, unë po e them mendimin tim dhe ju ftoj të gjithëve të mendojmë një gjë të tillë. Mendoj që është interes. Çka më ka ndihmuar mua, pasi që po reagoni, që të mendoj kështu dhe ta bëj një analizë?

E dini kur kam hyrë në politikë, e dini qysh kam hyrë në politikë, por kur kam hyrë, një mik që ka ndikuar të hyj unë në politikë, më ka thënë: po hyn në politikë, politika është kështu, kështu, kështu... por, mendohu, janë dy lloj - tha - njerëz, që merren me politikë dhe, këtë e dini edhe ju. Janë politikanët dhe janë burrështetasit. Dallimi është shumë i madh në mes tyre, politikanët mendojnë vetëm për zgjedhjet e ardhshme, burrështetasit mendojnë për gjeneratat e ardhshme. Unë të mendoj kur ta bëj një analizë çka të vendos, të gjithë jemi para dilemave të tilla, po edhe po ju them për këtë, kam vendosur që të mendoj dhe të veproj, të mendoj për gjeneratat e ardhshme, jo për vete, mendoj për të ardhmen jo aq shumë për të kaluarën dhe ta votoj këtë gjykatë.

UÇK-ja asnjëherë nuk është fshehur dhe nuk është frikësuar nga e vërteta. Asnjë prej nesh, prej atyre që kanë qenë të akuzuar apo edhe neve që do të jemi të akuzuar, nuk kemi ikur, nuk jemi fshehur, por gjithmonë kemi treguar gatishmëri që të ballafaqohemi me fakte, në qoftë se... dhe gjithmonë kemi dalë fitues. Jam i bindur, jam i bindur edhe duke e ditur edhe këtë, se e drejta dhe e vërteta janë në anën tonë, unë do të jem njëri prej atyre që do të thotë të shkojmë, të ballafaqohemi dhe ta dëshmojmë drejtësinë, ta dëshmojmë pafajësinë tonë.

UÇK-ja, njerëzit e UÇK-së, u thanë këtu edhe u shantazhuan edhe disa të tillë, por gjithmonë para interesit të vet, edhe në luftë nuk është hyrë për interes të vet, është hyrë për interes të Kosovës, e ka pasur përpara vetes interesin e Kosovës dhe ne sot, pasi që jemi para një vendimi të tillë, pasi që jemi para një realiteti të tillë, a po i hyjmë një rruge të rrezikshme, në qoftë se votojmë, po, siç tha Ramushi, pajtohem me të, ishte shumë bindës, që po i hyjmë një rruge të keqe. Por, unë po e them këtë, ku po mbetet Kosova në qoftë se s'e votojmë? E kjo është brenga ime më e madhe.

Unë mendoj se po i jap një ndihmesë Kosovës, që Kosova të lëvizë përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Ramush, nuk të përmendi. Urdhëro!

RAMUSH HARADINAJ: E din qysh, është një dallim në mes burrështetasve dhe atyre që janë sipërfaqësorë. Burrështetasit janë në themel, në substancë, në përmbajtje të vendit të vet, Agim Çeku është sipërfaqësor.

KRYETARI: Faleminderit! Anton Çuni e ka fjalën.

ANTON ÇUNI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,
Zëvendëskryeministra,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Kosovës,

Çdo komb e ka historinë e vet, me të cilën krenohet, duke i vënë në pah vlerat që e madhështojnë atë. Pjesëtarët e atij kombi krenohen me të arriturat në shkencë, kulturë, sport, ekonomi, rend, ligj, e tjera...

Synimi i çdo kombi është që të gjitha të arriturat t'i arrijë duke qenë i lirë dhe të ketë mundësi që t'i shfrytëzojë të gjitha burimet njerëzore, ekonomike dhe intelektuale për të mirën e tij.

Mirëpo gjatë historisë ka pasur raste kur shtete apo kombe të ndryshme kanë synuar që të mirat për vete t'i arrijnë në dëm të kombeve dhe popujve të tjerë, duke i shtypur, robëruar dhe duke ua shfrytëzuar burimet e tyre ekonomike dhe njerëzore. Së këndejmi, edhe gjakimi i popujve dhe kombeve të shtypura për të fituar lirinë dhe për të zhvilluar në të gjitha aspektet.

Prandaj, është vlerë e çdo kombi gatishmëria për të fituar dhe mbrojtur lirinë. Por, kjo vlerë e ka çmimin e lartë, sepse arrihet me luftë, gjakderdhje, viktima, shkatërrime, dhunë, trauma, djegie, shpërngulje, skamje e tjera.

Në duar të protagonistëve të luftës, dijetarëve, analistëve, politikëbërësve mbetet të krijojnë opinion për motivin, qëllimin dhe suksesin e luftës në të gjitha fazat e zhvillimit të saj.

Jo të gjithë, i kanë vlerësimet e njëjta. Por sidoqoftë krijohet një opinion i përgjithshëm.

Edhe për luftën tonë në vitet 1988-1999, qëndron një vlerësim i përgjithshëm se ishte luftë çlirimtare, e drejtë dhe e domosdoshme dhe si mundësi e fundit për të fituar lirinë. Dhe, nga popujt liridashës dhe miqtë tanë lufta jonë u cilësua si e tillë, prandaj edhe na qëndruan afër me kapacitet politike, ushtarake, diplomatike, humanitare e tjera.

Besoj fuqishëm se rezistenca e popullit shqiptar në Kosovë, që e arriti kulmin në luftën në mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave policore-ushtarake të Serbisë, e vërtetoi edhe një herë bindjen se ne jemi popull liridashës, paqësor, fisnik, i qytetëruar por që dimë edhe të luftojmë kur ajo është e domosdoshme.

Kjo është vlerë e kombit tonë, që mua më bën të ndjehem mirë. Kujtimet më të fuqishme i takojnë asaj kohe kur bashkëluftëtarët e mi ishin familja ime e dytë.

Ne edhe sot i kemi lidhjet e veçanta shpirtërore, që janë më të fuqishme dhe më të singërta se cilado lidhje tjetër. Në atë kohë, ne kishim dallime të vogla ndërmjet vete, në kuptimin e moshës, edukimit, ideologjisë, traditave lokale e tjera, por, në shënjestër të armikut ne ishim të njëjtë.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, cilësohet si një ndër ngjarjet më madhështore të kombit tonë. Prandaj, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me tërë atë madhësi i nënshtrohet një vlerësimi të përgjithshëm në të gjitha dimensionet e saj dhe nga shumë këndvështrime të ndryshme e në disa

raste për qëllime të caktuara. Për luftën tonë, për sakrificën tonë, vlerësim kanë dhënë edhe humbësit e luftës, forcat serbe. Dhe, ndër konotacionit që ia jepnin luftës sonë, ishin epitete të tilla, si: terroristë, kriminelë, fundamentalistë e tjera.

Pavarësisht këtyre etiketimeve, forcat serbe e përjetuan rënd luftën tonë dhe gatishmërinë tonë për të luftuar deri në vdekje për lirinë e vendit dhe popullit tonë.

Edhe pse të shumta në numër, edhe pse me armatim shumë më të fortë forcat serbe nuk arritën që të kenë motivimin dhe vullnetin për luftë, siç e kishim ne, sepse ata bënë luftë pushtuese, luftë që shtypte, vriste dhe masakronte një popull të pafajshëm që jetonte dhe donte të jetojë në shtëpitë e tyre, në vendin e tij, kurse ne luftonim për ta mbrojtur popullin tonë, për ta çliruar vendin tonë, për të fituar lirinë.

Për këtë arsye, forcat serbe u mposhtën edhe me ndihmën e aleatëve tanë të NATO-s, të cilët e vlerësuan të drejtë lufton tonë për liri dhe na ndihmuan që këtë liri ta fitojmë sa më shpejt dhe me sa më pak viktima e dëme.

Forcat serbe e humbën luftën, kurse ne bashkë me popullin filluam të rindërtojmë vendin dhe t'i vëmë bazat e lirisë, të pavarësisë dhe të demokracisë.

Mirëpo, edhe pse e humbën luftën, serbët nuk e ndalën përpjekjen për të fituar betejën diplomatike. Atë që e kishin humbur në terren duan ta fitojnë në tavolinën diplomatike, ashtu siç ka ndodhur edhe herëve të tjera.

Historia e jonë është e mbushur me lufta të shumta, me fitore të shumta në luftë, por që i humbim në tavolinën diplomatike. Dhe kjo ndodhte për shkak se ne nuk dinim si t'i ruanim fitoret në luftë, pasi që nuk kishim ndonjë traditë të mirë në fushën e politikëbërjes dhe të diplomacisë. Edhe luftërat i bënim shpesh pa ndonjë strategji dhe platformë të qartë se si të arrinim fitore në luftë dhe si ta mbronim në tavolinën diplomatike.

Për shkak të këtyre, ne në shumë raste nuk mund të përcaktonim as pozicionin e duhur gjeopolitik e gjeostrategjik, e së këndejmi edhe nuk mund të krijonim aleanca të qëndrueshme, me fuqi të ndryshme evropiane dhe botërore.

Po ashtu, edhe ndonjë aleat që mund ta kishim, ndodhte që të mos ishte në kushte për të na ndihmuar, për shkak se kishim mundësi të kufizuara politiko-ushtarake.

Historia e jonë e viteve të '90-ta të shekullit të kaluar, është historia jonë e ndërtimit të një diplomacie moderne dhe e aleancave të forta euroatlantike. Pozicionimi ynë në boshtin gjeopolitik euroatlantik përkatësisht Bruksel - Uashington, ka qenë pozicionimi ynë më i mirë dhe i duhuri i bërë ndonjëherë që nga koha e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Mbi këtë bazë ne fituam betejën diplomatike me Serbinë dhe e fituam edhe betejën ushtarake.

Megjithatë, ne sot jemi para një sfide të re dhe shumë të veçantë, e që është sfida që na është imponuar në kuadër të angazhimeve të faktorëve të shumtë, e që kanë të bëjnë me disa dyshime për disa vepra të supozuara e të cilat i kanë ngritur disa euro-deputetë.

Edhe pse Serbia dhe ndonjë aleat i saj ka synuar dhe synon të njollosë luftën tonë për liri si dhe imazhin tonë në sy të opinionit ndërkombëtar, megjithatë Gjykata Speciale është menduar dhe është projektuar si vendi ku do të ballafaqohen faktet dhe argumentet.

Akuzat e ngritura nga euro-deputetët që rëndojnë dhe vënë në dyshim pastërtinë e luftës dhe popullit tonë, për ne dëshmitarët e ngjarjeve janë të papranueshme dhe shpifje të ulëta.

Lufta e një populli për lirinë e tij nuk mund të jetë luftë tjetër pos luftë për liri dhe për të vë në vend të drejtën e tij për të jetuar si të gjithë popujt tjerë të lirë dhe të zhvilluar dhe në fqinjësi të mirë me fqinjët në rajon, si dhe me popujt tjerë të lirë në botë.

Edhe pse këto akuza kanë hedhur fije dyshimi për luftën tonë, në opinionin e vendeve demokratike ne duhet të dëshmojmë se ato akuza nuk kanë kurrfarë baze reale dhe nuk mund ta njollosin luftën tonë.

Të bindur se lufta jonë për liri është e drejtë, e pastër dhe e panjolllosur, edhe aleatët tanë që na kanë ndihmuar në luftën tonë kërkojnë nga ne që t'i japim një mundësi drejtësisë për të vërtetuar pastërtinë e kësaj lufte.

Gjatë kësaj kohe, bashkësia ndërkombëtare ka punuar me ne në mënyrë që ta kuptojmë rëndësinë e kësaj gjykate, si për pastërtinë e luftës sonë, ashtu edhe për pozicionin tonë diplomatik dhe për imazhin tonë në përgjithësi.

Prandaj ne sot i kemi dy mundësi: të pranojmë apo ta refuzojmë gjykatën speciale.

Duke qenë i bindur në pastërtinë e luftës dhe sakrificës sonë, duke qenë i bindur në fitoren tonë edhe në këtë gjykatë, ashtu sikur që kemi fituar edhe në Tribunalin e Hagës, duke qenë i bindur se do ta forcojë lidhjen dhe mbështetjen e aleatëve tanë, unë jam i gatshëm që të ballafaqohem edhe me Gjykatën Speciale.

Në anën tjetër, shmangia nga përgjegjësia, nga ballafaqimi me akuza të ngritura, që do të trajtohen nga Gjykata Speciale, nga mungesa e guximit ushtarak dhe njerëzor e që vetëm sa ngrit dyshimin dhe bindjen se lufta jonë për liri është luftë kriminale dhe rrezikon që edhe ushtria jonë – Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të konsiderohet si formacion kriminal.

Unë si pjesëtar i kësaj lufte dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund ta pranoj një gjë të tillë, as për veten e as për bashkëluftëtarët e mi, as për ata që nuk janë në mesin tonë. Por, një arsye tjetër, po ashtu shumë madhore, është që duke e pranuar sfidën ne e përmirësojmë imazhin tonë, imazhin e vendit tonë, përmirësojmë perspektivën euroatlantike të vendit tonë, kurse duke e refuzuar sfidën ne i dëmtojmë të gjitha këto dhe kjo nuk na bën nder as si njerëz, as si ushtarakë dhe as si popull.

Pra, nuk është e vërtetë se duke refuzuar Gjykatën Speciale, ne e mbrojmë kombin dhe ushtrinë tonë. Kombin dhe ushtrinë tonë ne e mbrojmë vetëm kur të tregohemi të ndërgjegjshëm dhe të përgatitur për të pranuar faktin se si në çdo luftë tjetër në botë edhe në luftën tonë mund të ketë individ që mund të kenë bërë tejkalime të autorizimeve. Tejkalimet e tilla kanë ndodhur edhe nga ushtarët e ushtrive më moderne në botë, të angazhuara në misione dhe lufta të ndryshme. Në çdo luftë, në çdo ushtri dhe në çdo vend ndodhë që në momente të caktuara ushtari të ndajë vetë drejtësi duke shpërfillur konventat ndërkombëtare si dhe zakonet e luftës.

Mirëpo, ato i trajtojnë dhe ndëshkojnë rënd rastet e tilla, pa u shkuar nëpër mend se në këtë mënyrë njolloset lufta e tyre. Ata janë raste individuale dhe nuk kanë të bëjnë fare me trajtimin kolektiv të formacioneve ushtarake të shteteve apo të grupeve të ndryshme shoqërore.

Prandaj, deri sa edhe në ushtritë dhe në shtetet e organizuara dhe të konsoliduara demokratike ku përzgjedhja, komandimi dhe kontrolli, disiplina ushtarake dhe profesionalizmi ushtarak, është në shkallë shumë të lartë, ka raste të tejkalimit të autorizimeve nga ana e ushtarëve apo eprorëve, kështu që bashkësia ndërkombëtare po kërkon nga ne që të ndjekim shembullin e tyre dhe t'i trajtojmë ligjërisht rastet e supozuara.

Bashkësia ndërkombëtare e di se ne nuk i kishim as mundësitë dhe komoditetin që të rekrutoni dhe të përzgjidhni në përputhje me standardet më të larta ushtarët tanë. Ne u mobilizuam dhe vepruam në kushte lufte, në shumë raste edhe pa u stërvitur fare dhe me njohuri të pakta ushtarake.

Përkundër këtyre, bashkësia ndërkombëtare ka vlerësuar lart faktin se në kulturën tonë, në besimin dhe traditën tonë janë thellë të ngulitura normat morale si vlerë e kombit tonë, e së këndejmi edhe si vlerë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, bashkësia ndërkombëtare e ka vlerësuar jo vetëm luftën tonë por edhe të gjithë traditën dhe vlerat pozitive që bartim si popull, sepse kanë qenë këto vlera që kanë bërë që të bëjmë kaq të pakta gabime, apo më pak gabime se ushtritë e rregullta të shteteve të organizuara dhe të konsoliduara demokratike. Prandaj, edhe trajtimi i rasteve individuale nuk mund të ndikojë fare, qoftë në cenimin dhe pastërtinë e luftës sonë, qoftë edhe në dëmtimin e imazhit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rastet e veprimeve të ndryshme të ushtarëve tanë janë të vogla dhe të papërfillshme, prandaj edhe nuk janë raste për t'u shqetësuar dhe për të ngritur frikën për njollosjen e luftës sonë dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në konceptin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ka qenë gjenocidi, pastrimi etnik, dëmtimi i popullatës civile, shkatërrimet në masë e tjera. Në konceptin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë lufta çlirimtare, mbrojtja e popullatës civile dhe pasurisë së njerëzve, e që i ka zbatuar në mënyrë shembullore.

Gjenocidi, pastrimi etnik, dëmtimi i popullatës civile dhe shkatërrimi në masë kanë qenë veçori të luftës pushtuese serbe.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Frika nga gjykimi i popullit duhet të jetë më e madhe se frika nga cilado gjykatë. Ne kemi tradita autoktone. Po këto tradita e kanë ruajtur identitetin tonë kombëtar.

Një veçori që desha ta theksoj në mënyrë të veçantë është kërkim falja, e cila është e ngulitur thellë në traditën tonë. Po e theksoj këtë si mundësi njerëzore, fisnike dhe burrërore që të gjithë ata që kanë problem me ndërgjegjen që padrejtësisht i kanë bërë dëm dikujt ose e kanë bërë të vuajë emocionalisht dhe fizikisht - të kërkojnë falje. Jam shumë i bindur se shumica e tyre do të falen.

Paqja e brendshme është goditja më e fuqishme për ata që e humbën luftën në fushëbetejë dhe që e duan fitoren në tavolinë. Paqja e brendshme do të thotë se Gjykata Speciale të mbetet pa materie.

Në këtë mënyrë ne jemi mirë me njëri tjetrin, me miqtë tanë që na qëndruan besnikë gjatë gjithë rrugëtimit, ashtu siç do të jemi mirë edhe me drejtësinë ndërkombëtare, e që janë garanci më të fuqishme për zhvillimin e shtetit tonë dhe për ndërtimin e jetës më të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Aida Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Të nderuar qytetarë dhe deputetë të Republikës së Kosovës,

Përpjekja për të trajtuar drejtësinë mbi paradigmen e paqes dhe stabilitetit nuk është asgjë tjetër përveç se politikë. Përgjashtimi i drejtësisë ndodhë duke e politizuar atë e që për pasojë ka paqen e rrejshme dhe stabilitetin e paqëndrueshëm.

Për më tepër një qasje e tillë në drejtësi është inkurajim për fajtorin.

Tribunali i Hagës për Krime Lufte në ish -Jugosllavi nuk bëri cilësim për palën ndërluftuese. Në asnjë rast nuk përcaktoi agresorin dhe viktimën, nuk dalloj luftën e drejtë prej luftës së padrejtë, nuk mori parasysh as bilancin e dëmeve dhe përmasat e krimit edhe pse të tri luftërat patën emërues të përbashkët Serbinë.

Shteti i Serbisë në asnjë rast nuk u akuzua për gjenocidin e kryer në Bosnje dhe në Kosovë. Shumica prej nesh janë dëshmitarë të përmasave të krimeve të kryera nga Serbia. Megjithatë, Serbisë i është besuar përndjekja e krimeve të luftës. Prokuroria e Serbisë për Krime Lufte ka trajtuar raste të krimeve të saj gjatë tri luftërave, në Kosovë, Bosnje dhe Kroaci, me ç'rast ka ngrehur gjithsej 51 akuza lidhur me vrasjen e 4 330 civilëve e që përfshin 175 të akuzuar. Merreni me mend i ka vetëm 51 aktakuza, e ka me dhjetëra mijëra krime të kryera.

Deri më tani janë dënuar 68 persona. Raporti i dënimit me numrin e vrasjeve të kryera i bie përafërsisht 1 vit burgim për 5 vrasje të kryera.

Sa i përket luftës në Kosovë, Prokuroria e Serbisë për Krime Lufte ka ngrehur 6 aktakuza kundër serbëve dhe 3 ndaj shqiptarëve. Janë gjithsej 23 serbë të akuzuar për 111 vrasje të shqiptarëve.

Njëkohësisht 3 aktakuza tjera që përfshijnë 19 shqiptarë të akuzuar shpërfaqin tendencën për barazim të krimit.

Nga 11 mijë e 840 civilë shqiptarë të vrarë, në mesin e të cilëve janë edhe 1.392 fëmijë, mjaftuan akuzat vetëm për 111 vrasje, apo 1% e numrit total të vrasjeve, për t'i duartrokitur Serbisë dhe për t'ia hapur rrugën e integritit në Bashkimin Evropian. Ndërkohë që nuk ka as edhe një aktakuzë të vetme për dhunimet seksuale të mbi 20 mijë grave dhe vajzave, në mesin e të cilave pati edhe shumë të mitura. E kjo është edhe një arsye më shumë që kjo gjykatë të mos votohet.

Për hir të vuajtjeve të këtyre grave dhe vajzave të dhunuara, të cilave nuk u lejohej dhe nuk do t'u lejohej të kërkonë drejtësi në këtë gjykatë, ju ftoj Vjosë, Florë, Salë që mos ta votoni.

Tendenca për t'i barazuar palët në krim, është padrejtësi. Viktimës nuk i besohet as ndarja e drejtësisë duke e vlerësuar si të paaftë për të gjykuar. Prandaj, në vazhdimësi kompetencat i patën misionet ndërkombëtare.

Para disa javësh patëm rastin të shohim dënimin e grupit të Drenicës, me 65 vjet burg për vrasjen e një njeriu që nuk i dihet as emri, as familja e as varri. E ky është indikacioni se çfarë dënimesh do të shqiptohen në Gjykatën Speciale, e cila do të merret ekskluzivisht me pretendimet në raportin e Dik Martit. Drejtësia e cila fillon prej viktimës është krim i radhës, prandaj ju ftoj që të mos e votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Bali, fjala është juaja.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë sapo e mora një kërkesë nga një qytetar dhe kam obligim që ta lexoj para juve, që është:

“Kërkesë nga Sami Kryeziu, qytetar nga Suhareka, dhe propozon që fjala nga deputetja Luljeta e harruar në foltore që lufta e UÇK-së ka qenë e pastër, të arkivohet pikërisht në foltoren e Parlamentit të Kosovës dhe të qëndrojë derisa është jeta me jetë. Faleminderit!

Nuk kam asnjë pikë dyshimi që ne sot po diskutojmë për një çështje shumë të ndjeshme dhe ndër më të rëndat që kur Kosova e ka shpallur subjektivitetin e vet shtetëror.

Sot, ne jemi para një sfide me pasoja fatale që qeveritë e papërgjegjshme të Kosovës na sollën vrage. Ne dhe bota demokratike me kohë e kemi dhënë përgjigjen se krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, shkatërrimet, dhunimet dhe vrasjet në përmasa gjenocidiale në Kosovë i ka kryer aparati shtetëror serb.

Sot, të nderuar deputetë, jemi para një situatë ku kemi vetëm dy zgjidhje. E para, që ne me votën tonë të marrim mbi supë një barrë të rëndë historike, për të cilën do të mbahemi mend gjatë gjithë kohës dhe do të gjykojemi nga brezat e ardhshëm apo ta refuzojmë krijimin e kësaj gjykate dhe të vihem në mbrojtje të dinjitetit të luftës sonë çlirimtare.

Me qëllim që të jemi ballëhapur para popullit dhe brezave që vijnë, të dashur kolegë, mendoj se ne duhet të zgjedhim të dytën, ngjashëm sikur që e kishim zgjedhur rreshtimin tonë në mbrojtjen e qenies tonë kombëtare gjatë viteve 1998-1999.

Si deputet, që vi nga komuna e Therandës, s'mund t'i harroj masakrat që u bënë atje, si kudo në Kosovë. Masakra në familjen Berisha. Familja Berisha nuk i numëron 20 anëtarë, as 100, por familja Berisha i numëron përmbi 2 mijë anëtarë. Po ashtu e kemi masakrën edhe në fshatin Tërnjë, masakrën në fshatin Leshan, Savrovë, Bukosh, pastaj dhunimet dhe torturat në Dragaqinë. Paramendoni, në Dragaqinë i kanë mbushë bunarët me njerëz të gjallë. Nuk di a po donë ta barazojmë krimin dhe viktimën, apo duhet t'i dallojmë çka është krimi dhe çka është viktima.

Jemi ende në plagë të harruara të qytetarëve dhe ata po vuajnë ende. Vota jonë pra kësaj gjykate do të jetë votë kundër sovranitetit të shtetit, kundër rendit juridik dhe kushtetues, kundër sistemit unik gjyqësor dhe prokurorial, kundër rolit dhe mandatit të Gjykatës Kushtetuese, kundër Institucionit të Avokatit të Popullit. Me një fjalë, vota e tillë është kundër përpjekjeve sublime të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi.

Momentet e tilla ku vihet në sprovë integriteti dhe dinjiteti i deputetëve, ku vota e deputetit lë gjurmë në historinë e vendit tuaj, janë shanse të rralla që përballen përfaqësuesit e popullit.

Andaj, të dashur kolegë, shfrytëzoheni këtë rast të dëshmoni se jeni në mbrojtje të integritetit, sovranitetit dhe vlerave të popullit që me votën e tyre ju kanë dhënë besimin juve.

Unë personalisht, si deputet i Parlamentit të Kosovës, si ish-ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk do ta votoj dhe do të jem kundër kësaj gjykate. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: I nderuar, kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Këto ditë kush më shumë e kush më pak për një kohë të gjatë kemi debatuar, diskutuar, kemi paraqitur argumente tona, opinione, qëndrime individuale, partiake e politike, sidoqoftë rreth ndryshimeve kushtetueseve të cilat janë ofruar në Kuvendin e Kosovës.

Po ashtu, sot këtu dëgjuam fjalë të ndryshme nga deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe unë ju kisha preferuar ta ktheni edhe një herë fjalimin e kolegut tonë, Glaukut, vazhdimisht, se edhe një javë për të folur, ajo është përmbledhja dhe zemra e krejt kësaj për çka po flasim ne dhe për çka jemi mbledhur sot. Mirë është ta marrim si shkrim dhe ta shohim në fakt një fotografi të qartë ku jemi dhe për çka po flasim ne këtu, çfarë obligime kemi, kë e përfaqësojmë ne këtu dhe çfarë pasoja e çfarë dëme mund t'i sjellim vendit nga kjo.

Dëgjova pjesëtarë, ish- bashkëluftëtarë të mi dhe deputetë, kolegë, me fjalë të cilat edhe unë nëse më pyesni, të njëjtat fjalë i them sikur ata, s'është me rëndësi ata a janë për a kundër për këtë

çështje që vjen, domethënë, rreth Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rreth bashkëpunimit. Krejt janë ato njëjtë dhe s'dua t'i përsëris.

Po këta, po e harrojnë një gjë. Nuk është duke u folur këtu e për të bërë gara e për të folur kush më mirë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Edhe kush këtu s'e merr parasysh. Ne mundemi ta lëvdojmë njëri-tjetrin në dash në çifteli, në sharki e në fjalime pa ndalur dhe për të kallëzuar kush ka qenë UÇK-ja dhe çka ka bërë UÇK-ja.

O njerëz, këtij vendi po i kërkohet diçka tjetër. Nuk ka nevojë ne përmes televizionit t'u tregojmë qytetarëve të Kosovës, kush po vrapojmë më tepër për t' i treguar vlerat e luftës sonë çlirimtare. Ne jemi deputetë të këtij Parlamenti, e kemi një përgjegjësi dhe para nesh kemi vendimet tona individuale, vendime që kanë për të na ndjekur në tërë jetën tonë.

E kemi pasur fatin ose fatkeqësinë, sido që të llogaritet, kushdo qysh ta shohë. Po me këtë kemi për t' u ballafaquar sa të kemi jetën. Dhe, asnjëherë më Kosovës nuk do t'i vijë, shpresoj dhe s'mund t'i vijë më keq, asnjëherë s'ka për t' u sfiduar Parlamenti i Kosovës, qysh do të sfidohet sot dhe qysh është duke u sfiduar sot.

Prandaj, këtu nuk është garë, këtu nuk është politikë, se diku ndjeva, thanë për të mos u bërë burrshtetas dhe politikan. Dëgjova, më duket ishte Agimi, nëse s'gabo. O burrshtetas është ai që s'mendon për karrigen e vet, e mbron interesin e vendit dhe e mbron sovranitetin e shtetit. A ka a s'ka kjo vend, do ta shohim në fund.

Kjo ka për të na përcjell, të nderuar miq, dhe prandaj këtu secili individualisht duhet të merret, të flas me ndërgjegjen e vet dhe të vendosë. Ama, arsyetimet duhet lënë me një anë, pasojat do t'ju demantojnë. Nëse i marrim e nëse i futim miqtë ndërkombëtar, për t'i qitur para veti e për t' u fshehur vetë mbrapa, le që është hipokrizi, është marri, s'është partneritet. Bile ata qeshin me neve, thonë: po çfarë të dashur bre këta për neve, kur s'e donë vendin e vet. Këta kaq lehtë e hëngrën sovranitetin e vendit të vet, po këta bre kanë për të bërë hajgare me neve si të dalë ndonjë më i fortë.

Ne duhet ta ndalim këtë logjikë të komunikimit, duhet ta ndërprejmë këtë logjikë të funksionimit. Të flasim si deputetë, e qysh është, me bindjet tona. Ne edhe mund të gabojmë, por të paktën jemi me bindje tona. Të flasësh një orë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për vlera, për luftën për krejt, të flasësh për të gjitha ato masakra të Serbisë dhe në fund të themi , jo vëlla po e votoj, çka jeni bre duke thënë? A ka bre hipokrizi më të madhe për t'i përmendur, krejt po thua i di, por qe vetëm s'kam qare pa votuar se po më thonë. Çfarë deputetë bre jemi ne?

A e dini miq që ne sot çka jemi duke diskutuar këtu, jemi në tentativë të shkeljes së Kushtetutës. S'kemi bre të drejtë ta diskutojmë këtë çka e kemi, s'kemi legjitimitet, s'kemi mandat. U fol aty, Gjykata Kushtetues. Lini këto, kjo masakër që është duke iu bërë këtij vendi kushtetues dhe juridik, se Gjykata Kushtetuese s'ka pasur të drejt për ta prurë këtë hiq. Gjykata Kushtetuese interpreton, nuk shkruan Kushtetutë. Ne kemi 2 nene të reja që po na vijnë për t' i votuar e që e suprimon krejt Kushtetutën çka ka.

Dy gjëra duhet t'i ndajmë dhe më erdh mirë që e pashë një vullnet nga të gjithë deputetët, e kjo është e mira që duhet ta çojë gjithmonë Kosova, mesazhin: Po, ne jemi për hetimin, dyshime, hetime, procedim e gjykim të gjitha krimeve ose dyshimeve të pretenduara nga kushdo që janë bërë në vend.

Ky duhet të jetë mesazhi i Kosovës, pa dallim, duhet të jetë konsensus nacional, ama për të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë.

Ne jemi për të gjetur alternativa, për të ndërtuar mekanizëm kredibil i cili do të adresonte, do t'i hetonte, procedonte dhe gjykonte të gjitha pretendimet e mundshme që shfaqen. Me kaq Kosova e kryen obligimin e vet. Ulemi, e gjejmë mekanizmin.

Në çështje të tilla, të nderuar miq, duhet konsensus. Në çështje të tilla, të nderuar miq, Kosova e ka pasur një traditë të ndërtimit të konsensusëve në momente të caktuara. Kjo çka ka ndodhur në muajt e fundit, krijimit të grupeve politike, teknike, bisedime jo transparente, të ashtuquajtura negociata, këto e dëmtojnë dhe e kanë dëmtuar seriozisht një traditë që e kemi ndërtuar në të kaluarën.

Kjo e ndan shoqërinë, mos harroni, pavarësisht votave tona qysh janë, nga sot Kosova nuk do të jetë njëjtë. Ky nuk është një projektligj, as s'do të votohet një qeveri, as s'do të votohet një president, që mund të kemi pajtime a mospajtime. Jo.

Ne, sot do ta fusim vendin tonë në të panjohura. Dhe kushdo që thotë kështu do të bëhet e ashtu do të bëhet, ai është ose naiv ose gënjen. Ne jemi duke u futur në vende të panjohura, pra ekspertët e dinë çka po flas.

Ne i kemi lexuar këto amendamente dhe ai projektligji që do të vijë, tërësisht jemi duke u futur në një diçka të panjohur për vendin tonë. Ne jemi duke e futur vendin tonë e nuk e dimë kur do të dalim.

Po më vjen keq, nuk është këtu ministri i Jashtëm. Tha, do të zgjatë nga 3 deri në 5 vjet kjo farë pune. Po pak më vonë, harroi, tha janë duhet dhanë nga 500 milionë për këtë punë. Imagjinoni, 500 milionë ai grupi vetëm t'i harxhojnë parat, s'mund t'i harxhojnë për 5 vjet. 500 milionë euro s'harxhohen për 5 vjet veç të harxhojë hiq mos të bëjë kurrgjë. Parat s'mund t'i harxhojnë gjithë ditën, parat nuk harxhohen për 500 milionë për 5 vjet e le më proceset gjyqësore. Po a e dini bre çka janë proceset gjyqësore?! Drejtësia nuk funksionon ashtu.

Ne do t'ia ngremë këtij vendi minimum nga 20 vjet një barrë. U tha nga kolegët, e edhe unë dua ta përsëris dhe këtë duhet ta themi, të gjithë bashkë, pavarësisht a pajtohemi apo s'pajtohemi në qeverisje, pavarësisht a pajtohemi a s'pajtohemi që kemi kryetar Kuvendi, zotin Veseli dhe ministrat që i kemi këtu, kjo temë është krejt tjetër. Ama, unë dua që Kuvendi, vendi im ta ketë një kryetar të fuqishëm. Unë dua ta ketë një kabinet të fuqishëm vendi im, jo të jetë i cënueshëm nga kushdo dhe kurdo. Ne punojmë përditë që këtë Qeveri sa më shpejt ta çojmë në shtëpi. Po Kuvendi duhet ta ketë kryetarin i cili është i pacënueshëm, Qeveri të pacënueshme, të pashantazhuar.

Nga sot e tutje nuk do të jeni kështu, nëse shkojnë këto ndryshime me amendamente. Parlamenti i Kosovës po ia heq vetes kompetencat për të ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare. Ne, sot me dorën tonë jemi duke i bartur pjesë të kompetencave tona te një individ, s'e di kush është. Dhe ai individ do të vendosë marrëveshje ndërkombëtare në lëmin e drejtësisë në emër të Kosovës me të gjitha vendet e rajonit, dhe Parlamenti i Kosovës as nuk njoftohet, as nuk pyetet.

Çdo gjë në marrëveshje që arrin, është obligative sepse ia kemi dhënë me këto ndryshime kushtetuese, nëse i votojmë.

Tash po ia bëj një pyetje veti. Po mirë, krejt pajtohem, retë e zeza, retë e bardha, retë e kuqe, çfarëdo qofshin... po pse bre po i kërkon këto sende? Pse po e prekni sovranitetin? Sovranitetin pse? Pse po na e bëni sistem dualist? Çka po u duhet bre Gjykata Kushtetuese? Çka po ju duhet prokurori që ia merr kompetencat Parlamentit? Ombudspersoni.

Andaj, përtej këtyre është mirë, dhe nuk u tha rastësisht, që secili deputet me ndërgjegje të veten duhet të vendosë.

Kjo që na kanë thënë të huajt dhe na kanë bërë presion të huajt, veç sot ka efekt. Nesër ata do të thonë, e keni bërë vetë. Sot po, deri të votohet, por prej nesër thonë ky është vendim i një institucioni të ligjshëm të Parlamentit të Kosovës, i zgjedhur nga qytetarët e Kosovës dhe këta vetë e kanë bërë, këta kanë obligime.

Ata që thonë, po jo, duhet bërë ne se përndryshe do ta bënit ju. O po të kishin mundur ta bënin , s'na kishin pyetur. Mendoni që ishim ardhur ne këtu ta debatojmë këtë punë? Asnjëherë. Ishte kryer kjo punë.

Duhet të jetë gjithëpërfshirëse, Gjykatë gjithëpërfshirëse. U përmendën këtu, prandaj tash edhe duhet lexuar pjesë të fjalimit të Glaukut, po pati edhe nga tjerët. Qindra masakra. Veç në 1998 janë 75 masakra që as Serbia nuk i heton e as s'i ka hetuar Haga. Kurrë s'ka për t'i hetuar, sepse për Serbinë konflikti ka filluar edhe për Hagën, me ligj në Hagë është më 1 janar 1999. Çka ka ndodhur para 1 janar 1999 nuk është pjesë e trajtimit të Hagës.

Shikoni, ne po futemi në një situatë që do të ketë pasoja të mëdha për vendin dhe ata që e votojnë këtë çështje do ta bëjnë një ndarje të madhe të vendit. Bile këtu s'qenka komuniteti serb. Kjo mënyrë dhe kjo qasje do të jetë e dëmshme edhe raportet etnike të cilat kanë pas nisur të konsolidohen e të relaksohen.

Po na ktheni në një situatë krejt tjetër me këtë mënyrë të logjikës, sepse këtu po shihet se diku po i bëhet e padrejtë. Këtu ashikare po shihet që një padrejtësi e madhe është duke ndodhur. Prandaj, si e tillë ajo nuk mund të anashkalohet.

I nderuar kryetar i Parlamentit, po të drejtohem me emër, duke u thirrur në të kaluarën tonë të përbashkët, por s'është edhe Hashimi, po ju drejtohem juve që jeni drejtues të institucioneve. Po them, po ju drejtohem me emër për shkak të afërsisë së të kaluarës të përbashkët që e kemi pasur.

Nuk kam pasur dëshirë, kemi mospajtime, s'pajtohemi në shumë sende, pavarësisht këtyre, por asnjëherë s'kam pasur dëshirë t' ju shoh në këtë pozitë dhe në këtë moment në këtë situatë dhe gjendje sot, të shtrohet kjo çështje kështu, nga pozita e kryetarit të Kuvendit. As e Hashimit nga pozita e zëvendëskryeministrit. Krejt disi përballohen, ne do të bëjmë luftë politike, s'do të ndalemi, e s'pajtohemi, unë mendoj sa më shpejt të shkojë kjo Qeveri, e krejt, po këtu s'kam pasur dëshirë asnjëherë t' ju shoh.

Nëse kthehemi atje, po them, nëse ka mbetur të ktheheni në kujtesë atje, kthehuni dhe shikoni. Tjerat krejt kanë qenë më vështirë se sa keni qenë ju. Çdo gjë ka qenë më vështirë se për t'i i thënë kësaj jo, sot. Dikush tha, po s'po na thotë kurrkush të mos votojmë çka po thotë Kosova. Për një besoj pajtohemi: më keq Kosova s'ka ku shkon. Llom është. Jam i sigurt, veç më mirë.

E kemi një moment historik për ta bërë një pikënisje dhe t' u themi këtyre miqve që janë kah na vijnë dhe na vijnë veç kur e kanë ndonjë agjendë të tyre të na shtyjnë e jo për festat tona, e keni parë. Të themi prej sot s'ka më vardisje e stabilitet, jemi të gatshëm për partneritet. Mos na paragjykoni, partneritet, partneritet, sepse na keni lënë një vend ishull izoluar, pa liberalizim, pa asnjë gjë, pa asnjë përfitim. Pesë vjet bisedojmë me Serbinë e përqaftimi, asnjë gjë s'e kemi përfituar...

Pra, ta nisim një lloj partneriteti me miqtë tanë. Unë ju ftoj, se ende ka kohë, kolegë ju ftoj dhe në mënyrë të veçantë ju ftoj juve drejtues, sepse në fund të fundit ju e keni përgjegjësinë kryesore, ende ka kohë për ta ndalë këtë të keqe të madhe për vendin, për t'u ulur e për të provuar ta gjejmë një solucion i cili nuk prek sovranitetin e shtetit. Dhe me atë solucion t' u dalim miqve ndërkombëtar.

Nëse vazhdohet kështu, nëse nuk e shikoni këtë frymë, por keni matematika tjera, më besoni se po futeni ... matematikat do t'u bien. Kryetari i Parlamentit, zoti Veseli e di mirë qysh jam trafikuar unë kur kam shkua në Hagë. S'ka më ashtu për të luajtur me njerëz. Dikush s'mund të bartë, mos luani me njerëz. Uluni, e bisedoni.

Këto që po bëni frikë, trimëri e burrëri, ju s'jeni provuar asnjëherë. Nëse dikush duhet të flas për këtë punë, mund të flas Ramushi e unë, që jemi provuar dhe e dini qysh kemi shkuar, sa jemi sakatuar, sa jemi persekutuar e kush s'e ka pasur gjale për atë punë. Dhe, s'po dua të flas për këtë temë, se ashtu besoj është sepse nuk dëmtohet bendi për interes të individit, kurrë. Kurrë nuk dëmtohet dhe kurrë s'guxon të qitet vendi para individit. Po hajde t'i çojmë ata individë, kushdo le t'i merr e të bëhet, por mos ta prekim shtetin, të gjejnë rrugë tjera.

20 vjet sovranitet, 20 vjet këtu qeveri s'keni për të pasur. Kjo do të kthehet në një republikë banane. 20 vjet këtu si të niset aeroplani i prokurorit prej Brukselit këtu do të dridhen krejt, çka po bëhet. Kështu bënte Karla Del Ponte. Ju kujtohet? Si nisej për Beograd ose për Kroaci, edhe shitoret në Zagreb dhe Beograd mbylleshin. Destabilitet total, s'ka ecur ai vend kurrë pa u la.

Po edhe unë mendoj, pa u pastrua kjo çështje, ky vend s'ec përpara. Edhe unë besoj. Ama, e kemi kaluar. Ka rrugë tjera. Kosova s'e ka merituar të vjen këtu, as institucionet e Kosovës. Po mundemi të kemi vërejtje pa hesap për institucionet tona, ama vendi ynë s'e ka merituar të vjen këtu. Sepse e kemi pasur UNMIK-un, e kemi pas EULEX-in, ekskluzivisht i kanë pasur ato

kompetenca, janë gjykuar dhe janë me qindra ushtarë more se këtu po dëgjoj, po thonë, duhet me ia nisë. More janë qindra ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në burgje, në gjykime. E hajde matni gjykimet e Serbisë dhe tonat. S'e ka merituar vendi këtu të vijë.

Ka dyshime. Mund të ketë edhe pas 10 vjet a 20 vjet, gjithmonë duhet hetuar, ama jo kështu, jo të kthejmë edhe një herë protektoratin, jo të na këqyrë edhe një herë në pavarësinë e mbikëqyrur, jo për të na bërë sistem paralel të drejtësisë, jo edhe një herë të na thonë këta s'janë të aftë të drejtojnë shtet ligjor. Këtë ne jemi duke e thënë, mos e bëni.

Ka deputet individualisht që vërtetë ka ndonjë presion të madh dhe thotë po e, votova unë çka bëhet me Kosovën? Vëlla, gajle mos e keni, keni bërë një punë të madhe, votoni, jo. Nuk e dua unë Kosovën më shumë se ju, s'jemi duke e bërë atë garë. Bile ka shumë që hala, hala më shumë janë në gjendje të bëjnë për vendin. Mos e kuptoni kështu. Unë besoj që s'e ka kurrkush atë qëllim ta thotë. Ama sot është, votoni se kurrgjë s'bëhet. Edhe ndonjë shef i juaji që ka thënë kurrgjë, s'ka gajle hiq, votoni e kur të kryhet ajo punë bile do t'u thotë mirë ia keni bërë. A e di, ndoshta s'e thotë me zë, po votoni se gjë s'bëhet, prapë do të shkojmë në shtëpi, vendet e punës nuk i humbni. Mos more, se ju jeni njerëz që keni dëshmorë që kanë dhënë jetë për këtë vend, po çka bëhet një votë kundër? Deputet je. Kemi të drejtë, po na kërkohet diçka e padrejtë.

Prandaj, miq, kolegë ju ftoj, thirrni ndërgjegjes tuaj. Përgjegjësisë s'mund t'i ikni, do të bëhet ndarje e madhe konceptuale. Ne deri tash kemi mospajtime politike, po nga kjo votë kemi ndarje konceptuale më, se kemi për të qenë gjithmonë pro dhe kundër. Ata që kanë votuar kundër sovranitetit të vendit të vet dhe ata që kanë votuar ta ruajnë sovranitetin e vendit. Kjo nuk kalohet me efekte politike, edhe qytetarët do t'i ndani, edhe popullin do ta ndani, në fshatra e në lagje. Nuk ka këtu të votohet kundër sovranitetit të vendit e tani të shkoni në shoqata të veteranëve ose të shkohet në përkujtime të dëshmorëve. Jo, s'shkojnë bashkë! Hiq s'shkojnë bashkë këto të dyja. Duhet ndarë sendet.

Dikush na ka prirë këtu të ndahemi, e unë jam duke ftuar mos. Ejani të ulemi, ta bëjmë një konsensus, ta gjejmë një alternativë. Mos të futemi në këtë, kjo ka pasoja.

Dua t'u them edhe kolegëve të mi, të Lidhjes Demokratike. Dikush edhe këtu po do të na ndaj përsëri, gjëja për ato që dihen. Po do për ta kthyer, jo ka bërë këtu dosje, jo s'ka bërë këtu dosje. E keni parë qysh po u dalin llafet. Dy herë në 1999-2000, disa kolegë të mi këtu të vjetër e dinë se çka kemi hequr deri sa e kemi krijuar atë farë klime që është. Jo, jo, krimet, ato me motive politike që ato të qofshin duhet hetuar deri në fund. Edhe ai me atë mekanizëm të veçantë, edhe Qeveria që është duhet t'i japë prioritet numër një, ama jo për t'u thyer tash e të thënë kush ka bërë dosje, se menjëherë do të dalë kjo. Për ata edhe jam duke thënë jeni duke u futur në shumë të panjohura. Nuk guxojmë të ndalemi. Ne mundemi të mos pajtohemi politikisht, por s'guxojmë të ndahemi e të kthehemi edhe një herë më 1999.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve së bashku, jo me arrogancë, po ka kërkuar diçka që s'i kërkohet asnjë deputeti në botë. Asnjë deputeti në botë s'i kërkohet çka na kanë kërkuar neve sot. Po na kërkojnë ne nesër të themi ju gjithmonë vullnetarisht e keni bërë, vetë e keni bërë, Parlamenti e ka bërë, ju po e vrani veten. Kjo nuk i kërkohet kurrkujt, s'mund të na kërkonin as neve. Na kanë kërkuar, ne dimë t'u përgjigjemi.

Prandaj, zoti kryetar, unë mendoj që vetë shtrimi i diskutimit të kësaj çështjeje është antikushtetuese. Antikushtetuese, sepse nuk negociohet statusi, sovraniteti.

Miq, sovraniteti i këtij vendi, nuk negociohet kështu, se dikush po thirret në nenin 20-22, a cili nen është, i Kushtetutës së Kosovës - bartja e kompetencave. Po për Bashkimin Evropian, për NATO-n, po këtu ne s'jemi duke bartur kompetenca bre, këtu është duke u ndërtuar sistem paralel për t'ia dhënë një grupi të njerëzve, pa identitet. Edhe ai grup i njerëzve nuk do të flasë në emër të një institucioni, por në emër të Kosovës do të flasë, se aq i duhet asaj. A sa për ligje të Kosovës, harroni. Po të kallëzon ligji, me çfarë ligji do të funksionojë. Po i japin një grup të njerëzve pa identitet, pa ditur i kujt është adresimi. Ia japim një shteti të veçantë dhe ta dimë, një shtet le ta marrë përgjegjësinë juridike e politike, hajde. Mirëpo, kujt po ia japim?

Prandaj, ju ftoj, shumë sinqerisht, mos ta bëjmë këtë ndarje. Nuk tejkalohet. Unë e di që ka 'sallta' të mëdha. Nuk tejkalohet në terren kjo. Këtë përçarje që e bëni sot ju, nuk do ta tejkaloni lehtë. Mos lejoni të bëhet kjo përçarje.

Hajde të ulemi, ka kohë ende për ta ndalë këtë. Po nëse e bëni, kurrë më Kosova mirë s'do të jetë dhe raportet tona s'do të jenë të njëjta, s'mund të jenë të njëjta, ndryshojnë konceptualisht, sepse jemi një pjesë që kemi votuar për, një pjesë që kemi votuar kundër.

Edhe një gjë. Mos na këqyrni votat andej që janë 31 vota. Jemi forca politike. Sot ju jeni me 60, nesër ne mund të jemi me 70 vota. Për herë të parë është pas lirisë së Kosovës, 3 forca politike të thonë- kundër jemi. Mos na këqyrni me numër, se kjo punë s'bëhet me numër. Sot ju jeni shumicë, po na nesër jemi. Këqyrnani si forcë politike, jo si numër me 30 deputetë. Dhe këtu janë 2 parti shqiptare, mund të dalin për, 3 parti shqiptare kundër. Doni të bëni këtu, vazhdoni, por ju e merrni përgjegjësinë për ndarjen që po ia bëni vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00 dhe pastaj vazhdojmë me seancën. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: E vazhdojmë seancën, të nderuar deputetë. Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Zoti kryetar!

Urdhrin që e keni dhënë paradite për largimin e policëve, nuk është zbatuar. Këtë jua vërtetoj unë, se në pauzë ka pasur në oborrin e Kuvendit policë specialë dhe se ka pasur edhe dyer të mbyllura, të cilat zakonisht qëndrojnë të hapura, e kjo do të thotë që ky Kuvend nuk po i zhvillon punimet në një gjendje të rregullt, por është gjendje e jashtëzakonshme.

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Këshillin e Sigurimit si gogol e kanë shpikur Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi. Këshilli i Sigurimit nuk krijon gjykata për shtete që nuk i njeh. Edhe kur Këshilli i Sigurimit krijon gjykata, atëherë ato i krijon për të gjitha komunitetet, e jo kështu siç po do të na imponojnë neve një gjykatë që t'i gjykojnë shqiptarët, kurse të tjerët të kalojnë në pafajësi.

Iniciativa për krijimin e gjykatës e ka zanafillën nga rusi Konstatin Kozahëv në mocionin e 15 prillit 2008, në dokumentin e Asamblesë Parlamentare të Evropës me numër 11-57/4. Kjo pastaj ka vazhduar me dokumentet që kinse i ka zbuluar Karla Del Ponte dhe ka ardhur deri te Dik Marti, por krejt kjo ka ndodhur me iniciativën e Serbisë. Prandaj, Këshilli i Evropës nuk është iniciatori, por është vetëm ai që ka marrë përsipër atë që nuk do të duhej ta merrte.

Udhëheqësit politikë që i patëm këtu për ata që e kanë përcjellë punën e tyre e dinë se këta të njëjtit shumë herë na kanë premtuar dhe kanë deklaruar se nuk do të lejojmë asnjë të keqe mbi Kosovën dhe se atë e garantojmë herë me jetë e çka do qoftë, por të njëjtit luftën ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e kanë cilësuar si konflikt, sepse kështu ka dashur Serbia.

Fusnotën e kanë zëvendësuar me Republikën, kurse negociatat me Serbinë i filluan pa kushte dhe pa parim të reciprocitetit. Madje, edhe për çështje të brendshme të Kosovës pranuan të flasin me Serbinë, e këto nuk kanë ndodhur në asnjë vend sovran.

Këta politikanë të papërgjegjshëm, të gjitha këto koncesione që i bënë përherë u arsyetuan se gjoja këto i kanë obligime ndaj ndërkombëtarëve.

Për t'u arsyetuar para qytetarëve për dëmin që ia sollën vendit me koncesione ndaj Serbisë, pra e zbuluan refrenin 'kemi obligim ndaj ndërkombëtarëve' për të bërë veprime të cilat përherë kanë qenë të dëmshme për vendin tonë.

Me arsyetimin se kanë obligime, e pranuan decentralizimin në baza etnike, gjë që mundësoi formimin e komunave politike njëetnike. Këto komuna pamundësuan funksionimin e shtetit në territorin ku shtrihen ato dhe mundësuan ndërhyrjen e institucioneve të Serbisë në atë pjesë të vendit.

Të gjitha këto lëshime u arsyetuan si obligime që kinse i kemi karshi ndërkombëtarëve, që mision e kanë ruajtjen e qetësisë, por jo domosdoshmërisht edhe ndarjen e drejtësisë.

Me obligimin ndaj miqve si arsyetim po mundohen që ta imponojnë edhe themelimin e Gjykatës Speciale që nuk ia sjell asnjë të mirë vendit, që paraqet vazhdim të cenimit të sovranitetit të këtij vendi, i cili edhe ashtu është i cenuar shumë.

Në emër të obligimeve ndaj ndërkombëtarëve, këta të njëjtit kanë mundësuar punësimin e punëtorëve të 'Civilna Zashitita', që janë punëtorë të MUP-it të Serbisë në institucionet e Kosovës, që nuk do të lejoheshin askund tjetër në botë.

Po tolerohet zhvillimi i mësimin në të gjitha nivelet e shkollave në Kosovë me planprogramet e Serbisë, e UÇK-në e quajnë terroriste, kurse popullin shqiptar armik të Serbisë.

Është legjitimuar plaçkitja e dokumenteve kadastrave. Po lejohet pjesëmarrja e serbëve në votime pa dokumente të Kosovës. Sa herë që kompromiset nuk mund të arsyetohen me dobinë që ia sjellin vendit, ato cilësohen si të domosdoshme për shkak të obligimeve që Kosova kinse i paska ndaj miqve ndërkombëtarë dhe perspektivës evropiane, edhe pse dihet se askush as nuk e ka obligim dhe as nuk ka të drejtë të vendosë në kundërshtim me interesat e vendit.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar miq ndërkombëtarë,

A thua nuk janë obligimet e këtij Kuvendi, të kësaj Qeverie dhe të juve miq ndërkombëtarë që të ndihmoni në zhvillimin ekonomik të vendit, në hapjen e vendeve të reja të punës, në rritjen e cilësisë në arsim dhe shërbime shëndetësore; në krijimin e ushtrisë pa kufizime, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; efikasitetin në Administratë dhe drejtësi, dobësi këto që po e përcjellin këtë vend tash e 15 vjet.

Se zgjedhja e këtyre problemeve jetike për Kosovën nuk ka qenë prioritet dhe preokupim i miqve tanë ndërkombëtarë, lehtë vërehet pas formimit të qeverive nga të cilat miqtë tanë ndërkombëtarë nuk kërkojnë zhvillim, por insistojnë dhe kërkojnë bisedime pa kushte me Serbinë, herë për decentralizimin në baza etnike, herë ulëse të rezervuara dhe të garantuara në Kuvend për minoritetin serb, herë arsim e shëndetësi e gjyqësi paralele, herë asociacionin e komunave serbe me ingerenca ekzekutive e buxhet paralel, herë Kosovë multietnike, herë ndarje në baza etnike. Kërkohen koncesione që nuk hasen askund, përveç në Kosovën që quhet multietnike, në të njëjtën kohë që 95% të banorëve i ka shqiptarë.

Preokupimi juaj miq ndërkombëtarë shkoi përtej garantimit të privilegjeve për minoritetin serb. Ju u angazhuat edhe për shumicën e dyfishtë në Kuvend që shpesh e paralizon punën e Kuvendit dhe kjo kërkesë u pranua si përmbushje jona ndaj jush.

Në Qeveri dhe në Kuvend në këto mandate u pranuan përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë, të cilët nuk e njohin pavarësinë e shtetit të Kosovës dhe kjo ndodhi për shkak të perspektivës evropiane, edhe pse këtë model nuk e gjejmë askund në Evropë.

Deputetë të nderuar,

Institucionet e Kosovës duhet t'i respektojnë miqtë, por nuk guxojnë të marrin obligime që janë në kundërshtim me interesat tona.

Deputetët e Kosovës e kanë për obligim ta përmbushin betimin e tyre të dhënë para qytetarëve të këtij vendi ku, përveç tjerash, thuhet: “Me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin; do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj; do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe integritetit të institucioneve të Kosovës”.

Të nderuar miq ndërkombëtarë,
Ju që na ndihmuat në momente shumë të rënda për fatin e vendit dhe popullit tonë, misioni juaj për ta ruajtur paqen në Ballkan nuk do të përmbushet kurrë duke u përpjekur t'i ngopni epitetet e Serbisë, sepse Serbia është e pangopshme.

Paqja do të ruhet, të nderuar miq, nëse fqinjët e njohin pavarësinë e njëri-tjetrit, nuk ndërhyjnë në punët e njëri-tjetrit dhe e pranojnë parimin e reciprocitetit, e kjo në rastin e Serbisë nuk po ndodh.

Kosovës do t'i ndihmohet duke mos u mjaftuar me kritika dhe kërcënime ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, por duke luftuar e atë me të gjitha mjetet e lejuara demokratike.

Miq të nderuar,
Kosovës nuk do t'i ndihmoni edhe as nuk do ta qetësoni rajonin duke ia imponuar kërkesat e paarsyeshme të Serbisë dhe duke i përkrahur politikanët e korrumpuar.

Kosovës i ndihmoni duke i inkurajuar përfaqësuesit e saj që ata vetë t'i identifikojnë interesat e veta dhe të punojnë për to, e jo duke imponuar zgjedhje.

Kolegë të nderuar deputetë,
Mos e votoni këtë gjykatë, sepse pasardhësit tanë nuk e meritojnë një trashëgimi të tillë, të cilën ne do t'ua lëmë nëse votojmë diçka kundër sovranitetit të këtij vendi për të cilin kanë luftuar baballarët, gjyshërit dhe stërgjyshit tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të vendit,
Në vend që sot treshja institucionale Mustafa-Thaçi-Jahjaga të ngriheshin në nivelin e përgjegjësisë së tyre shtetërore në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe sovranitetit të vendit, ata kanë vendosur të kundërtën e saj. Pra, janë rreshtuar së bashku për ta shkatërruar pa asnjë mëshirë atë që me mund, djersë e gjak dhe sakrificë të madhe është arritur, sidomos gjatë dekadave dhe viteve të fundit.

Duke qenë të amnistuar secili në formën e vet, ata sot janë bërë bashkë kundër kësaj sakrifice për ta ruajtur pushtetin inekzistent në Kosovën e stërlodhur nga pesha e madhe e varfërisë dhe joperspektiva e qytetarëve të saj.

Sidoqoftë, në vend që institucionet tona dje dhe sot, të nxitura e të përkrahura nga Qeveria e Kosovës të përgatitnin mbi 15 mijë padi për vrasjet e shqiptarëve të pafajshëm, madje edhe foshnjave të sapolindura në vend të organizatave, individëve e institucioneve tona të përgatitnin padi të panumërta për përdhunimet e kryera barbarisht mbi popullin tonë, në vend që këto të bëhen sot nga Qeveria, Qeveria jonë po del krejt me një agjendë tjetër.

Të nderuar kolegët e mi deputetë,

Si mund ta votoj unë sot këtë gjykatë, e nesër ta takoj nënën Havë Pajaziti, e cila në masakrën më të madhe në Mejë, kur humbën rreth 400 qytetarë, humbi 4 djemtë, 2 rejat, dy mbesat, shumë nipa dhe ajo sot në moshën 90-vjeçare përkujdeset për katër palë jetimë. Si mund të votoj unë sot e nesër të takohem me familjarët e kolegëve të mi mësues Zenelit, Ymerit, Rexhepit dhe t'u them që ka bërë një veprim të mirë? Si mund të votoj unë sot e takohem me nënën Zade, nënë e dëshmorit Hysen Arifi, nga fshati Pacaj?

Si mund të votoj unë sot, e nesër t'i dal përballë nxënëses sime Doruntinë Pajaziti, e cila nuk e njohu babanë e saj dhe sot pret që eshtrat e tij të kthehen në vendin, ku ajo për çdo 27 prill çon lule në mesin e axhallarëve që janë aty dhe babai i saj sot e kësaj dite nuk prehet i qetë në ato varreza? Si mund të votoj unë sot e të dal përballë shumë nuseve, nënave nga fshatrat Nivokaz, Bërja, Mulliq, Ponoshec, Botushë, Smolicë, Devë e gjithandej Gjakovës?

Si mund të dal të votoj e nesër të takohem me Sadri Tahirajn nga fshati Racaj, i cili e humbi të vetmin djalë, i cili sot me mbi të 80-tat që i ka shpreson që ende është i gjallë. Si mund të votoj unë sot, kolegë deputetë dhe ju kolege të nderuara, e nderuara kolege Blerta, kur para vetes unë e kam një broshurë me krimet e luftës në komunën e Gjakovës, e disa nga to unë do t'ia dhuroj kryeministrit, zëvendëskryeministrit, kryetarit të Kuvendit, e të shihni vetëm në disa nga dëshmitë që janë këtu se çfarë ka ndodhur në Gjakovë dhe gjithandej dhe kush thjesht sot akuzohet, kush ka dalë para drejtësisë.

Krejt të pafajshëm qytetarë të masakrave në Dushnjë, Devë, fëmijë të vrarë në masakrën e fshatit Mejë; i pafajshëm dhe pa i mbushur ende 10 vjet. Si mund të votoj unë sot pra dhe nesër të ndihem e qetë? Si mund të votoj, kur unë çdo ditë që udhëtoj nga Dobroshi për në Gjakovë dhe Prishtinë kaloj nga lapidarët, të cilët janë ndërtuar me mundin e familjarëve, që janë pra rreth 400 në Mejë, e që në çdo fshat, Dobrosh, Sheremetaj, Dallashaj, Rracaj, ka lapidarë të ngrehur me mundin e tyre.

Ato nëna, ato motra, përpos dhimbjes së madhe që kanë, edhe sot e kësaj dite u desh të përkujdesen edhe për t'i ngrehur lapidarët për t'u treguar fëmijëve të tyre që lindën edhe pas vrasjes, masakrimit të baballarëve të baballarëve të tyre nga pushteti serb, për t'u treguar se këtu ishte dhe është vendi, janë pronat tuaja, të cilat i trashëguat nga ata baballarë, që sot nuk janë me ju. Si mund të votoj unë sot, e nesër të ndihem e qetë? Si mund të votoj dhe t'u them që ju që jeni qytetarë të Kosovës që na votuat për të qenë përfaqësues tuaj, e ne sot e morëm një vendim gjakftohtë dhe thjesht treguam se nuk jemi të zotët për ta udhëhequr vendin.

Deri kur jemi në gjendje ta shtrijmë qafën e të copëtohem dhe mos të jemi të bashkuar për diçka që thjeshtë ka ndodhur? Askush, të nderuar, nuk po gjykohet për këto masakra. Janë me qindra e mijëra dëshmi, të cilat sot e kësaj dite nuk janë ngrehur nga institucionet tona. Kush vallë duhet ta bëjë këtë?

Andaj, edhe një herë, e di Blertë që e përjeton shumë rëndë, e di për të gjitha koleget, por që nga dje e ke marrë një përgjegjësi edhe më të madhe, për të na përfaqësuar ne si grup i grave deputete.

Prandaj, edhe një herë ju bëjë thirrje me gjakftohtësi, që t'i themi 'jo' kësaj gjykate.

Edhe pse pa praninë e kryeministrit të vendit, unë do t'ia lë njërën nga këto broshura kryetarit të Kuvendit, zëvendëskryeministrit, por për të gjithë deputetët dhe Qeverinë i kam të gjithë numrat dhe secilit nga ta do t'ia jap. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Ndoshta jeni lodhur me fjalime, kolegë të nderuar,

Por, sot është ditë shumë e rëndë dhe është me rëndësi të gjithë të diskutojmë.

Është ditë e rëndë dhe e vështirë për deputetët e Kuvendit dhe për shtetin tonë. Në këtë ditë është një prej atyre momenteve të rralla, kur Kuvendi i Republikës ka rol të jashtëzakonshëm, sepse kjo ditë ka të bëjë, në njërën anë, me vendosjen e së kaluarës tonë dhe, në anën tjetër, me të ardhmen tonë.

Duhet të pyesim apo të shohim direkt ku drejt, ku është Kosova sot. Shteti ynë është i thyer, i copëtuar dhe i dërmuar. Sot sovraniteti i Kosovës, ai i cili duhet të jetë i plotë, ndahet me UNMIK-un, me KFOR-in, me EULEX-in dhe me Serbinë.

UNMIK-u përfaqëson Kosovën aty ku shteti nuk është i përfaqësuar dhe nuk e e pranon ekzistencën e këtij shteti.

KFOR-i i ruan kufijtë tanë, por nuk e njeh shtetin tonë. EULEX-i bën gjithçka, përpos drejtësisë dhe sundimit të ligjit, e Serbia është kthyer si vendimmarrëse në Kosovë.

Asnjëri nga këta katër aktorë nuk e njohin Republikën e Kosovës dhe të gjithë janë pjesë e shtetit të Kosovës.

E ku është ajo copë tjetër e sovranitetit tonë? Ajo është një pjesë e sovranitetit shumë të gjymtuar dhe e zhytur në korrupsion, nepotizëm dhe çka është më së keqi - në mungesë absolute të vetëdijes shtetndërtuese dhe zhvillimore.

Ne kemi paradoks, kur anëtarët e Qeverisë së Kosovës shkojnë në Bruksel nga anëtarët e Listës serbe normalisht, pjesë e delegacionit të Serbisë, si para dy muajsh dhe flasin për rregullimin e brendshëm të Kosovës.

Sot, në të njëjtën kohë duhet të pyesim pse Shtetet e Bashkuara na kërcënojnë me Rusinë? Na kërcënojnë për shkak të dështimeve tona, apo për shkak të dështimit të sistemit gjyqësor, të ndërtuar nga bashkësia ndërkombëtare? Nëse kemi dështuar ne, atëherë duhet të drejtohet gishti te burimi i dështimit, e ai burim janë institucionet e Kosovës, është politika e Kosovës, apo janë institucionet e drejtësisë, të instaluar nga bashkësia ndërkombëtare?

Populli ynë sot në shumicë mendon se kjo gjykatë do ta ndihmojë Republikën e Kosovës, sepse populli ynë sot është i pashpresë. E populli ynë mendon se një mekanizëm i tillë ndërkombëtar do të vijë, do ta çlirojë dhe do t'i rregullojë të gjitha problemet në vendin tonë.

Kosova nuk e meriton këtë gjykatë në këtë formë, nëse burimi i dështimit bie mbi EULEX-in dhe UNMIK-un. Të mos harrojmë që të dy këto institucione në mandatin e tyre ekzekutiv i kanë pasur krimet. Pas 16 vjetëve drejtësi ndërkombëtare, kjo drejtësi nuk ka kredibilitet në Kosovë dhe nuk duhet të ketë kredibilitet me asnjë pjesëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kosova vuan për drejtësi tash e 16 vjet, e ne 16 vjet jetojmë si eksperiment i drejtësisë.

Pse po mendojmë që një gjykatë speciale, e cila kushton më shumë se 300 milionë euro do ta bëjë atë që nuk e ka bërë EULEX-i me më shumë se një miliard euro, aq ka kushtua asgjë, e s'ka bërë, as nuk e ka luftuar korrupsionin, e as krimet e luftës. Domethënë, drejtësia ndërkombëtare nuk ka kredibilitet në Republikën e Kosovës.

Ne, që nga shpallja e pavarësisë, i kemi pasur dy akte të suspendimit të pjesëve të shtetësisë. Akti i parë ka qenë fusnota, akti i dytë është Marrëveshja e Brukselit. Sot mund të ndodhë suspendimi i pjesës së tretë, me Gjykatën Speciale.

Kjo gjykatë mund të shkruajë, ndër të tjera, marrëveshjen ndërkombëtare me palë të treta pa miratimin e Kuvendit të Kosovës, nuk do të mbikëqyret nga asnjë institucion i Kuvendit të Kosovës dhe do të udhëhiqet nga një organizëm i dështuar nga ata që e kanë themeluar EULEX-in. A me të vërtetë mendoni që kështu do të ecim përpara?

Paaftësia e Qeverisë, e një klase politike, nuk mund të mbulohet me arsyetime, pa na thënë të tjerët. Zgjidhen bartësit e institucioneve në Kosovë me arsyetimet 'po na thonë të tjerët'. Bëhet fusnota antishtetërore, sepse na thanë të tjerët. U pranua rruga e bosnjëzimit të Kosovës, sepse thanë të tjerët. Po, po të thonë të tjerët revokojeni pavarësisë, a do ta bëjë ky Kuvend një gjë të tillë?

Po të udhëhiqej politika e Kosovës gjatë viteve të '90-ta nga na thanë të tjerët, ne kurrë s'do ta kishim pasur pavarësinë.

Gjatë viteve të '90-ta, nën çizmen e regjimit të Milosheviqit dhe në vllugun e luftës, shtetet perëndimore thoshin gjatë gjithë kohës se Kosova nuk do të jetë shtet i pavarur, por do të jetë krahinë autonome në Republikën Federale të Jugosllavisë.

Por vendosmëria jonë, zonja e zotërinj, na e solli pavarësinë dhe përkrahjen e të tjerëve.

Këto amendamente, të cilat janë para nesh, e shkelin obligimin e Kosovës, të cilin e kemi marrë me letërkëmbimin Jahjaga-Eshton. Nuk është paraparë asnjëherë gjykatë e tillë, e cila është jashtë sistemit juridik të Kosovës dhe që gjendet jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

E tash, sot, dëgjuam shumë për shkak se është ditë e rëndë dhe ka shumë plagë të pambyllura në vendin tonë, 16 vjet pas luftës për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Por, sot duhet të shikojmë edhe çka është bërë në këto 16 vjet. Çka ka ndodhur në Republikën e Kosovës është tentimi konstant 16-vjeçar për përvetësimin partiak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E partizimi i UÇK-së ka qenë gabim jashtëzakonisht i madh, sepse nuk e kemi ruajtur si diçka e cila është jopolitike, jopartiake dhe si vlerë të përbashkët të vendit tonë.

Dhe, me këtë tentim partiakizimi, thua se lufta për liri ka qenë partiake, e jo popullore.

Në të njëjtën kohë, jashtë çfarëdo pseudopatriotizmi folklorik duhet të themi qartë se ka vetëm luftë të drejtë dhe luftë të padrejtë. Lufta e Kosovës ka qenë e drejtë, por nuk duhet të hyjmë në atë e të themi se ka luftë të pastër, e të papastër, sepse luftërat si të tilla janë të papastra.

Pavarësia e Kosovës edhe një herë është rezultat i vullnetit të popullit tonë për shtet të vetin. Vullnet për shtet demokratik funksional me ligj dhe me barazi.

Është rezultat i përpjekjes së shumë gjeneratave 96-vjeçare. Nuk ka fillua as me ë '90-tat, as me të '80-tat, as me të '60-tat, as me të '70-tat.

E Gjykata Speciale, ligji për të cilën i sanksionon edhe përndjekjet për krimet më të tmerrshme të luftës, e përdhos lirinë e Kosovës. E Kosovën e bën shtet-krijesë të themeluar mbi krim, spastrim etnik, përdhunime, mbi krim të organizuar, na bënë shtet banditësh. E zhvlerëson pavarësinë dhe luftën e drejtë, luftën e brezave tanë për liri.

Ju kam thanë këtu edhe më herët - vetëm një popull në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore është gjykuar nga një gjykatë njëetnike, populli gjerman, pas vitit 1945. S'ka popull tjetër, i cili ka krijuar gjykatë gjysmë ndërkombëtare, njëetnike që ta gjykojë vetveten. Kjo nuk ka ndodhur. E ky është precedent jashtëzakonisht i madh.

Mos harroni që Tribunali i Hagës ka qenë për territorin e ish-Jugosllavisë, domethënë edhe për ne.

E pavarësia jonë është pjesë e kontekstit të shkatërrimit të Jugosllavisë, as atë s'bënë ta harrojmë.

Ligjshmërinë e pavarësisë sonë e ka vulosur edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë para pesë vjetëve. Po me këtë gjykatë, për të cilën ne sot po diskutojmë, ne do të marrim epitet tjetër jashtë shteteve tjera të ish-Jugosllavisë. E thashë, bëhemi popull i vetëm pas Luftës së Dytë Botërore që do të dalë se e kemi fituar luftën me krim. As kroatët, as boshnjak, e askush tjetër nuk e ka atë hije mbi vete, me një sistem të drejtësisë.

Dhe, të jua tregua të drejtën bëhemi me keq se Republika serbe në Bosnjë, e cila është ndërtuar mbi varrezat masive në Srebrenicë, Prijedor, Foçë. E ne mund të rrezikojmë që të harrohet Batanjica dhe shumë Batanjica të tjera. E pasi jemi te Srebrenica, të ju them diçka. Ju po e shihni që iniciativa e bashkësisë ndërkombëtare, apo e Perëndimit për klasifikimin e gjenocidit të Srebrenicës me Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk do të ketë sukses. Dhe, po e shihni që Serbia po reziston çfarëdo aludimi që të pranojë që Srebrenica është gjenocid, e edhe Tribunali i Hagës, edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e kanë vërtetuar që është. Dhe ne sot këtu po tentojmë ta frikojmë njëri-tjetrin me një sistem ndërkombëtar.

Është për gjynah që për këto 16 vjet ne nuk kemi pasur në të vërtetë asnjë veprim institucional për ta dënuar persekutimin pas qershorit 1999. Në vend se të kërkonim me ngulm hetimin dhe dënimin e të gjitha atyre që kanë vrarë serbë, shqiptarë, romë e boshnjakë pas 12 qershorit 1999, këtu në Kosovë janë gjetur arsyetime për veprime të tilla.

Në vend se ta krijojmë gjykatën e shtetit të Kosovës për krime lufte, ne u bëmë me udhëheqësi, e cila bën kompromise dhe e cungon shtetin për shkak të frikës së fateve individuale. Fati individual i kujtdo është thellësisht relevant kundruall fatit të shtetit dhe të popullit tonë.

Në minimum 20-vjeçarin e ardhshëm, nëse aprovohen ndryshimet kushtetuese, ne kolektivisht do të ndihemi të turpëruar me gjykatën, në formën se si është para nesh. Po na thonë dhe po na thonë, e nuk po ndalen duke na thënë ‘ne i kemi vetëm dy opsione, ose ju votoni gjykatën, ose shkon në Kombet e Bashkuara’. A e dini që kurrë nuk janë vetëm dy opsione. Në politikë nuk ka dy opsione. Ekziston edhe opsioni i tretë, por opsioni i tretë varret prej vullnetit tuaj, të nderuar deputetë, e ajo është krijimi i gjykatës së Kosovës për krime lufte. Kjo gjykatë duhet të jetë e njëjtë me tillën çfarë e kanë Kroacia, Bonja edhe Serbia. Ekziston kjo rrugë, e cila e sfidon shtetin tonë dhe pjekurinë politike dhe shoqërore për ballafaqim me krimet e kryera në emrin tonë.

Domethënë, ne sot duhet të dalim me një ‘po’ për një gjykatë të Kosovës, ama të Republikës së Kosovës, me seli në Kosovë, për krime të luftës, e nëse duhet po marrim dhe gjykatës e prokurorë ndërkombëtarë, e nëse duhet po i mbajmë edhe dëshmitarë jashtë Kosovës, por gjykimet duhet të mbahen në Kosovë, sepse krimet kanë ndodhur në Kosovë.

Ju deputetëve të LDK-së, unë jam për zbardhjen e fatit të çdo anëtarit të partisë suaj, i cili është vrarë prej vitit 1999. Por, jo, zonja e zotërinj, kjo gjykatë nuk do ta zbardhë fatin e vrasjes të askujt. Edhe mbani në mend diçka!

Drejtësia selektive, zonja e zotërinj, nuk është drejtësi. Nuk ka drejtësi njëetnike dhe nuk ka drejtësi ku ka gjykim të një populli. Ka vetëm drejtësi universale. Tek e fundit, çdonjëri prej neve do të jetojmë me vendimin tonë të sotëm.

Dhe, ky votim nuk do të jetë si ata të tillë në të kaluarën, nuk do të harrohet. E unë ju kisha ftuar që çdonjëri të votoni sipas bindjeve tuaja, e jo sipas presioneve. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën, m’u duk si reagim ndaj Ilirit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë i kuptoj të gjithë ata që po flasin dhe nga ajo që e ndiejnë, edhe ata që po flasin sa për të thënë diçka dhe për të tentuar të na moralizojnë tash. Në Kosovë nuk kanë ndodhur vrasje tash e një vjet, gjashtë muaj, në kuptimin çfarë e tha parafolësi, kanë ndodhur bukur moti, dhe s'ia kemi dëgjuar kurrë zërin të dalë e të kërkojë, e organet e drejtësisë e kanë këtë obligim. Dhe, ne nuk themi që kjo gjykatë do ta zbardhë ose s'do ta zbardhë fatin, përkatësisht ajo çfarë ka ndodhur edhe me veprimtarët e LDK-së.

Prandaj, mos i negatërroni gjërat dhe mos u mundoni të na tregoni neve që vazhdimisht kemi kërkuar nga organet e drejtësisë, por jo nga ndonjë parti politike, në këtë rast më së paku prej juve, që kur zëri s'u është dëgjuar, as s'e keni thënë asnjëherë asnjë të vetmen fjalë as të keqardhjes për atë çfarë ka ndodhur në Kosovë, e sot na moralizoni, kjo është me të vërtetë e pakuptueshme. Sidoqoftë, le të mbetet në ndërgjegjen tuaj, dhe bindjet tuaja mbani për vete, sikur që ne i kemi bindjet tona dhe i mbajmë për vete dhe me votë në fund vendosim.

Ne e dimë që e kemi kryeministrin, e dimë që e kemi edhe ministrin dhe ju i dini këto edhe më herët çfarë kanë ndodhur, dhe edhe një herë po e them - s'ju prekur kurrë ndërgjegjja, prandaj lini dhe mbani për vete këto moralizime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajde Glauk, një gjysmë-replike, vetëm jo gjatë!

GLAUK KONJUFCA: Nëse ekziston një definicion 'par exelance' i dyfytërsisë, atëherë unë dyfytërsinë e definoj kështu.

Një deputet i një subjekti politik, i cili sapo foli, del në foltoren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe atij prapa, i cili e udhëheq seancën e Kuvendit dhe me të cilin bashkë e qeverisin Republikën e Kosovës, i thotë 'ti je vrasësi, ti më ke vrarë, ti ke dashur të më vrasësh, ju keni vrarë shumë aktivistë tanë, shumë shokë tanë' dhe vazhdojnë ta qeverisin Republikën e Kosovës së bashku, kurrë nuk e kanë paditur atë të cilin e akuzojnë, derdhn vazhdimisht lot krokodili dhe e fajësojnë opozitën, kjo me të vërtetë është e padurueshme!

KRYETARI: Glauk, aktor je për besë. Shkoni në Prokurori, se na lodhët! Ismet, a do të flasësh? Urdhëro!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Me të vërtetë edhe unë po pajtohem me këtë aktor, e përmbylla - nuk do t'i replikoj më, se jo vetëm ky, por ky e ka një duzinë aktorësh, po veçmas ky është kryeaktori i këtyre që i thatë dhe po pajtohem plotësisht.

Zoti Konjufca, po të kemi argumente, jo veç atë, por edhe ty, edhe çdonjërin do ta kisha paditur. Nuk kam pasur kurrë argumente, e unë e di ku i bëj argumentet. Në Prokurori duhet bërë, e jo këtu në Kuvendin e Kosovës. Edhe një herë po them, po më vjen keq dhe do të mundohem të mos bie në nivelin tuaj, se e di ku është vendi. Në atë moment që të kem argumente, unë e bëj padinë, për dallim prej aktrimeve dhe lotëve tuaj të krokodilit.

KRYETARI: Ganimete, merre fjalën, se ta ndala fjalën 2-3 herë, por së pari shprehu nëse je e lirë në grupin tënd parlamentar që ta shprehësh mendimin, sepse po thonë...

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kam thënë vazhdimisht dhe vazhdoj, edhe sot po e them, meqë veç po e kërkon edhe publikisht, ndihem jashtëzakonisht krenare dhe e lumtur që nga viti 2000 jam anëtare e Partisë Demokratike të Republikës së Kosovës, e cila me të vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës është parti demokratike. Asnjëherë nuk ma ka cenuar të drejtën time, asnjëherë nuk ka bërë presion mbi vendimet e mia. Prandaj, ndihem shumë e lumtur dhe shumë e lirë që sot të dal në këtë foltore këtu ku jam.

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Masakra e Likoshanit, masakra e Qirezit, masakra e Abrisë, masakra e Izbicës, masakra e Poklekut, masakra e Rezallës, masakra e Vërbovcit, masakra e Çikatovës, masakra e Shtuticës; nëna Rabë që iu vra djali i hasretit, Smajli, dy muaj para dasmës dhe ajo sot e kësaj dite lëngon e vetme në shtrat; Shpresa Bajrami që u mor nga duart e nënës dhe që me thonj luftoi deri sa e ekzekutuan, janë vetëm disa nga arsytet pse unë do t'i them 'jo' kësaj gjykate sot.

Falënderimi i takon Zotit dhe Ushtrisë Çlirimtare që popullin tonë e shpëtoi nga shfarosja barbare, pa e anashkaluar asnjëherë edhe ndihmën e miqve tanë ndërkombëtarë, por unë udhëhiqem nga bindja se lirinë nuk na e fali askush, atë e fituam me gjak. Për këtë liri u masakruan fëmijët 4 ditësh, gjithashtu u masakruan edhe pleqtë 98-vjeçarë. Për këtë liri e dhanë jetën shumë bijë e bija të këtij vendi, prandaj falënderimi u takon atyre sot.

Para se të vinim sot në këtë takim, mendoj se bashkësia ndërkombëtare fillimisht do të duhej t'i shpallte të pavlefshme institucionet apo misionet, si UNMIK-u, EULEX-i, ose Haga, ose përndryshe çka na duhet Gjykata Speciale? Kush ka mbetur pa u gjykuar ende? U gjykua Grupi i Llapit, Grupi i Dukagjinit, Grupi i Gjilanit, Grupi i Pashtrikut dhe i dhanë vulë në fund edhe me Grupin e Drenicës, që është turpi i drejtësisë ndërkombëtare në Kosovë. Nuk mund t'i dërgojnë në burgun e Mitrovicës për t'i poshtëruar me gardianë kriminelë për të vuajtur në paraburgim, atëherë ua gatuan gjyqin politik, duke montuar dëshmitarë të rrejshëm e kriminelë, të cilët për ta fituar një azil politik mohojnë dhe e përdhosin lavdinë e kombit të vet.

Për fund, që mos t'i përsëris të gjithë parafolësit e mi, do t'i them edhe nja dy gjëra:

Në një, unë askënd nga deputetët nuk do ta ftoj as të votoni, e as të mos e votoni këtë gjykatë, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm për vendimet që i marrim dhe secili le të mbajë përgjegjësi për votën e vet, ashtu siç është zotuar para qytetarëve kur e ka kërkuar besimin e tyre. Por, e di që një parim i drejtësisë thotë: Më mirë është 100 fajtorë në liri, sesa një i pafajshëm në burg.

Dhe, e dyta që dua ta them është ajo që u tha nga "Vetëvendosja" në fillim të seancës, se pse e keni sjellë Policinë në oborr të Kuvendit, duke ju pyetur nëse po frikoheni nga veteranët? Jo të nderuar, nga veteranët të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës as nuk është frikuar, e as nuk frikohet asnjëherë askush, sepse askush nuk frikohet nga shpëtimtari i tij. Por, siguria e shtuar në oborrin

e Kuvendit vjen si pasojë e rezultateve të dhunës së treguar në kohë të caktuara. Ju e dini që në këtë Kuvend janë penguar deputetët për të hyrë në sallë, e besa besë edhe ambasadorët e vendeve mike të Kosovës, siç është ambasadorja amerikane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Derisa Vjosa Osmani e merr fjalën, ka ndodhur një fenomen i veçantë. Krejt opozita e ka tërhequr fjalën, edhe për mediat ta kenë pasur parasysh. Jemi duke shkuar drejt një loje taktike të re tash të opozitës.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot është një vendim i vështirë për secilin prej nesh, pavarësisht qasjes apo argumenteve që mund t'i kemi për apo kundër themelimit të Gjykatës Speciale. Vota jonë sot, prandaj, pavarësisht se për cilën alternativë është, duhet të pranohet dhe respektohet përderisa ajo të bëhet në përputhje të plotë me ndërgjegjen tonë dhe me bindjen tonë të plotë se nëpërmjet këtij veprimi po i mbrojmë interesat e vendit nga një skenarë shumë më i keq.

Prandaj, në radhë të parë, dua t'i siguroj qytetarët e Kosovës që njësoj si çdo vendim tjetër që e kam marrë gjatë tërë mandatit si përfaqësuese e tyre, se ky vendim imi sot nuk është bërë dhe kur nuk do të ndodhë të bëhet nën presion, e as nën orientimin e askujt, por me bindje të plotë se nëpërmjet këtij veprimi marrim përgjegjësi shtetërore dhe e parandalojmë një të keqe shumë më të madhe që po i kanoset Kosovës.

Më lejoni të shpjegoj pse mendoj kështu?

Më 17 shkurt 2008, përfaqësuesit e popullit të Kosovës e miratuan deklaratën e pavarësisë, e cila parasheh përkushtimin e Kosovës dhe popullit të saj që Kosovën ta bëjë anëtare të komunitetit të kombeve që i respektojnë obligimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe i respektojnë parimet që dalin nga Karta e Kombeve të Bashkuara.

Kapitulli VII i kësaj karte, respektivisht neni 41, e autorizon Këshillin e Sigurimit që të ndërmarrë masa që nuk janë përdorim i forcës për ta vendosur paqen dhe sigurinë. Pikërisht nën autoritetin e këtij neni dhe duke e njohur rëndësinë e sundimit të ligjit për paqe në çdo vend, ky këshill ka themeluar apo ka marrë pjesë në themelimin e gjykatave apo tribunaleve ndërkombëtare e të gjykatave apo të tribunaleve speciale nëpër vende të ndryshme.

Po i numëroj këtu disa prej tyre: Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, siç e dini, Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën, Tribunali Special për Libanin, Gjykata Speciale për Sira Leonën, dhoma të specializuara apo speciale për Kamboxhian.

Më të gjitha këto raste, pra Këshilli i Sigurimit e ka shfrytëzuar autoritetin për të vendosur për këto tribunale, çfarë na bën të besojmë se do të ishim përjashtim nga ky rregull dhe se Këshilli i Sigurimit nuk do të vepronte njësoj kësaj radhe. Në fakt, i vetmi dallim do të ishte që për dallim nga ato shtete dhe raste që i përmenda më herët që OKB-ja, apo Kombet e Bashkuara, i pranojnë si shtete, sepse janë anëtare të kësaj organizate, në rastin e Kosovës, meqenëse nuk jemi anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe nuk njihemi si shtet sovran nga anëtarët permanentë të Këshillit të

Sigurimit, skenari i vetëm i mbetur do të ishte miratimi i një rezolute që themelon gjykatë speciale, por jo në marrëveshje me Republikën e Kosovës si shtet, por me UNMIK-un, pra rikthim i të gjitha autoriteteve në fushën e politikës së jashtme dhe të drejtësisë që i ka pasur UNMIK-u para pavarësisë, duke ia rikthyes, siç po flitet, edhe kompetencat, të cilat nuk i ka pasur më herët.

Kjo rezolutë që, sipas të gjitha gjasave, do ta sponsorizohej nga Rusia, për dallim prej amendamentit që e kemi sot para nesh, nuk do të parashihte që ligjet e aplikueshme janë ato të Kosovës dhe Kushtetuta e Kosovës, nuk do të parashihte afat kohor për funksionimin e vet derisa do të shfuqizohej rezoluta nga po të njëjtit anëtarë permanentë të Këshillit të Sigurimit dhe po ashtu do ta përfshinte gjenocidin si vepër, për të cilën do të akuzoheshin të gjykuarit potencialë para kësaj gjykatë.

Kushdo që beson se Rusia nuk do ta bëjë këtë, apo mendon se ndonjëra nga shtetet që janë po ashtu anëtare permanente të Këshillit të Sigurimit do ta ndalë, është mirë të takojë dhe të bisedojë me misionet e përhershme të këtyre shteteve në Kombet e Bashkuara. Edhe diçka, Samantha Powers, që është, të nderuar deputetë ambasadore e SHBA-ve në misionin e përhershëm të këtij shteti në Kombet e Bashkuara, e ka dëshmuar shumë qartë se kë e konsideron ajo viktimë, e kë agresor në luftën e fundit të Kosovës. Ju ftoj ta lexoni librin e saj, ndër të tjera, edhe për gjenocidin në Kosovë, por ajo po ashtu e ka thënë shumë qartë që përderisa e njeh kush ka qenë agresor dhe kush viktimë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta parandalojnë një rezolutë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që do ta themelonte një gjykatë speciale për Kosovën, që po ashtu do të bazohej në raportin e Dik Martit, por do t'i përfshinte edhe të gjitha elementet që i përmenda më herët.

Edhe disa nga rastet e Tribunalit të Hagës e kanë dëshmuar po ashtu këtë që e ka thënë zonja Powers, duke i dënuar disa nga figurat e larta të shtetit serb për krimet kundër njerëzimit dhe për krime lufte në Kosovë. Të gjitha këto janë përdorur si argument para gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë, ku edhe një herë u dëshmuar që populli i Kosovës ishte viktimë e një represioni të organizuar, të sponsorizuar dhe të zbatuar nga shteti serb. Pra, në këtë rast nuk kishim të bënim me krime individuale, por kishim të bënim me një represion dhe një gjenocid shtetëror, të urdhëruar nga vetë shteti.

Në kontrast me zonjën Power, përfaqësuese në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqësuesi i Rusisë, zoti Çurkin, një njeri me urrejtje patologjike ndaj popullit shqiptar, tani i ngarkuar që ta çojë përpara rezolutën për tribunalin special, në rast se ne sot dështojmë, mendon që në Kosovë nuk ka pasur fare krim ndaj popullit shqiptar. Në fakt, në një takim që e kishim në prag të shpalljes së pavarësisë me të, ai qeshte me konstatimin se në Kosovë ka njerëz të zhdukur. Qeshte! Dhe, në qoftë se unë mund të bëj sot diçka që të parandalojë që e ardhmja e këtij tribunali të jetë në duart e këtij njeriu, unë sot do ta bëj duke votuar për këtë gjykatë.

Unë refuzoj, po e përsëris, që ta lë në duart e një njeriu të tillë propozimin e një rezolute, e cila në cilindo variant, pavarësisht ndërhyrjeve që mund t'i kenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, apo edhe shtetet e tjera, do të përfundojë si rezultat një tekst kompromisi, i cili përsëri do të jetë më i keq se sa amendamenti që sot e kemi para vetes. Të lejohet që të hapet rruga për një

vendim të tillë në Këshillin e Sigurimit dhe të miratohet një rezolutë e tillë, që na kthen në kohën e shpalljes së para pavarësisë, do të ishte cenimi më i rëndë i sovranitetit tonë.

Duke marrë përgjegjësi si Kuvend, por edhe si deputet individual, ne mund ta parandalojmë një skenar të tillë, duke deleguar sovranitet, në këtë rast përveç Dhomës së Posaçme brenda Kosovës, edhe në një dhomë të posaçme, e cila do të ketë adresë të qartë. Ajo do të bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, e cila do të negociohet me Holandën, si shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe do të ratifikohet në këtë Parlament, pra nga ky institucion i Republikës së Kosovës, duke ekzekutuar përgjegjësitë kushtetuese që i ka.

Nuk mund të themi që kriminalizohet e tërë lufta nëpërmjet gjykimeve individuale. Sikur të ishte ashtu, ka shumë ushtarë të Ushtrisë Amerikane që janë gjykuar edhe për shkelje të konventave të Gjenevës, edhe për shkelje të së drejtës së luftës, por kjo kurrë nuk ka çuar në përfundimin se është kriminalizuar e tërë lufta amerikane nëpër territore të ndryshme, luftë kjo që është bërë për të çliruar popuj të tërë.

Po thuhet se Serbia nuk i ka gjykuar kriminelët për krimet që janë bërë në Kosovë. Shumë e vërtetë, por a është Serbia shembulli që ne sot duam ta ndjekim. Vërtet edhe ne duhet ta japim një shembull të tillë? Unë mendoj që duhet të refuzojmë çdo paralelizëm. Ne duhet të dëshmojmë qoftë edhe për 100 vjetët e ardhshme, sepse lufta me Serbinë, po flas këtu lufta diplomatike dhe politike, nuk përfundon për pak vjet. Do të vazhdojë, sfidat tona në raport me këtë shtet do të vazhdojnë dhe ne vazhdimisht duhet të dëshmojmë që ne jemi ndryshe nga ata, edhe në qoftë se Rusia mbetet shteti i vetëm që e beson këtë skenar. Sepse, pa i bindur edhe ata, ne do ta kemi të pamundur të jemi anëtar i barabartë i kombeve të lira në Kombet e Bashkuara.

U tha këtu që vendimet nuk harrohen. Unë pajtohem shumë dhe dua të ndaj me ju një rrëfim. Pak para zgjedhjeve të fundit, në Aeroportin e Shkupit kam takuar disa të rinj që ishin kthyer nga Afganistani, sepse ishin atje bashkë me ushtrinë amerikane dhe ata më thanë që në zgjedhjet e fundit, që u mbajtën në qershor, kanë ardhur nga Afganistani për të votuar për disa prej nesh. Dhe, kur i pyeta pse, ata thanë sepse me këtë datë 'ke votuar kështu, ke votuar kundër kësaj marrëveshjeje' dhe për mua kjo ka qenë një ndër momentet më të rëndësishme në karrierën time politike që ta shoh që vërtet këto vendime nuk harrohen. Dhe, në qoftë se unë sot gaboj, lutem shumë që ata qytetarë nesër të më gjykojnë dhe unë pres që të më gjykojnë.

Le të më gjykojnë, mirëpo le ta gjykojnë edhe secilin, i cili është i bindur që ky skenar, për të cilin unë deri tani fola, mund të ndodhë, qoftë edhe një 20% të ndodhë, dhe sot pretendon që fëmijët e vegjël që e kanë humbur jetën në luftën e Kosovës, dikujt këndej i dhimbsen më shumë, e dikujt këndej i dhimbsen më pak, sepse kjo absolutisht nuk është e vërtetë. Absolutisht nuk është e vërtetë! Është shumë e lehtë të zgjohen ndjenjat e secilit në këtë Parlament, sepse secili prej nesh kemi përjetimet tona në luftë, ka prej nesh që kemi përjetime edhe pas lufte, sidomos shumë zyrtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për të cilët u fol sot, mirëpo ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës mund të kritikohemi se ndoshta po gabojmë profesionalisht në analizën tonë, ndoshta vërtet keni të drejtë disa prej jush që po thoni ky nen interpretohet ndryshe, ky ndryshe.

Na kritikoni profesionalisht. Na kritikoni në vlerësimin që ne po ia bëjmë amendamentit dhe ligjeve që do të votohen, apo nuk do të votohen sot, nuk e di cili do të jetë epilogu përfundimtar.

Mirëpo, jo të thuhet sot që dikush ka dhembshuri më shumë e dikush ka dhembshuri më pak, sepse ne kemi mandat edhe në rastet e tilla të vështira, kur e kemi një vendim të tillë para vetes, por mendojmë që mund të ngjajë shumë më keq në qoftë se një institucion tjetër vendos ndryshe, ta parandalojmë duke mos lejuar që të bëhet një cenim aq i rëndë i sovranitetit të vendit tonë, duke e rikthyer UNMIK-un.

Unë shpresoj që me votën time sot për Gjykatën Speciale ta jap atë kontribut të vogël. Në qoftë se do të gaboj, natyrisht që do të më gjykojnë qytetarët e Kosovës dhe le të jetë ky mandati im i fundit. Le të jetë kjo madje edhe dita e fundit në karrierën time politike. Por, unë jam e bindur, flas me bindje të plotë, flas me përgjegjësi të plotë, që ky vendim sot po bëhet për të parandaluar diçka shumë më të keqe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani ka ardhur tri herë te foltorja. Urdhëro!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Desha ta falënderoj Vjosën për fjalimin që e mbajti - ligjëratë shumë e bukur, shumë interesante, ata që kanë ardhur prej Afganistani kanë menduar se bëhet kryetare e Lidhjes Demokratike, prandaj për atë arsye kanë ardhur.

Dhe ta falënderoj po ashtu edhe për fjalën që tha për veprimet që i kanë marrë dhe i marrin për rezoluta. Unë këtu e kam një vendim të Këshillit të Evropës, që e ka mbajtur dje edhe është kërkuar një rezolutë për gjenocidin serb në Bosnjë për Srebrenicën dhe nuk ka kaluar. Domethënë, 8 mijë veta janë vrarë, e një rezolutë në Parlamentin Evropian nuk ka kaluar! Kjo do të thotë që krejt janë relative dhe jo të arsyeshme ato që i tha. Prandaj, unë dua të filloj, para se ta kërkoj atë çështje, dua t'ju jap disa fotografi të Burgut të Dubravës, që keni mundësi t'i shikoni.

Ky është komandanti i burgut, Miki Vidiq. 130 veta janë të vrarë në Burgun e Dubravës. Këtu shihet me makinë brenda burgut. Këtu shihen brenda burgut të vrarët, këtu shihen të vrarët e tjerë, kush ka mundësi t'i shohë, por disa edhe nuk i shohin. Këtu mund të shihen të gjitha, janë viktimat.

Këtu shihet tjetri i vrarë me pushkë në dorë. Edhe ky është këtu, dhe këtu është i vrari, kur vëllai e bart të vvarin, nga Gjakova janë. Këtu e kemi një kallëzim penal që e kemi bërë pikërisht për këta vrasës që dihet nga drejtori i burgut, nga komandanti i burgut, nga anëtarët ose udhëheqësit e burgut. Të gjithë janë, e nuk kemi asnjë vendim.

Këtu e kam një shkresë tjetër të drejtorit të burgut. Dosje kemi sa të duash, dhe e drejtori i burgut të Mitrovicës flet këto ditë për një rast të Ukshin Hotit. Flet për Ukshin Hotin, thotë shqiptarët e kanë vrarë posa ka dalë 100 m prej Burgut të Dubravës, dhe ky është një rezultat shumë interesant i politikës që zhvillohet, pikërisht këto ditë që ta fusë një përçarje brenda nesh. Krejt të burgosurit e dinë që ky drejtor drejtpërdrejt, ata 60 burgosur që kanë qenë në Burgun e Mitrovicës së Stremit, e dinë kush e ka rrahur, si e kanë rrahur, si e kanë torturuar, si e kanë masakruar shpirtërisht dhe fizikisht Ukshin Hotin atje. Pikërisht është ky drejtor, Trifun Ivkoviqi.

Dhe askush asnjëherë nuk është përgjigjur. Edhe vetë Ukshini në fjalën e vet ka thënë që kur të dal unë duhet të flas, duhet të tregoj qysh ka qenë gjendja, ndërsa thotë ti je... Natyrisht se... gjithëherë kur na kanë rrahur kanë thënë jeni rrëzuar prej krevatit, nuk kanë thënë që ju kemi rrahur ne. Prandaj, gjitha këto janë ato që ne kërkojmë t'i bëjmë. Gjykata ka pasur nevojë të jetë në Kosovë, jo për UÇK-në. Ka pasur nevojë të jetë një gjykatë në Kosovë për krimet e luftës, e atëherë do të kishim mundur t'i përcaktojmë krimet individuale, por s'ka krime individuale, atëherë pozicioni është, e përmendën kolegët të gjithë, nuk dua të përsëris më shumë, por dua të kërkoj nga shefat e grupeve, dua të kërkoj nga deputetë, unë jam kundër votimit dhe kundër kësaj gjykate. Kjo gjykatë nuk mund të më dënojë mua, nuk mund ta dënojë unë veten me votimin tim.

Vuajtjet e viteve e të burgut e të luftës t'i bëj në kurriz, e të them që unë kam gabuar që kam luftuar, të them kam gabuar që kam qenë pjesë e burgjeve, ose vuajtjeve, dhe lufta jonë për liri ka qenë jo e drejtë! Nëse unë do të votoj, unë do të them që kam qenë dhe jam kundër lirisë, kundër çlirimit të Kosovës dhe kundër lirisë sime. Jam kundër gjykatës, sepse kam luftuar me të drejtë për çlirimin e Kosovës dhe çlirimi i Kosovës e ka fituar këtë të drejtë të jemi sot dhe të votojmë këtu.

Kërkoj nga shefat e grupeve të deklarohen, kërkoj mocion që fjalët retorikë deri tash pati mjaft, ndoshta edhe unë ju kam mbajtur pak retorikë, por kërkoj që t'i ndërpresin fjalimet dhe të hyjmë në pjesën e votimit. Në pjesën e votimit, kërkoj që të kemi votim të fshehur, sepse kemi tri lloje votimesh, neni 50 i Rregullores së Kuvendit e përcakton formën e votimit. Votimi është i hapur, votimi është me dorë dhe votimi është i fshehtë. Rregullorja e Kuvendit e përcakton, ndërsa pika D e nenit 50 thotë: "Mund të ndërpritet debati dhe kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare".

Kërkoj nga grupet parlamentare të deklarohen për votimin, për formën e votimit. Unë kërkoj votim të fshehtë. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi një propozim, derisa i kemi pesë deputetë, të cilët janë lajmëruar. Realisht, në ndërkohë le të flasin deputetët, të përgatiten grupet parlamentare, por s'kemi prej kujt ta fshehim votën tonë.

Ne s'kemi pse të frikohemi prej askujt për votën tonë, secili e jep në mënyrë të hapur. Pse ta fshehim? Atëherë, edhe pesë diskutues i kemi, e në ndërkohë, kërkoj falje se po e vërej reagimin, kur jemi futur këtu së bashku me shefat e grupeve parlamentare kemi biseduar - askujt s'do t'i ndalet fjala. Le ta tërheqin fjalën, përfundojnë diskutimet. Për mua ,moralisht nuk është e mirë ta ndalim çështjen e fjalimeve, për votim pastaj në fund, kur të mbarojmë me diskutimet, e vendosni ju, në fund të fundit.

Tash u paraqitën tetë. Fjalën e merr Njomza Emini, në ndërkohë le të merren vesh shefat e grupeve parlamentare.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar kryeministër, akademik Isa Mustafa,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Dhe ju kolegë deputetë,

Edhe unë si ligjvënës dhe përfaqësues e qytetarëve të Republikës së Kosovës mendoj që duhet të diskutojmë në baza të primeve të shëndosha dhe t'i informojmë drejt qytetarët tanë.

Formimi i Gjykatës Speciale në Republikën e Kosovës është dakorduar, siç e dini edhe ju, me ratifikimin e letërkëmbimit me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës vitin e kaluar dhe tash kemi ardhur deri te formalizimi i kësaj gjykate përmes votimit që do të ndodhë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne si shtet, siç e thanë edhe kolegët e mi deputetë, nuk është se kemi zgjedhur me dëshirë formimin e kësaj gjykate, sepse konsiderojmë se lufta çlirimtare e popullit tonë ka qenë e drejtë dhe e tillë do të mbetet çdoherë, por duhet kuptuar se themelimi i kësaj gjykate është një obligim ndërkombëtar, që krahas obligimeve tjera ndërkombëtare, Republika e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran duhet mbajtur përgjegjësitë e veta në arenën ndërkombëtare.

Gjykata Speciale, duhet ta kemi parasysh, që nuk e gjykon luftën e qytetarëve tanë për liri dhe pavarësi, por do ta gjykojë individ të caktuar dhe asnjëherë nuk do të arrihet të njolloset lufta e drejtë e qytetarëve tanë. Unë, krahas kolegëve të mi këtu, e kuptoj që ky proces është i rëndë dhe si i tillë është i vështirë për t'u kapërdirë, por situatë më e rëndë do të jetë në Republikën e Kosovës në rast se kjo çështje arrin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe atje vendoset në kushte, të cilat nuk mund të parashikojmë nga këtu dhe do të ishim të obliguar t'i pranojmë pa vullnetin tonë eventual si institucione të Republikës së Kosovës.

Dihet mirëfilli dhe deri më tani është provuar disa herë se qytetarët e Kosovës kanë qenë viktimë dhe aparatura shtetërore e Serbisë dhe grupet paramilitare serbe që kryen krime gjatë luftës kanë qenë agresorë, por ky kapitull do të jetë i fundit dhe do të nxitet krijimi i një gjykate të veçantë për gjykimin e individëve, që supozohet që kanë rënë ndesh me ligjet dhe zakonet e luftës.

Po e ritheksoj edhe një herë dhe duhet të jemi të qartë para qytetarëve tanë se lufta e çlirimtarëve, e bijve dhe bijave tona që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit, nuk mund të njolloset asnjëherë, sepse falë këtyre jemi këtu dhe votimi i themelimit të kësaj gjykate në Republikën e Kosovës asnjëherë nuk nënkupton papjekurinë institucionale apo dobësinë e institucioneve tona përballë të tjerëve, por është marrje e përgjegjësisë ndërkombëtare dhe dëshmi se jemi të aftë të vendosim për veten tonë, pa shkuar çështja në Këshillin e Sigurimit dhe funksionimi i kësaj gjykate të na imponohet në kushte tjera.

Si në të gjitha rastet tjera, besoj edhe kësaj here, ne si Legjislative, por duke mos e anashkaluar edhe Qeverinë dhe Presidencën e Republikës së Kosovës, do t'i dëshmojmë faktorit ndërkombëtar për partneritetin e ndërtuar dhe parimet e shëndosha dhe të qëndrueshme të punës që na karakterizojnë si Republikë e Kosovës. Unë jam për gjykatën, për themelimin e Gjykatës Speciale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Labinotë Demi-Murtezi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Kuvendi i Kosovës dhe populli kosovar janë sfiduar shumë herë dhe vazhdojnë të sfidohen. Një nga sfidat e mëdha është edhe kjo seancë e sotme dhe vota jonë për ose kundër Gjykatës Speciale. Kjo situatë e rëndë na rikthen në kronologjinë historike të vendit tonë dhe jo vetëm në luftën e fundit. Secili nga ne këtu i ka ende të freskëta dhe do t'i ketë të freskëta deri në vdekje ngjarjet e luftës së Kosovës, ngjarjet e viteve '98, '99.

Ne i shihnim masakrat dhe e vazhdonim shkollimin. I shihnim masakrat, e vazhdonim luftën dhe këngën. Secili nga ne e kishte të ngulitur në kokë thënien e urtë dhe ambicien e lartë "Liri, pavarësi dhe demokraci!".

Dhuna e gjatë e ushtruar me vite e dekada, si fizike e psikologjike, nga Serbia dhe Milosheviqi, i detyroi qytetarët që të organizohen dhe t'i përgjigjen edhe me pushkë kundër agresorit serb.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës doli në fushë. Ishim të vetëdijshëm çfarë force kishim ne, e çfarë force kishte Serbia. Por, ne e kishim një ideal të pathyeshëm dhe një mendje të prerë - jetë a vdekje! Ishim të bindur në atë që kërkonim, por edhe shpresonim në përkrahjen ndërkombëtare. Ne besonim te politika e urtë e Ibrahim Rugovës, ne besonim te pushka e Adem Jasharit, besonim te vendimet e liderëve tanë në Rambuje, besonim te nxënësit dhe studentët që e donin shkollën dhe universitetin në liri dhe, mbi të gjitha, bota na besoi neve dhe na ndihmoi t'i japim fund bashkë njëherë e mirë një dhune të vazhdueshme represive.

Kosova dhe liderët e saj u gjykuan edhe në Hagë dhe dolën të pafajshëm, e jam e bindur se sa herë që ne pyetemi dhe gjykohemi për veprimtarinë tonë, vetëm do ta dëshmojmë shpirtin tonë fisnik dhe do ta rritim krenarinë tonë dhe krenarinë e vendit. Unë nuk do ta ftoj askënd të votojë as për as kundër kësaj gjykate, por unë e vlerësoj dhe e respektoj çdo deputetë dhe mendimin e gjithsecilit. Kjo gjykatë do të bëhet qoftë nga ne, qoftë nga OKB-ja. Unë vetëm dua të them se besoj, siç kam besuar gjithmonë, te çiltërsia e çdo bashkëvendësi tim në luftën për liri në çdo lloj forme që e kanë bërë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Doruntinë Maloku e ka fjalën.

DORUNTINË MALOKU: Të nderuar deputetë, Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, Shumica këtu e thanë se lufta e UÇK-së ka qenë e pastër dhe se nuk ka nevojë të pastrohet. Kjo është shumë e vërtetë. Nuk ka nevojë të pastrohet dhe as të gjykohet lufta për çlirimin e Kosovës, sepse po të kërkonim diçka të tillë, do të duhej të gjykoheshin edhe shtetet më të fuqishme të botës, aleatët e Kosovës, të cilat morën vendim për ndërhyrje ushtarake kundër Serbisë, intervenim i cili e bëri të mundshëm kthimin e më shumë se 1 milion shqiptarëve të Kosovës në shtëpitë e tyre dhe e detyroi largimin e forcave ushtarake dhe paraushtarake serbe në Kosovë.

Ne sot po vendosim për themelimin e gjykatës, nga e cila pritet ta bëjë atë që të gjithë ne dështuam ta bëjmë. Dështuam t'i mbrojmë viktimat, t'i mbrojmë dëshmitarët dhe dështuam që të siguronim procese të drejta dhe të paanshme. Madje, dështuam të nisim procese gjyqësore, pavarësisht se dosjet janë të kompletuara dhe myken nëpër sirtarët e prokurorive. Pra, Gjykata Speciale është rezultat i dështimit të shumicës së partive për ta krijuar një sistem të drejtësisë, i cili do t'i hetonte krimet, do t'i gjente fajtorët dhe do t'i dënonte ata.

Do të doja që ju t'i kishit adresuar shqetësimet tuaja edhe pas publikimit të raportit të Këshillit të Evropës mbi kërcënimin e vrasjen e dëshmitarëve në Kosovë. Raportuesi Zhan Çarls Kardeto pati shprehur shqetësimin e thellë për mungesën e pavarësisë së sistemit të drejtësisë në Kosovës, siç pati thënë ai, 'i kapur nga korrupsioni'.

Shumë nga ju përmendët sot masakra, vrasje dhe zhdukje të civilëve të pafajshëm, përfshirë fëmijë, pleq dhe gra, krime këto të kryera nga forcat paramilitare serbe, shumica krime të pagjykuara, të cilat absolutisht duhet të dënohen, por krime të cilat u dëshmuan dhe i treguan botës mbarë, kryesisht nga Qendra për Informim i Kosovës, dy shefat e së cilës u vranë para shtëpive të tyre, njëri babi im i vranë më 1999 para syve të mi, dhe tjetri Xhemajl Mustafa, i vranë në vitin 2000, në hyrje të shtëpisë së tij, pra i vranë pas luftës në Kosovën e çliruar.

Ju që po thirrreni si qytetarë të ndershëm të Republikës, sa herë keni kërkuar zbulimin e këtyre vrasjeve? Sa herë kërkuat drejtësi për personalitet e shquara të Kosovës, të vranë pas shpine? Sa herë keni kërkuar sistem të mirëfilltë për mbrojtjen e dëshmitarëve? Shumë prej këtyre viktimave kanë qenë pjesë aktive dhe e rëndësishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo vetëm të LDK-së. Apo ju e çmoni vetëm një pjesë të UÇK-së? Pse po i frikësoheni kaq shumë drejtësisë? Ai që është i pastër nuk ka nevojë t'i frikësohet drejtësisë. Shumë familjarë dhe miq të mi, disa që jeni edhe këtu kolegë të mi, që ishin pjesë aktive e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk janë kundër Gjykatës Speciale. Ata jetojnë të qetë, sepse janë të vetëdijshëm se përgjegjësia për çfarëdo krimi të pretenduar do të jetë individuale.

Prandaj, mos e përdorni Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për poenë politike. Lufta për liri ka qenë e popullit. Ju nuk mund ta monopolizoni atë, as ta përvetësoni, e as ta interpretoni sipas interesave tuaja të ngushta. Unë ju ftoj që, në emër të drejtësisë së mohuar për qindra viktime të luftës dhe të pasluftës, ta votoni themelimin e kësaj gjykate. Mos u bëni pjesë e përpjekjeve të kundërshtarëve të Kosovës për krijimin e gjykatës nëpërmjet Këshillit të Sigurimit! Tregoni se me të vërtetë e çmoni drejtësinë kudo dhe në çdo kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Ramiz Kelmendi e ka fjalën, Sadri Ferati u lajmërua ndërkohë, pastaj Naim Fetahu, Albin Kurti.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar,
Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministër,
Kolegë deputetë,
Dhe ju qytetarë të nderuar,

Sot është një ditë sprove dhe një mundësi t'i tregojmë komunitetit ndërkombëtar se jemi shtet, kemi lidhë dhe struktura shtetërore mirë të organizuara dhe dimë t'i ruajmë dhe ta avancojmë miqësinë ndërkombëtare. Është keq të thuhet sot se deputetët po e krijojnë një gjykatë ndërkombëtare. Ne nuk po votojmë sot për krijimin e akuzave ndaj luftëtarëve apo të gjykatës akuzuese. Këto akuza janë evidente dhe të bëra publike. Po kërkohet vetëm votim për heqjen e këtyre akuzave të padrejta nëpërmjet gjykatës, e për fat të keq speciale dhe jashtë Kosovës.

Gjykata Speciale është obligim ndërkombëtar, është obligim shtetëror, është obligim për largimin e akuzave që na i kanë ngjitur, e ato mund të hiqen jo duke folur nëpër mëhalla e lagje,

por duke prezantuar fakte para gjykatës për pastërti. Këto hiqen vetëm nga Gjykata Speciale. Është për t'u çuditur se kjo gjykatë do të duhej realisht të krijohet për akuzimin dhe gjykimin e krimeve që kanë bërë forcat serbe, të mbështetura nga serbët lokalë.

Çfarë padrejtësie! Por, duke e ditur pastërtinë e luftëtarëve tanë, edhe kjo sfidë do të fitohet. Nga ky obligim ndërkombëtar dalin shumë detyra. Ky obligim ndërkombëtar nuk duhet të na e marrë krejt energjinë dhe ne të merremi vetëm me mbrojtjen nga këto akuza. Duhet të vazhdohet me promovimin e shtetësisë së Kosovës në shtetet e botës, ashtu siç po vepron Zëvendëskryeministri, Kryeministri dhe Presidentja.

Duhet të vazhdohet me ngritjen dhe mirëmbajtjen e miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n, të vazhdohet integrimi në EU dhe në NATO. Të punohet edhe më shumë në ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe thithjen e investitorëve të shumtë. Të punohet që ky obligim të mos na dërgojë në drejtim të gabuar politik dhe ekonomik, që do t'i kënaqë armiqtë tanë të jashtëm.

Të nderuar deputetë,
E kemi fituar luftën, do ta fitojmë edhe paqen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naim Fetahu, Albin Kurti, Shaip Muja... Ka mundësi që edhe unë si kryetar i Kuvendit t'i them nja dy fjalë.

NAIM FETAHU: I nderuari kryetar i Kuvendit, Veseli!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot, si asnjëherë më parë, që nga themelimi i institucioneve të Kosovës, jemi para një sfide të madhe. Duhet të vendosim ndërmjet themelimit të një gjykate, e që të gjithë pajtohemi që është e padrejtë, apo t'i themi jo këtij varianti, për t'u përballur me një variant aspak të këndshëm dhe që del pengesë serioze në zhvillimin e vendit.

Me këtë gjykatë do ta ruanim pastërtinë e luftës sonë të drejtë çlirimtare dhe njëkohësisht do ta ruanim partneritetin strategjik me miqtë tanë, që rrjedhimisht i bie se ne po investojmë në perspektivën e vendit dhe të fëmijëve tanë. Lufta e UÇK-së ishte dhe do mbetet e drejtë dhe çlirimtare, e cila është vërtetuar edhe nga gjykatat ndërkombëtare, si Gjykata e Hagës në dy raste, gjykatat e UNMIK-ut dhe të EULEX-it dhe askush në asnjë formë nuk do të mund ta njollojë luftën tonë.

Ne luftuam t'i mbrojmë shtëpitë tona, familjet tona, vendin tonë. Ne luftuam për t'u çliruar nga një pushtues. Është e vërtetë se për luftën në Kosovë duhet gjykuar pushtuesin. U përmendën edhe nga shumë parafolës sot këtu shumë masakra, vrasje, tortura, dhunime dhe mijëra të zhdukur që mbetën të pagjykuara, ndërsa sot po kërkohet që të gjykohen çlirimtarët, ata që e mbrojtën prapë dhe nderin e shtëpisë.

Jam i bindur se ky proces nuk është i lehtë, ama jam i bindur se kjo gjykatë edhe një herë, për të fundit herë, do ta vërtetojë pastërtinë e luftës së UÇK-së dhe Kosova do t'i ketë dyert e hapura

për t'u integruar në institucione dhe mekanizmat ndërkombëtarë, duke e hapur perspektivën e zhvillimit të vendit dhe të fëmijëve tanë.

Kosova ka dëshmuar dhe vazhdon ta dëshmojë gatishmërinë për ta mbështetur vendosjen e drejtësisë në vend dhe për t'i hequr edhe këto dyshime të pabazuara dhe të ngrehura mbi bazën e shpifjeve dhe të spekulimeve. Ecja përpara e Kosovës duke bashkudhëtuar me një raport, si ky i ish senatorit evropian Dik Marti, pa i hedhur poshtë pretendimet e tij është e pamundur. Andaj, unë për ta hequr çdo dyshim që mund t'i vihet luftës sonë dhe njëkohësisht për ta ruajtur dhe kultivuar edhe më tej të ardhmen, tonë do t'i them po Gjykatës Speciale. Po besoj se në këto rrethana kjo është më e mira për vendin dhe po ashtu jam thellësisht i bindur në pastërtinë e luftës tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip Muja, sepse Albini po dëshiron i fundit Shaip. Është lider opozitar, duhet dhënë këtë përparësi.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot, pavarësisht sa do të rrini serioz ju përballë këtu, unë do ta mbaj seriozitetin, do të mundohen së paku, ose nuk do të shkëputem nga ajo çfarë dua të them.

Sot është një temë jashtëzakonisht e vështirë, shumë e vështirë. Është shumë e rëndësishme dhe me shumë pikëpyetje dhe me shumë paqartësi, të cilave ne duhet t'u japim drejtim. Unë personalisht mendoj që raporti i Dik Martit është një produkt i të gjithë neve. Është i të gjithë neve, sepse që në fillim ky raport është injoruar si raport politik dhe si raport i tillë politik është fryrë nga shumë elementë, duke filluar nga secila parti politike, e cila pa menduar mirë politikisht se sa do të shndërrohet në akt juridik ky dokument, ka bërë që sot për çdo gjë që po flasim është e vërtetë. Çdo gjë që ka ndodhur në Kosovë është e vërtetë dhe për krimet nuk është dhënë drejtësia e drejtë për Serbinë. Nuk janë dhënë drejt as vendimet gjyqësore, me të cilat janë duke u dënuar ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mirëpo ne jemi para një akti të kryer, një akt i cili nuk mund të revokohet, siç thotë populli "Nuk ruhet çurani për ditën e Bajramit".

Ne është dashur të punojmë pak më herët dhe ujkun e kemi sjellë ne vetë në torishtë. Prandaj, ne duhet t'i dimë faktorët që e sollën këtë gjendje. Ne nuk ishim edhe në disa media, të cilat që në fillim kur është bërë ky raport, unë e di ditën e parë një media, që s'po dua t'i bëj marketing politik e jashtë spektrit publik, më ka pyetur: 'Çka e mendon ti, pse je në këtë raport, si person i përfolur për trafikim të organeve?' Dhe, i kam thënë tri çështje duhet të jenë këtu: qenka raport shumë serioz, e akuzuar popullata e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, unë personalisht, që kërkon zgjedhje gjyqësore të drejtësisë në Prishtinë, Bruksel ose Uashington.

Dhe, ne këtu asnjëherë nuk jemi organizuar seriozisht si institucione, që të fillojmë këtu brenda Republikës së Kosovës të gjejmë drejtësi, e kjo formë sot mori akt juridik. Ne partitë politike si u sollëm tash e gjashtë vjet? Duke filluar në mandatin e kaluar, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, s'po dua t'ua përmend emrin deputetëve, le t'i lexojnë arkivat, çdo kund ku kishim ndonjë rezistencë sikur kjo, akuzoheshim o trafikantë, o kriminelë, o gjithçka. Ndërsa, këta miqtë tanë ndërkombëtarë që shohin këtu, nuk ka njohin që jemi të papërgjegjshëm politikisht dhe thonë derisa tri herë thuhet për dikë që është trafikant, ky duhet të jetë trafikant, prandaj t'u hyjmë hetimeve. Nëse s'po i bëjnë këta hetimet vetë, duhet t'i bëjmë ne. Ne, duke filluar nga

“Vetëvendosja”, e cila thirret ndoshta edhe si partia që duhet t’i kërkohet certifikata për patriotizëm, le ta shohin në arkiv çka kanë folur.

Ato çka u kemi folur, ne i kemi bërë dosje dhe ato dosje nuk bëhen. Le t’i shohin deputetët e Partisë Demokratike, të cilët fshehtas, për ta fundosur ekzistencën e rezistencës politike brenda, kanë thanë ‘hajt se ndoshta e ha ky person ose ai person brenda partisë dhe dënohet, e ne shpëtojmë’. Do të thotë, papërgjegjësi politike.

Prandaj, ne nuk mund të krijojmë me këto prononcime gjykatë vendore të besueshme, sepse vetë e kemi humbur legjitimitetin për ta krijuar një gjykatë të tillë dhe tash ne po duam të bëhemi avokatë në ditën e fundit, se po harrojmë që ne kemi deponuar. Ka deputetë që gjatë fushatës deklarojnë: “Në Komoran do ta bëjmë një universitet mjekësor, ku rektor do të bëhet Hashim Thaçi, Azem Syla dekan dhe unë do të bëhem shef i transplantimit”. Ato janë të shkruara. Prandaj këto çështje duan kërkesë, duan përgjigje. Ata deputetë me këta deputetë që kanë deponuar dhe të cilët ndoshta edhe kanë frikë, sepse ata që kanë deponuar fshehtas, pa fakte, qoftë ata nga Partia Demokratike, qoftë nga Lidhja Demokratike, qoftë nga “Vetëvendosja”, ose deputetët tu Ramush, na nuk mund t’i fshehim. Macja në thes nuk mundet të hyjë.

Prandaj, ne jemi vetë fajtorë. Jemi vetë fajtorë, sepse kemi akuzuar politikisht. E kemi akuzuar njëri-tjetrin për kriminel. Kur t’i thuash personit kriminel, duhet ditur që ke goditur rëndë. Kur t’i thuash dikujt hajn, duhet pasur fakte. Nëse e duam Kosovën, duhesh shkuar të deponosh.

Këto media që shkruajnë, unë e pashë sot një gazetare tha: “Ata që po i frikësohen gjykatës...”. Nuk është që po i gjykojnë, se edhe ata që po duan, po kanë qejf, duke eliminuar një faktor politik, për të ardhur një faktor tjetër politik pa kurriz, pa butak, nuk bëhet shteti kësaj.

Prandaj, unë besoj thellë që 2,6% aktive e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tash po e tregojnë edhe statistikën, nuk kanë qenë bartësit ose detonatori i sovranitetit. Ne e falënderojmë faktorin ndërkombëtar që na ka parë që jemi të bindur dhe unë nuk e besoj që faktori ndërkombëtar do të luajë me sovranitetin e Kosovës. Nuk do ta lërë Kosovën territor, i cili mund të bëhet për trajtime anarkike, politike, ndërkombëtare ose kombëtare, dhe ne nëse mendojmë ashtu, le të na marrin të gjithëve, por ne duhet ta kemi një përgjigje: Kush do të ma pastrojë dosjen time për akuzat që janë bërë? Askënd s’e dëgjova. Ata që kanë akuzuar, ata që kanë shpifur duhet të japin deponim. Ata duhet t’i sjellin faktet dhe nuk duhet të ikim nga kjo çështje.

Prandaj, ne duhet ta krijojmë këtë gjykatë, edhe pse e dhimbshme është. Është jashtëzakonisht e rëndë, mirëpo ne e kemi humbur legjitimitetin juridik që të jemi seriozë, edhe në aspektin juridik, edhe në aspektin politik.

Dhe, këtu fajtori është te të gjithë ne. Mos kërkoni fajtor tjetërkund. Çdo recitim që e keni bërë është për mrekulli. Ne të gjithë kemi të vlarë në familje, kemi dëshmorë, kemi të dëmtuar dhe jemi të dëmtuar në esencë, qoftë në zhvillimin ekonomik, qoftë në zhvillimin arsimor, në të gjitha drejtimit, mirëpo ne nuk guxojmë ta zëmë peng vetveten, duke thënë se ne nuk po krijojmë diçka, me të cilën ne sot po e shpëtojmë kombin dhe po prishemi me të gjithë.

Nuk e dëgjova askënd se cili është opsioni. Cila është vërtetësia e asaj çka po themi ne? Unë nuk mund të jem i besueshëm nëse unë kam akuzuar çdo ditë, sot dikë, e të kthehem tash të besoj se unë po kundërshtoj një diçka që s'po di si po kundërshtoj. Dhe, këto çështje janë të pabesueshme sot. Unë personalisht nuk jam për t'u dënua populli shqiptar. Nuk është i barabartë krimi, të cilin e ka bërë Serbia. Serbia ka bërë krim. Serbia ka bërë gjenocid në Kosovë dhe disa akte të veçuara, të cilat janë bërë pa vetëdije ndoshta, mund të bëhen të baraspeshuara, por nuk e besoj që faktori ndërkombëtar do të luajë edhe me sovranitetin e Kosovës, por nuk e besoj që shqiptarët do të vdesin krejt. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

KRYETARI KADRI VESELI: Faleminderit, shumë!

Në rend të parë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për korrektësinë e jashtëzakonshme dhe pjekurinë, të cilën e kanë treguar, veçanërisht sot në seancë.

Realisht, dita e sotme është shumë e vështirë, por jam shumë i sigurt se pas të sotmes hapen disa dilema që do të jetë besa edhe më e vështirë. Krejt kjo çka po shihet dhe kjo çfarë po bisedojmë aktualisht këtu, e tregon një qëndrim, një shqetësim të përbashkët të të gjithë neve. Jemi të shqetësuar, por unë besoj fuqimisht se asnjëri për veten këtu nuk është i shqetësuar. Jemi të shqetësuar për të ardhmen e vendit tonë, për sovranitetin e shtetit tonë. Jemi të shqetësuar besa edhe për papërgjegjësinë e atyre që kanë kryer krime dhe që deri më sot ende nuk janë përgjigjur. Jemi të shqetësuar besa edhe për perspektivën e fëmijëve tanë në shtetin tonë, në Republikën e Kosovës.

Realisht, si qenie njerëzore ne funksionojmë në bazat e emocioneve dhe të arsyes. Çdo gjë çfarë kemi biseduar, pavarësisht mundit, ka pasur nganjëherë edhe gjeste kur nga emocionet janë bartur tek individët, por janë të rënda për arsye se edhe faktikisht 16 vjet pas luftës shumë masakra që janë bërë askush nuk është përgjigjur. Në të njëjtën kohë, jemi duke u ballafaquar me një moment si sot, kur duhet me marrë një vendim, ne vetë duhet marrë vetë një vendim, realisht për të shkuar drejt një procesi, të cilin dikush e quan gjykim të historisë sonë, dikush e quan zhdaravitje të një mjegulle, e cila i është vendosur Republikës sonë, shtetit tonë, luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Realisht, po shihet që nuk po mund të dalim të bashkuar nga kjo situatë. Realisht, po shihet se nuk po mund të dërgojmë edhe mesazhe në mënyrë të bashkuar nga kjo situatë. Desha vetëm t'i theksoj nga dy momente, të cilat besoj bashkërisht, pavarësisht qëndrimit të cilin e kemi pasur, të mos krijojmë keqkuptime, veçanërisht te faktori ndërkombëtar.

76 ditë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e NATO-s e kanë sulmuar Serbinë, me gjithë makinerinë vrasëse, pikërisht për disa nga arsyet, të cilat sot deputetët i përmendën, këtu. Ato kanë qenë veçanërisht vrasjet dhe masakrat, të cilat i kanë bërë ndaj popullatës civile. Andaj, ndoshta nuk do të ishte shumë korrekte, shpeshherë përdoren të njëjtat elemente, të cilat janë reale, të historisë sonë, të cilat do të duhej ne si politikë këtu më së pari, edhe njëherë po e

ritheksoj, pas 16 vjetësh, duhet të na vijë pak turp, se ky Kuvend i Republikës së Kosovës, asnjë rezolutë nuk e ka nxjerrë për dënimin e krimeve të Serbisë gjatë luftës, as 1998, as 1999, as 1945, as 1968, as 1981-ës. Realisht, kjo është një situatë e cila nuk është shumë e mirë.

Pastaj, nën 2, pat shumë atakime të cilat u bënë, se bashkësia ndërkombëtare, konkretisht po flasim këtu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimi Evropian, duan të na e cenojnë sovranitetin tonë. Realisht, unë tash flas si deputet, edhe unë jam munduar të jap kontributin tim për vendin një kohë, veç nuk e di çfarë sovraniteti do të mund të ndërtojme pa këtë partneritet dhe pa këto shtete. Ndoshta, dikush ka zgjidhje tjetër, ndoshta mendon se realisht do të na cenojnë sovranitetin, por unë besoj fuqishëm, se mbi vullnetin e popullit tonë, i cili ka qenë i fuqishëm, ka qenë ky partneritet, që ne sot bashkërisht e gëzojmë lirinë, e kemi shtetin tonë të përbashkët dhe ecim përpara.

Gjykata Speciale, pa cinizëm, është një e keqe e cila na ka ndodhur. Po të kishim qenë të aftë, nuk do të vinte Gjykata Speciale e Kosovës hiç, realisht. Po, kjo ka ardhur një realitet, i cili në momentin kur po flasim tani, pothuajse është i pashmangshëm për vetë faktin, se nuk po na thotë as Rusia, as Kina, as Serbia, formojeni Gjykatën Speciale. Edhe unë nuk e besoj, në këtë rast dëshiroj të komunikoj veçanërisht me të gjithë bashkëluftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me një vendim, në qoftë se e marrim ne këtu, për refuzimin e kësaj situatë, e cila është kërkesë e partnerëve tanë ndërkombëtarë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, që të krijohen dhomat e specializuara, përmes votimit në këtë Parlament, në mënyrë që të mos i lehet Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marrë një vendim tjetër për të nxjerrë jashtë Kosove, nuk besoj se do të mund ta ndalim.

Të gjithë bashkëluftëtarët e mi edhe tuajt, që jeni këtu, duhet ta dimë se nuk do të ndalen arrestimet, veç se do të shtohen arrestimet, po thonë 5-6, ndoshta mund të jenë edhe 20, askush prej nesh nuk e di atë, por realisht veçse frikësohemi se do të shtohen sanksionet ndaj vendit të Kosovës. Dhe po them edhe personalisht, është pak e rëndë, kur njeriu flet, për arsye se nesër në qoftë se ndodh dhe nuk ke një aktakuzë të tillë, do të thonë, e ka ditur ai, për arsye se për vete s'e ka pasur, për ata insistonte për ta votuar. Por, sido që të jetë, edhe po ta dija, për besë të Zotit, se i pari do të jem, jam shumë krenar që kam qenë në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk kam dashur kurrë të flas për atë histori, por pasi që ka një gjykatë, jam një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jam prej fillimit të formimit të saj, kam marrë pjesë në çdo aksion që ka qenë i mundur, jam krenar për luftën, e kam përkrahur çdo zhvillim që ka qenë në vendim tim, nuk jam kurrë pishman për atë. Në të njëjtën kohë, nuk ia tërheq asnjë presje luftës sime, për arsye se kam luftuar kundër barbarëve, në të njëjtën kohë kam qenë i besës, qysh jam deri më sot.

Gjykatën Speciale, frikësohem, se as ju, as unë, nuk do ta ndalim me këtë votim, këtu, përkundrazi, vetëm do ta dëmtojmë krejt vendin përmes mos votimit të kësaj Gjykate Speciale. Kjo është arsyeja pse unë do ta votoj Gjykatën Speciale, të mos pësojë kurrkush për shkak meje. Realisht, më mirë është të pësojmë ne disa si individë, edhe kështu boll na kanë fyer, ou çka kemi dëgjuar fyerje... paçavura të njerëzve më të ulët, të njerëzve të padijshëm edhe njerëzve të pasherr, të cilët i kanë mashtruar të tjerët, se e zeza e Kosovës vjen prej këtyre njerëzve.

Realisht, le ta dinë shumica e bashkëlufëtareve, unë s'besoj se do të ndalen fletarrestimet për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, me ndaljen e kësaj Gjykate Speciale. Unë frikësohem se do të ketë edhe më shumë procese gjyqësore të llojit, qysh u arrestua dhe u dënua komandanti i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pa kurrfarë faktesh, Sylejman Selimi, në të njëjtën kohë edhe kryetari i komunës së Skenderajt dhe komandanti i Zonës Operative të Drenicës. Andaj, më mirë të ballafaqohemi njëherë, në mënyrë që të ndalen këto histeri, të ballafaqohemi përmes partnerëve tanë. Atje, po thonë se është më e drejtë, atje do të shkojmë, por kurrkujt nuk i frikësohemi në çdo ballafaqim.

Faleminderit ! Sido që të jetë, votimi do të jetë i lirë. Kush do voton siç dëshiron, vetëm të kemi transparencë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë, për sqarim, isha i lajmëruar më herët, po Salihu ma ka fikur dritën dhe më është dashur ta përsëris kërkesën. Kërkoj falje.

Faleminderit, për mundësinë ta them edhe unë mendimin tim!

Siç po shihet, të gjithë këtu po i flasim mendimet tona, po krijojmë opinion. Por, nganjëherë me qëllim, ose pa qëllim, me motive nga më të ndryshmet edhe temat e rënda po i bëjmë edhe akoma më të rënda. E vërteta, Kosova ka një përvojë jo të mirë me gjykimet e njerëzve të saj. Kemi pasur raste që edhe kryeministri i Kosovës të çohet në gjykim mbi supozimet, që merret me mend se ku një kryeministër burgoset, një thes fakte e argumente duhet të jenë paraprakisht, ani pse jo të konfirmuara, sepse atë e bën gjykata, po megjithatë dihet se në cilat rrethana dhe si duhet të çohet në gjykim një lider, pra edhe një lider dhe një kryetar i një qeverie.

Po ashtu, kemi përvojë të keqe edhe mbi fillimin e dyshimeve, sepse kryesisht të gjitha janë bërë mbi dyshimet dhe materialet që janë marrë nga Prokuroria serbe. Shumë rrallë kemi pasur rastin ne të lexojmë, se ka pasur marrje dhe faktografi nga pozitat neutrale, ose edhe nga ekspertët neutralë.

E gjitha kjo dhe mungesa e drejtësisë, në raport me gjithë ato masakra dhe gjithë atë që ka ndodhur në Kosovë, edhe kjo nuk është e mjaftueshme që ne sot mos ta dallojmë se për çka po bisedojmë. Ne nuk jemi këtu për të votuar sot për atë që ne dëshirojmë. Nuk ka qenë kjo iniciativë e asnjë institucioni të Republikës së Kosovës. Dihet se si ka ardhur dyshimi, se ku kanë filluar ato dyshime, se si kanë ndodhur hetimet dhe pranë cilit material jemi. Kosovës i është mundësuar kjo mundësi që ta votojë këtë gjykatë, përndryshe unë besoj në fjalët e atyre me të cilët kemi përvoja të mira në bashkëpunim, se mos votimi sot nuk e ndalon pretendimin e drejtësisë. Pra, edhe kjo gjykatë do të formohet në rrethana, në një rrugë tjetër, po që është më e keqe për Kosovën.

Unë deri më tash nuk kam pasur rastin të dëgjoj së paku, se dikush është dënuar, është hetuar, se ka qenë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare dhe pse ka luftuar në forma të ndryshme për lirinë e Kosovës. Prandaj, bie ai pretendimi se njolloset Ushtria Çlirimtare. E vërteta, nuk po i shkon përshtati e gjitha kjo rejtingut të Kosovës, ajo është për keqardhje, mirëpo gjatë tërë ditës unë dëgjova dhe ende nuk dëgjova një argument të një alternative, që na ofron një mundësi më të mirë, nëse nuk e votojmë, cila është rruga tjetër e mirë, a kemi zgjedhje? Unë them, se nuk kemi. Mua askush s'më ka bindur deri tash, se e kemi. Kam parë një meskinizëm, se ne s'po e votojmë, të bëhet çfarë të bëhet, le ta votojë Këshilli i Sigurimit, jo, nuk është njëjtë. Neve nuk na paguan ky popull, as si pozitë, as si opozitë, për t'ia bërë qejfin, as me provua që të parën fjalë kur të dalim në foltore "të nderuar qytetarë - të nderuara vota", jo, jo. Ai neve na paguan për ta udhëheq këtë popull, për ta forcuar këtë shtet, alternativa nuk është për ta refuzuar.

Merreni me mend ju, çfarë deklarimesh ka pasur javëve të fundit. Mungesa e sovranitetit – kush po na e merr atë sovranitet? Kush është ai që po e merr sovranitetin, ai që të ka ndihmuar ta bësh? Kjo nuk qëndron. Nuk qëndron njollosja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Çka është realiteti? Realiteti është se kemi disa dyshime, që ne duam t'ia japim mundësinë të shkohet deri në fund. Mirëpo, ne thërrasim të gjithë ata profesionistë që do të merren me këtë punë, që të mos maltretohen njerëzit me dyshime të pabaza të Serbisë, të Prokurorisë së Serbisë, po të jenë më realë në këto gjykime, të jenë gjykime të shpejta, të mos maltretohen njerëzit dhe pas pesë vjetësh që u shkatërrohet iu thua një ditë, ej këto argumente qenkan të pabaza.

Prandaj, unë personalisht do të angazhohem dhe do ta votoj këtë gjykatë, jo pse e kam dëshiruar, jo pse e kam iniciuar, jo pse kam gjetur alternativë, po dua t'i jap mundësi rastit të drejtësisë ndërkombëtare, që është më e fuqishme se ajo vendore, në mënyrë shumë shpejt Kosova t'u kthehet problemeve reale jetike, sepse nëse ne e problematizojmë edhe nja dy vjet qytetarët tanë kanë për të jetuar, ishte gjykata apo s'ishte gjykata, kanë për ta harruar arsimin, kanë për ta harruar shëndetësinë, zhvillimin e ekonomik, integrimet evropiane, fuqizimin e shtetit të Kosovës.

Prandaj, për hir të këtij bilanci, unë do ta votoj, pra sot, gjykatën, sepse po i jap mundësi më të madhe. Kur e thashë në fillim, temat e rënda po i bëjmë më të rënda, pikërisht kështu po i bëjmë, se do vetëm ti qysh ke qejf dhe e pengon tjetrin që ta japë mendimin deri në fund. Po, pra. Edhe pa asnjë konsideratë i thua të gjitha fjalitë, kurrkush nuk të ndërprejë. Kur dikush e thotë mendimin e vet, ty të pengon dhe kujt i pengon, atij që më së paku ka kontribuar për të ardhur deri këtu. Po gjykohen ata që e kanë formuar shtetin e Kosovës, se po i mungon sovraniteti, po akuzohen miqtë e Kosovës, prej atyre të cilët sot kanë ardhur dhe po mendojnë se e kanë zbuluar botën.

Pra, duke dhënë votën, ne po e forcojmë, po i japim mundësi shtetit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! E kemi nga deputetët diskutuesin e fundit dhe përfundon maratona e diskutimeve. Fjalën e ka Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pse kemi këso seancash të ngutshme, ku vendime tejet të rëndësishme duhet të paraprihen me vetëm një debat disaorësh?

Ne, secilin ligj, ligjin e dhe më të thjeshtë, ne e trajtojmë në dy lexime të ndara, me dy muaj në mes, kurse ndryshimet kushtetuese po i nxitojmë shpejt e shpejt. Më shumë e më shpesh po ndryshohet Kushtetuta e Kosovës me amendamente, sesa cilido ligj në Kosovë. Ndryshimeve kushtetuese nuk po ua kushtojmë as kohën e vëmendjen e ligjeve të thjeshta.

Kosova, asnjëherë në historinë e saj nuk ka pasur kushtetutë të drejtë e të mirë, mirëpo edhe ndryshimet kushtetuese ishin famëkeqe në të kaluarën e të tilla janë edhe këto pas shpalljes së pavarësisë, përfshirë edhe këtë sot. Fundja, çfarëdo debati për ndryshimet kushtetuese dhe Gjykatën Speciale në Kosovë, duhet patjetër të paraprihet prej një debati për EULEX-in.

Pra, ky Kuvend duhet të debatojë njëherë për atë që e bëri e nuk e bëri EULEX-i, tek i cili para pak muajve shpërtheu një prej skandaleve më të mëdha të korrupsionit të pasluftës, nga prokurorja Bamje dhe jo vetëm ajo e vetëm më pastaj të diskutojmë edhe për Gjykatën Speciale. Le të diskutojmë për atë që patëm, para asaj që mendojmë se duhet të jetë.

Së paku në dhjetë vjetët e ardhshme në Kosovë e për Kosovën, nuk do të flitet për tjetër gjë më parë e më shumë, se sa për këtë Gjykatë Speciale, nëse ajo kalon me votimin tuaj. Tash që nuk është miratuar kjo gjykatë, nuk po përmendemi në opinionin publik ndërkombëtar. Edhe nëse nuk e miratojmë, ky do të jetë lajm marginal, edhe nëse e miratojmë ky sërish do të jetë marginal. Mirëpo, në dhjetë vjetët e ardhshme do të ndërtohet si lajm kryesor për Kosovën dhe Gjykata Speciale e Kosovës do të jetë edhe më e famshme, se sa Kosova jashtë kësaj gjykatë speciale.

Po, nëse ne nuk e miratojmë sot Gjykatën Speciale, Serbia do të propagandojë ca në botë, mirëpo si u bë, si nuk u bë kjo gjykatë, Serbia edhe ashtu do të shpifë për Kosovën, për UÇK-në e për shqiptarët. Imazhi i Kosovës do të nxihet pikërisht nga pasja e një gjykate të tillë në dekadën e ardhshme e jo nga mospasja e saj, të cilën mund ta vendosim ne sot këtu pas pak minutash.

Në faqen 44 të Programit qeverisës thuhet, që Qeveria me prioritet do të hartojë dhe do t'i propozojë Kuvendit për aprovim Ligjin për themelimin e kësaj gjykate, që tanimë është marrë si obligim ndërkombëtar nga ana e Republikës së Kosovës, në proceset integruese. Pra, po e përsëris edhe njëherë, është marrë si obligim ndërkombëtar nga ana e Republikës së Kosovës në proceset integruese. Së pari, s'ka lidhje kjo gjykatë në tentativë me proceset integruese. Nuk i afrohem Bashkimit Evropian pse patëm apo nuk patëm Gjykatë Speciale. Ne edhe ashtu jemi shumë larg, s'kemi as liberalizim të vizave, siç e dini. Dhe së dyti, edhe vetë Qeveria nuk po e arsyeton në programin qeverisës këtë gjykatë në tentativë me nevojën për drejtësi. Edhe vetë Qeveria kur e përmend Gjykatën Speciale në programin qeverisës, nuk e përmend me fjalën drejtësi, po me fjalën obligim ndërkombëtar.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të gjithë ata që e kanë kapur shtetin janë për Gjykatën Speciale. Nuk po them që të gjithë ata që votojnë për Gjykatën Speciale e kanë kapur shtetin, por të gjithë ata që e kanë kapur shtetin janë për Gjykatën Speciale, sepse ata që e kanë kapur shtetin, ata shtetin e shohin si vegël të vetes për veten e tyre dhe, jo si vlerë e dobi për të gjithë.

Persekutimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pardje nga UNMIK-u, ka vazhduar edhe dje e sot me EULEX-in edhe për shkak se UÇK-ja nuk përmendet as në Deklaratën e Pavarësisë dhe as në Kushtetutën e Republikës. Pra, as në Deklaratën e Pavarësisë, as në Kushtetutën e Republikës nuk e ke as luftën çlirimtare as Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Rrjedhimisht, ky shtet po ndërtohet duke e mohuar UÇK-në, prandaj edhe ajo është shpallur jo legjitime dhe i është hapur rruga persekutimit të saj.

E dini që është një traditë e lashtë tek shqiptarët dhe jo vetëm tek shqiptarët, që kur ndërtojnë një shtëpi të re, në themele e vendosin kokën e një dashi, nëse janë ca më të pasur, ose të një gjeli, nëse janë më të varfër dhe, këtë e bëjnë si kurban për themele të thella e shtëpi të qëndrueshme. Mirëpo, Kosova e ka kurbanin e saj. I ka 2500 dëshmorë, i ka mbi 10000 civilë martirë, i ka mijëra gra të dhunuara. Mirëpo, ky kurban ynë për shtëpinë tonë, se ashtu sikurse është ndërtesa ku banon familja juaj, shtëpia juaj, ashtu shteti është shtëpia e popullit, pra ky kurban ynë për shtëpinë e popullit, që quhet shtet, në rastin tonë Republikë e Kosovës, ky kurban është përjashtuar, nuk ndodhet në themele dhe për më keq se kaq, dashin e kanë ngrënë politikanët e brinat ia kanë kthyer popullit.

Prandaj, çka po synoni që t'i bëni UÇK-së ju sot dhe jo vetëm sot, e sidomos me përjashtimin nga Deklarata e Pavarësisë dhe Kushtetuta e Republikës, kurrë s'ka mundur dhe nuk do të mund t'ia bënte Serbia. Nuk bëhet fjalë për partneritet me ndërkombëtarë. Nëse ky është partneriteti, unë nuk e di çka është serviliteti. Bëhet fjalë për servilitet ndaj ndërkombëtarëve. E serviliteti është mungesë e vetë respektit. Kur të mungon respekti për veten tënde, kot e do zyrtarin ndërkombëtar, sepse nuk do ta kthejë mbrapa as dashurinë as respektin. E serviliteti i Thaçit dhe Mustafës dhe i të tjerëve ndaj burokratëve ndërkombëtarë nuk bëhet për hir të shtetit e të kombit, por nga motivet e qëllimet e ngushta personale. Këta nuk po lëshojnë pe se Kosovës po i duhet, po për shkak se po i duhet vetes së tyre.

Pra, nuk ka kurrfarë qëllimi fisnik në servilitet, përveçse serviliteti është i dëmshëm e i padrejtë në vetvete edhe në kontekstin ku ndodhet ai, është shumë i padrejtë e i dëmshëm, sepse është për motive të ngushta personale. Pra, këta nuk po nënshtrohen sepse është interesi i Kosovës, këta po nënshtrohen sepse është interesi vetjak i tillë. Nuk mund ta mbrojnë Republikën njerëzit që e konsiderojnë vetën dhe tjetrin dhe çdo tjetër shumë privatisht e shumë personalisht. S'ka Republikë pa publike, e këta njerëz nuk janë njerëz publik, këta janë njerëz privatë, çdo kund dhe çdoherë privatë dhe vetëm privatë.

E di që shumë njerëz në Kosovë, jo vetëm deputetë në Kuvendin e Republikës janë lodhur me këta mujsharët e pasluftës në Kosovë dhe thonë se "Hajt, se ndoshta kjo Gjykata Speciale do të na i heq qafe!" Pushtetarët e korruptuar, politikanët e krimit të organizuar, vrasësit e plaçkitësit e veshur me pushtet, as nuk duhet dhe as nuk mundemi t'i heqim qafe me iniciativa që vijnë prej Serbisë e prej Rusisë. Ata duhet t'i largojmë nga pushteti dhe me ta duhet të përballim vetë shoqëria jonë e ne qytetarët e këtij vendi. Shteti i kapur e mjerimi social u kanë ndodhur edhe popujve të tjerë, pra ne s'jemi fare "sui generis", por ata në shesh e me zgjedhje i kanë rrëzuar a larguar të korruptuarit e kriminelët, duke i hapur rrugë drejtësisë, demokracisë e zhvillimit. Bile, nuk është korrekte, nuk është fer, që vazhdimisht të kërkojmë të na i kryejë punët dikush tjetër, dikush prej lart, dikush prej jashtë.

Kësisoj, duke kërkuar që spastrimin e Kosovës nga të korruptuarit të na e bëjnë ndërkombëtarët, ne po e tregojmë se nuk jemi as qytetarë të Republikës përnjëmend e as deputetë të vërtetë të Kuvendit. Dëgjuam këtu edhe duke na thënë disa deputetë, po cila është alternativa? A din në çka më përngjan ? Po të afrohet një person, i cili ka vendosur të ta thyjë këmbën dhe ai person paraprakisht të njofton, që dëshiron të ta thyjë këmbën dhe ai të vjen e të thotë, cila është alternativa jote. alternativa ime është të mos ma thyesh këmbën.

Ndaj një personi që vjen të ta thyjë këmbën, nuk ke nevojë të kesh alternativë tjetër, përveçse të mos ta thyjë këmbën. Kjo tregon defensivën në të cilën ka rënë Kuvendi i Republikës, si organi më i lartë përfaqësues e legjislativ. Në Kosovë këta të korruptuarit pas meje e që besa edhe para meje, duhen akuzuar e gjykuar si kriminelë të paqes për atë çfarë i bënë popullit tonë për këta 16 vjet e jo si kriminelë të luftës për atë çfarë i bënë Serbisë, në ata 16 muaj. Po, unë pajtohem me ju, shumë prej këtyre e kanë vendin në burg edhe në mesin e deputetëve ka aso që e kanë vendin në burg, por në burgun tonë dhe jo me iniciativa të Serbisë e të Rusisë.

Jo pak liberalë në botë, se ky nuk është fenomen i izoluar për Kosovën, jo pak liberalë në botë, sidomos në shekullin 21, e bënë atë gabimin e mirënjohur, filluan që në emër të lirisë ta luftojnë fundamentalizmin e më pas për ta vazhduar luftën kundër fundamentalizmit, hoqën dorë nga liria. Ne duhet ta luftojmë këtë kastë të kriminelëve e të korruptuarve në emër të Republikës sonë e drejtësisë universale, në emër të kombit tonë e të demokracisë klasike, në emër të së drejtës e të drejtësisë, por ne nuk guxojmë që t'i sakrifikojmë të gjitha këto, vetëm që të mund t'i luftojmë këta pushtetarë të krimit.

Nuk duhet ta humbim arsyen. Nëse një person ka vrarë, ai nuk duhet të jetë në burg për dhunim dhe anasjelltas, sepse padrejtësia është e dyfishtë. Nuk po fut më për vrasje dhe po e fut për dhunim. Kjo po ndodh edhe në Kosovë. I gjithë zelli dhe pasioni është që këta njerëz të hiqen nga skena politike, sepse e kanë vjedhur Kosovën e pasluftës. Shumë mirë. Mirëpo, le t'ua japim mirënjohjen e paraluftës e të luftës e le t'ua japim edhe dënimin e pasluftës në emër të luftës, në emër të ardhmërisë sonë dhe të nevojës për zhvillim e përparim.

Ky ngatërrim i tezave është tepër i rëndë, është padrejtësi e dyfishtë. Po e dënon për atë që nuk e kanë bërë dhe, nuk po e dënon për atë që kanë bërë.

Unë nuk do të thosha që ata që duan ta votojnë Gjykatën Speciale janë doemos jo patriotë, më parë mendoj që janë naivë. Kosova është vend i pazareve. Këta nuk t'i japin paratë e veta, se shokët e vet i japin. Bile, bile, edhe nëse dikush përfundon në burg, shumë më tepër kjo do të jetë se këta e dhanë, e sakrifikuan, se sa pse ai bëri ndonjë krim. Punën që s'e kanë bërë UNMIK-u dhe EULEX-i nuk do ta bëjë as Gjykata Speciale. Madje, kjo e fundit paraqet versionin ekstrem të UNMIK-ut dhe të EULEX-it, të cilët preferonin ushtarë të UÇK-së dhe jo ata të policisë e të ushtrisë së Serbisë, ndërsa, tash Gjykata Speciale këtë preferencë e bën edhe absolute edhe normë.

UNMIK-u e pati sjellë një rregullore, në bazë të së cilës nuk gjykonte askënd në mungesë, “in apscencia”. Dhe, asisoj i ndiqte pjesëtarët e UÇK-së, që janë këtu në Kosovë e jo kriminelët serbë që kishin ikur prej këtu. Gjykata Speciale është versioni ekstrem i UNMIK-ut dhe i EULEX-it.

Pra, nuk do të na e sjell Këshilli i Sigurimit i OKB-së një UNMIK të ri në vend të Gjykatës Speciale, po pikërisht kjo Gjykatë Speciale është UNMIK-u i ri në versionin e tij më ekstrem të mundshëm, duke imponuar gjykime etnike. Kjo Gjykata Speciale është UNMIK-u i ri. Nuk do të na vijë UNMIK-u i ri prej Këshillit të Sigurimit, UNMIK-u ka preferuar pjesëtarë të UÇK-së, njësoj Gjykata Speciale, jo vetëm që i preferon, por imponon drejtësinë selektive ndaj tyre.

E gjykimet etnike nuk janë gjykime. Gjykimet etnike janë paragjykime. Votimi për Gjykatën Speciale është votim për paragjykim etnik. Rrjedhimisht, kjo gjykatë është tashmë gjykim dhe ky gjykim është tashmë dënim, duke qenë paragjykim.

Le të kthehemi edhe përnjëmend te vota për si votë naive. Pse ky naivitet? Nga buron ai dhe çka e mundëson atë? Naiviteti i votës për vjen nga mendësia e pacientit dhe e të burgosurit. Pacienti dhe i burgosuri janë përplot vetëmashtrim, përplot shpresë naive, përplot dëshirë e aspak vullnet. Pacientit në spital dhe të mbyllurit në burg optimizmi u vjen nga mungesa e informacioneve.

Një autor i huaj thoshte që në jetë nuk ka lumturi pa pak vetëmashtrim, mirëpo te pacienti dhe i burgosuri, pothuajse e gjithë lumturia është vetëmashtrim. Mjeku e pacienti e kanë një raport special. Gënjeshtria duhet të jetë e atillë, sa që i gënjyeri i cili e beson atë, duhet ta bëjë edhe gënjeshtarin, që më pastaj ta marrë gënjeshtren e vet për të vërtetë.

Burokratët ndërkombëtarë që kanë bërë trysni mbi politikanët vendës nuk e besojnë këtë Gjykatë Speciale si të drejtë e të vërtetë, por pritët që besimi ynë me zell e pasion t'i bëjë edhe vetë ndërkombëtarët të besojnë. E dini qysh është kur motra medicinale në spital, një pacienti, i cili është në ditët e fundit të jetës, ia sjell supën dhe në buzëqeshjen e vetë të portokalltë e plastike i thotë: do të lirohesh javën tjetër, se e paske pirë supën krejt. Edhe pacienti e din se nuk është kështu edhe motra medicinale e din se nuk është kështu, por s'ia thonë njëri-tjetrit.

Ne të gjithë e dimë se kjo Gjykatë Speciale nuk është kurrfarë shërimi, kurrfarë drejtësie e kurrfarë lirie, mirëpo i gjithë diskutimi këtu bëhet, jo për të thënë diçka, po për të mos thënë asgjë.

Nga ata që deklaruan se do të votojnë për u tha që po e zgjedhin të keqen më të vogël, mirëpo ta zgjedhësh të keqen më të vogël do të thotë të zgjedhësh të keqen. Dhe, ta zgjedhësh të keqen më të vogël do të thotë, që pas kësaj zgjedhjeje ta rrisësh ca të keqen. E keqja më e vogël nuk është njësoj e vogël, sikur para se të zgjidhet, sikur pasi që të zgjidhet ajo. Por, mbi të gjitha, deri kur do të zgjedhim këso të këqijash më të vogla? Kur do ta zgjedhim të mirën? Dhe, sërish zgjedhje e vazhdueshme e të keqes më të vogël nuk është tipar i njeriut të lirë e sovran, por i atij që është i shtrirë në spital, ose i mbyllur në burg. I burgosuri dhe pacienti vazhdimisht e zgjedhin të keqen më të vogël.

Kosova nuk bëhet dot e lirë e sovrane, nëse të tillë nuk janë pikësëpari deputetët e saj, përfaqësuesit e popullit të saj si ushtrues të sovranitetit, siç edhe definohet në Kushtetutë. As disa prej deputetëve, që e bënë këtu njëfarë lloj vetëkritike mazohiste s'janë të drejtë e janë të dëmshëm. Le ta bëjnë vetëkritikën këta deputetë për veten e tyre, vetëkritikë individuale. Pse bëjnë këta deputetë vetëkritikë kolektive? Thonë: "s'është gjë populli jonë, s'është gjë shoqëria jonë, s'janë gjë politikanët në Kosovë, s'është gjë asnjë politikan në Kosovë"... jo po, fol për

veten tënde. Këta njerëz i kanë ambiciet e mëdha individuale, ndërkaq për të qenë më keq se kaq, nuk kanë fare vetëkritikë individuale, vetëm kritikë kolektive. Po, vetë e kemi kërkuar në Gjykatën Speciale. Jo, ndoshta ti e ke kërkuar. S'e kemi kërkuar ne, populli s'e ka kërkuar, hidhe në referendum edhe e sheh nëse e ka kërkuar populli.

Gjykata Speciale tashmë e ka sjell fillimin e rrëfimit të ri për luftën e fundit në Kosovë. Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Frank Valter Shtain Majer, se për të siguruar qetësinë në sallë mjafton t'ia përmendësh emrin një ndërkombëtar dhe menjëherë... Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Frank Valter Shtain Majer, gjatë vizitës në Kosovë para dy muajve deklaroi me sa vijon: "Nga përvoja gjermane mund të them, që ballafaqimi me të kaluarën është bazë për atë që njeriu të jetë i vetëdijshëm dhe të lëvizë përpara drejt të së ardhmes." Mirëpo, shtrohet pyetja, a nuk do të duhej që zoti Shtajn Majer ta thotë këtë në Beograd? Pse e krahason Kosovën e neve me Gjermaninë pas luftës së Dytë Botërore? Pikërisht Gjykata Speciale po bën që neve e jo Serbisë t'ia marrin për shembull Gjermaninë e pasluftës së Dytë Botërore.

U tha që edhe Serbia e ka njëfarë gjykate speciale atje, mirëpo për 160 mijë jo serbë të vrarë në katër luftërat në ish-Jugosllavi, nga gjykatat në Serbi për krime lufte e krim të organizuar janë dënuar vetëm 160 jo serbë. Thua se secili prej tyre i vrau nga 1 000, duke lënë anash kushtimisht për një moment, të torturuarit, të plagosurit e të dhunuarit. E shumë më tepër se kaq, tashmë kanë dënuar UNMIK-u dhe EULEX-i.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës, pas nënshkrimit të "Zajednicës", asociacionit të komunave me shumicë serbe, e për zbatimin e saj nevojitet një rrëfim i ri për Kosovën, një narracion i ri për luftën e fundit në Kosovë, që t'i bëhet vendi "Zajednicës". Gjykata Speciale ka mision historik e politik që t'i bëjë shqiptarët e Kosovës që kolektivisht të ndjehen fajtorë dhe ta pranojnë me turp instalimin e "Zajednicës" në Kosovë. Mbamendja jonë kolektive për luftën duhet ndryshuar, në mënyrë që të mund të implantohet në trupin e shtetit dhe të territorit të Kosovës "Zajednica".

Do të thuhet, që Serbia bëri shumë krime mbi shqiptarët, prandaj u lejua dhe u njoh Pavarësia e Kosovës, mirëpo shqiptarët i bënë krimet, prandaj u njoh "Zajednica" për serbët.

Tash për tash "Zajednica" nuk ka vend në Kosovë. Me rrëfimin e ri për historinë e Kosovës, nëpërmjet Gjykatës Speciale, qëllimi është që shqiptarët kolektivisht të ndjehen fajtorë dhe t'i bëjnë vend "Zajednicës" në Kosovë, si një entitet territorial, administrativ, autonom brenda Kosovës e kundër Kosovës.

Gjykata Speciale konsiston në një histori të re politike për Kosovën. Historia politike është parashikim i së kaluarës. Gjykata Speciale duke parashikuar ndryshe do ta shkruajë ndryshe historinë.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot, më 26 qershor të vitit 2015, janë bërë saktësisht 2 vjet, prej kur është votuar ratifikimi i marrëveshjes Thaçi – Daçi, me Serbinë. Pra, më 26 qershor të vitit 2013, u pat ratifikuar marrëveshja me Serbinë në këtë Kuvend. Saktësisht dy vjet më vonë po i hapet rruga gjykatës speciale dhe "Zajednicës". Të hënën, Mustafa e Thaçi do të shkojnë në Bruksel për

“Zajednicën”. Ata po duan që të hënë t’ia çojnë peshqesh Vuçiqit e Daçiqit, Gjykatën Speciale kundër UÇK-së.

Duke mos votuar për këtë Gjykatë Speciale kundër UÇK-së, ju i lini duarthatë Vuçiqin e Daçiqin, në Bruksel, si dhe e vështirësoni sajimin e “Zajednicës” në Kosovë. Nuk ka “Zajednicë” pa Gjykatën Speciale dhe nuk ka Gjykatë Speciale, pa “Zajednicën”. Nga historia e dimë se pas kapitullimit vjen Tribunali. Negociatat dhe marrëveshja e Thaçit me Serbinë, më 19 prill 2013 ishin kapitullim. Serbia i fitoi integritet evropian, njëherë statusin e vendit kandidat e pastaj edhe negociatat për anëtarësim, Serbia fitoi pushtetin në dhjetë komuna të Kosovës. Miliarda euro e dollarë janë dhënë ë Kosovë për multietnicitet e partia e Daçiqit e fitoi më shumë se çerekun e komunave të Kosovës, kurse Kosova po e fiton Gjykatën Speciale për krimet e pjesëtarëve të UÇK-së.

Gjykata Speciale është infra-struktura e bosnjëzimit të Kosovës. Me “Zajednicën” dhe Gjykatën Speciale, po i garantohet një luftë edhe brezit të ardhshëm në Kosovë, edhe fëmijëve tanë. Nuk ka asnjë brez të shqiptarëve pa, së paku, një luftë të përjetuar. Ka breza të shqiptarëve edhe me nga dy tri luftëra në jetën e tyre, po s’ka asnjë brez të shqiptarëve pa, së paku, një luftë. Ne kemi shpresuar, se mbase brezi që ka lindur pas luftës do të jetë ai i cili nuk do ta përjetojë luftën sikurse ne, mirëpo me Gjykatën Speciale e me “Zajednicën” edhe ky brez e ka luftën të siguruar.

Për fund, më lejoni ta kujtoj një thënie të Paolo Herkenhoff, kur thotë se kujtesa është përvojë që njerëzit e kanë vetëm kur mendojnë. Pra, kujtesa është përvojë, që njerëzit e kanë vetëm kur mendojnë. Mund të mendosh pa u kujtuar, por s’mund të kujtosh pa menduar e pa u menduar. Thirrja jonë te kujtesa historike është thirrje për të menduar për të tashmen dhe për të ardhmen. Ne po kërkojmë që ju të mendoni! Kush mendon për Kosovën, nuk ia bën asaj Gjykatën. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka deputetë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, zëvendëskryeministri e ka fjalën. Jemi në përfundim. E kemi një propozim. Po, Nait, tash e trajtojmë me shfat e grupeve parlamentare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

Po flas edhe në emrin tim edhe si kryetar i partisë më të madhe në Republikën e Kosovës, që nga tetë palë zgjedhje, gjashtë në fakt, po bëhen edhe tetë, por jo në emër të Qeverisë.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryetar Veseli,

Kryeministër Mustafa,

Ne, sot dëgjuam diskutime të cilat janë jashtëzakonisht mesazh edhe për të gjithë që jemi këtu, edhe për deputetë, por edhe për Kabinetin qeveritar.

Vlerësoj se secili nga ne që jemi këtu, kemi rrëfimet tona edhe personale edhe familjare edhe lokale prej nga vijmë, por dhe në nivel të Kosovës, për të kaluarën tonë. Dhe, secili mund të rrëfejme atë se çka ka ndodhur në Kosovë, si ka ndodhur dhe kush e ka bërë. Dhe natyrisht, se

shumica e këtyre rrëfimeve që u treguan këtu, janë jo të panjohura për opinionin publik, por gjithmonë janë tronditëse dhe rrëqethëse në atë se çka ka bërë Serbia, në Kosovë, me dhunën dhe represionin, me vrasjet, burgosjet, maltretimet, dhunimet deri në përmasa të gjenocidit.

Secili prej nesh jemi të vetëdijshëm se si Serbia ka atakuar gjithmonë lëvizjen politike për pavarësi të Kosovës, me etiketa prej më të ndryshmeve, prej më të ndytave të mundshme. Secili prej nesh, që jemi sot këtu, dhe shumë të tjerë që kanë sakrifikuar dhe që kanë treguar një mosbindje të plotë dhe unike qytetare ndaj Serbisë, kanë sakrifikuar për këtë vend dhe janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë, që kemi treguar edhe në të kaluarën, për përgjegjësitë që kemi edhe sot dhe përgjegjësitë që duhet t'i marrim edhe për të ardhmen.

Por, në të njëjtën kohë, ne e dimë se ballafaqimet tona në betejën për liri, në betejën për pavarësi dhe tash në agjendën integruese euroatlantike, janë këto përkushtime që mund të lëvizim përpara vetëm bashkërisht. Prandaj, vlerësoj se me një konsensus edhe politik edhe qytetar, ne jemi parti të ndryshme dhe është mirë që kemi krijuar realitetin e pluralizmit politik, sepse pa liri s'ka pasur hapësirë pa demokraci dhe pasi që fituam lirinë i ndërtuam edhe partitë politike, me programet dhe agjendet tona, por të gjitha me një synim shtetbërjen, konsolidimin e shtetit, forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve dhe perspektivën euroatlantike, pra që Kosova të jetë pjesë e NATO-s, e Bashkimit Evropian dhe në raporte speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Natyrisht se edhe kjo periudhë e 16-vjeçarit të fundit, nuk ka qenë e lehtë. Ka qenë një tranzicion rraskapitës, por ka qenë më i lehtë i mundshëm për qytetarët e Kosovës, në historinë e tyre ndonjëherë, sepse për herë të parë kemi jetuar të lirë dhe tash gati 8 vjet të pavarur.

Nëse fillojmë të diskutojmë për histori secili mund të prezantojë këtu orientimet e veta, zhvillimet e ndryshme dhe natyrisht represionin e vazhdueshëm më tepër se një shekullor të Serbisë, që ka ardhur duke ushtruar dhunë, ka qëndruar duke ushtruar dhunë dhe u largua duke ushtruar gjenocid.

Natyrisht se lëvizja politike për pavarësi në Kosovë, nuk ka qenë një lëvizje ideologjike, nuk ka qenë një lëvizje lokale dhe nuk ka qenë një lëvizje pa platformë, prandaj edhe e ka fituar besimin e qytetarëve të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës si kurrë ndonjëherë më parë u bashkuan dhe i thanë jo Serbisë.

Fillimi i rezistencës së armatosur që në fillim të viteve të 90-ta, ka qenë projekti më serioz kombëtar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, projekti më i vështirë, më i rrezikshmi dhe natyrisht më sakrifikuesi. Sot është shumë lehtë për të folur për atë periudhë, po pikërisht ajo përpjekje e viteve të tëra, ajo sakrificë që ka ndodhur në Kosovë edhe sot duhet të na bëjë më të përgjegjshëm në vendimmarrje tona.

Pasi që këtu kishte diskutime, natyrisht që s'mund t'i ikësh atij debati të ndërsjellë, edhe ndërpartiak nganjëherë, që është e tepërt, por edhe e përmendjes së emrave të veçantë.

Askush mos të mendon se ka qenë e lehtë të fillohet një mosbindje e plotë qytetare ndaj Serbisë dhe një rezistencë e armatosur kundër Serbisë. Të fillosh një rezistencë të armatosur kundër

Serbisë, në atë kohë ka qenë e paimagjinueshme për shumëkënd se do të fitohet liria, e do të ndërtohet pavarësia. Të fillosh një rezistencë pa një mbështetje mund të them jo të gjerë e fare ndërkombëtare, por kemi arritur që me përpjekjet tona, me sakrificat tona, në luftën tonë për drejtësi kemi fituar edhe mbështetjen e botës ndërkombëtare kur e filluam dhe fuqizuam luftën tonë në Kosovë dhe filluam të kemi mbështetjen gjithëshqiptare dhe atëherë e fituam edhe mbështetjen ndërkombëtare.

Projekti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është projekti më madhor i kombit tonë, është projekti që i ka sjell me sakrificën e të gjithë qytetarëve të vendit tone, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Nuk ka forcë që mund ta njollosë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe nuk ka sakrificë që ne duhet ta kalojmë që do të vonojë apo do të devijojë orientimin perëndimor të shtetit të Kosovës.

Meqë këtu u dëgjuan edhe opinione të ndryshme politike, unë për hir të transparencës, për hir të opinionit publik, për hir të përgjegjësive që kam kaluar në këto 16-17 vjet në emër të Kosovës, herë me ekipet e përbashkëta e herë edhe në përgjegjësitë institucionale që i kam pasur nga legjitimiteti qytetar i institucioneve tona, duhet ta them atë se çdoherë që kemi ndërmarrë veprime jo të lehta ka dal një sukses më madhor për Kosovën.

Unë dëgjova gjatë tërë ditës, prandaj kisha kërkuar që askush mos të hedhë fjalë nga vendi dhe kush do të polimizojë le të dalë këtu, deri në mëngjes rrimë.

Meqë është e pamundur për disa prej këtyre të “Vetëvendosjes” që të mos ma përmendin emrin, atëherë edhe unë natyrisht se do të jap përgjigje sqaruese për njerëzit.

Natyrisht se kemi pasur edhe opinione edhe rrugë të ndryshme me 3-4 bartës të kësaj lëvizje, s’flas për krejt lëvizjen as për krejt deputetët. Është e vërtet se unë s’kam shkruar ndonjë libër e as s’e kam ndërmend njëherë, por edhe unë jam një nga themeluesit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që në vitin 1992, i pëlqej dikujt apo s’i pëlqeu. Jam i dënuar prej Serbisë me aktakuza për këtë punë, ju e dini shumë mirë.

Jam pjesëmarrës aktiv dhe një prej organizatorëve kryesor, të themelimit, të forcimit, të riorganizimit, fuqizimit, masivizimit dhe fitores së luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jam krenar për gjithë atë angazhim dhe gjithë bashkëluftëtarëve të mi.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka kaluar nëpër situata jashtëzakonisht të rënda, në situata që pak kush ka menduar që do të mund të mbijetonte, por lufta e drejtë bëri që të mbijetonim dhe të fitonim dhe ta fitojmë edhe mbështetjen gjithëqytetare.

Unë vlerësoj dhe respektoj edhe angazhimet e gjithë njerëzve nëpër parti të ndryshme, edhe në atë kohë, por ajo që dëshiroj të theksoj sot këtu është se ne kemi pasur opinione të ndryshme edhe sa i përket organizimit të Konferencës në Rambuje.

Ky zotëriu që shtirret tash se jeni patriotë mega, patriot i kombit shqiptar, parafolësi, thoshte që duhet të shtyhet kjo konferencë, që kjo konferencë nuk i sjell asgjë Kosovës, se duhet të ndodhë

edhe me dy-tri stinë me luftë e pastaj të mbajmë një konferencë dhe pastaj të shohim se çka mund të ndodhë. Fliste jo në emër të UÇK-së se s'e ka pas atë autoritet kurrë, dhe gjithashtu mund të theksojë se vetë koha na dha të drejtë neve apo këtij. Ne që si delegacion i Kosovës e nënshkruam marrëveshjen me partnerët ndërkombëtarë dhe ndodhën bombardimet dhe e fituam lirinë.

Gjithashtu, thoshin që u shkatërrua UÇK-ja, u nënshkrua marrëveshja për transformimin e UÇK-së. Po, është nënshkrimi im dhe me krenari të plotë dhe përgjegjësi edhe morale, edhe politike, edhe kombëtare qëndroj fuqishëm pas atij nënshkrimi së bashku me gjeneralin Çeku për transformimin e UÇK-së në një forcë të re, në një Trupë Mbrojtëse, transformuese, edhe me zotin Haradinaj dhe të tjerët që janë këtu Ramushin dhe na u dha përsëri koha dhe realiteti na dha të drejtë. Përsëri erdhi momenti i fillimit të çështjes së statusit politik për të diskutuar në Vjenë.

Ne e dimë se ka pasur protesta, ka pasur ofendime të ndryshme ndaj ekipit të unitetit dhe ndaj të gjithë atyre njerëzve dhe thoshin që duhet të protestojmë sepse Kosova nuk do të pavarësohet, mirëpo ndodhi që Kosova u pavarësua. Delegatët - deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e lira, fer e demokratike, njerëzit legjitimë të këtij vendi e shpallën Kosovën të pavarur dhe sovran. Dhe, pastaj përsëri zotëriu doli dhe tha - kjo s'është pavarësi, kjo s'është Republikë, ky s'është shtet, kjo s'është liri. Ne përsëri vazhduam.

Sot, Republika e Kosovës është njohur nga 111 shtete. E di se ndokush mund të thotë po do të duhej të jetë pjesë e OKB-së. Edhe unë pajtohem, por ne kemi bërë kaq, i kemi sjell 111 njohje. Ma thuaj vetëm për një njohje a ke lobuar, vetëm për një njohje, përpos se ke folur zi e terr për Kosovën këdo që ke takuar, sepse s'të kanë pritur jashtë.

Sot, Kosova po anëtarësohet në shumë organizata rajonale, evropiane dhe regionale.

Të nderuar të pranishëm dhe përsëri Jeremiq ngriti pyetjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë se bërja e Kosovës të pavarur a ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare a jo? Përsëri ky zotëriu u qua e tha: Kosova nuk është e pavarur, kjo nuk është pavarësi, mirëpo dhe thoni që Kosova s'po përgatitet për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Këtu kemi dëshmitarë të atyre angazhimeve të jashtëzakonshme që janë bërë dhe përsëri Kosova fitoi dhe vendimi apo opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ishte i qartë: Deklarata e pavarësisë së Kosovës është në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Përsëri s'ia ke qëlluar, dhe kurrë s'ke për t' ia qëlluar me këto mend.

Formimi i Forcave të Armatosura të Kosovës, vitin e kaluar.... Po, mos e votoni - s'ka ushtri. Po thoni s'ka ushtri Kosova. Vitin e kaluar, me miratimin, me mbështetjen e partnerëve strategjikë dhe me pëlqimin edhe të NATO-s, Qeveria e Kosovës e ka marrë vendimin për themelimin e forcave të armatosura të Kosovës. Ne e kemi proceduar si Qeveri e Kosovës dhe për interesa të ngushta partiake, e them, fajin e kemi dhe e kanë ata që e kanë penguar themelimin e forcave të armatosura të Kosovës në këtë Parlament të Kosovës, sepse theksuat se janë zgjedhjet në qershor dhe po fitohen poenë politike. Prandaj, sot është dilemë e madhe se si do të mund t'i formojmë forcat e armatosura të Kosovës, ky është realitet, dhe ju e dini i nderuar.

Te dialogu me Serbinë, “zajednica”... mos u shqetëso se kurrë s’ka për të ndodhur ajo “zajednicë” qysh po ke qejf ti, për të ardhur e për t’i sharë këtu njerëzit, as bosnjëkizimi s’ka për të ndodhur. Ti e di shumë mirë që e kemi evituar edhe ndërtimin edhe autonominë në Mitrovicë, edhe formimin e një modeli Republika Serbe dhe ndarjen e Kosovës. Unë e di që ke qejf tema të tilla për të ardhur këtu e për të pretenduar të shesësh patriotizëm, po nuk të shiten ato, të jesh i sigurt, prandaj nuk të shiten ato.

Sot, ne kemi marrëveshje me dëshmitarë ndërkombëtarë sa i përket normalizimit të plotë të marrëdhënieve mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Është një marrëveshje që është ratifikuar po nga ky Kuvend i Republikës së Kosovës, prej njerëzve legjitimë të vendit tone. Është kjo një marrëveshje që dje në të njëjtën kohë e kemi rifuqizuar me pikën 6 mesa më kujtohet të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kërkohet të fillohet çështja e demarkacionit mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, sipas vijës kufitare të vitit 1974 dhe mendoj se pikërisht edhe çështja e hapjes së demarkacionit me Serbinë, është fillimi i njohjes reciproke të integritetit territorial të njëri- tjetrit.

Te dialogët që po diskutohen apo që e përmendët edhe më herët, ne kemi pasur seanca dramatike në këtë Kuvend, kemi pasur debate të pakëndshme shpeshherë, por kemi treguar kulturë edhe qytetare edhe politike në tejkalimin e atyre problematikave.

Ju dilni dhe flisni kundër dialogut, ndërsa në anën tjetër kur funksiononte ai VAN-i a si i thoshit në atë kohë në vitin e kaluar, ju vetë kërkonit personalisht ta udhëhiqni dialogun me Serbinë. Cili është standardi juaj? Cili është standardi dhe partia e juaj? Sot ju me dy-tre veta, Visarin, Albinin, Topallin e të tjerët, krekoseni aq shumë kundër themelimit të Gjykatës. Unë vetëm duhet t’ ju them, aktrimi juaj politik kinse jeni kundër gjykatës, tanimë është dalë mode. Në shpirtin tuaj vlon entuziazmi për themelimin e kësaj Gjykate.

Ju aktroni për të votuar kundër, por në shpirtin tuaj vlon entuziazmi për themelimin e kësaj Gjykate, sepse e sheh shpresën tuaj politike, por atë shpresë, tuajën politike e thyen legjitimiteti qytetar, prandaj të nderuar deputetë, unë ju ftoj... Mos u trazo tash.

Prandaj, të nderuar deputetë, unë ftoj që të veprojmë dhe të votojmë në përputhshmëri me interesat e shtetit tone dhe të së ardhmes së shtetit tonë dhe jo të ngarkuar nga politikat elektorale ditore. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Tash replikë, por në bazë të Rregullores. Urdhëro, Albin!

ALBIN KURTI: Kur i përmendët të gjitha kontributet tuaja gjatë luftës dhe para luftës për UÇK-në, është dashur ta vëni theksin te ajo e cila është më e rëndësishmja në fakt, çarmatosja. Nuk ka asnjë ushtri në botë, e cila ka pasur aq shumë humbje e vuajtje duke e bartur armatimin të cilin ju e keni nënshkruar të dorëzohet në fund. Asnjë ushtri nuk ka humbur aq shumë pjesëtarë të vet në kufi duke bartur armatimin të cilin ju e keni dorëzuar në fund. Dhe kjo është, jo vetëm pa përgjegjësi, por është edhe krim historik që e keni bërë.

Në përgjithësi ju jeni ngritur në karrierë me tri lëshime pe, duke e çarmatosur UÇK-në, duke iu kthyer privatizimit neoliberal dhe duke e braktisur bashkimin kombëtar. Me këto tri lëshime pe që janë kapitale ju jeni ngritur.

Ne kemi nevojë për politikanë të rinj në Kosovë, që ngrihen duke qenë radikal, jo duke lëshuar pe, që ngrihen, sepse ngrihet populli, e jo sepse bie ai.

Suksesi i Kosovës nuk ka qenë Konferenca e Rambujesë, por dështimi i saj. Nuk ka pasur njeri që i është gëzuar intervenimit të NATO-s, bombave të para në orën 20 të mbrëmjes, më 24 mars të vitit 1999 se sa unë vetë, sepse e kam ditur që kur të bien bombat e para atëherë bie dokumenti i Rambujesë.

Unë jam gëzuar shumë kur ka intervenuar NATO-ja, sepse ra dokumenti i Rambujesë, në fakt ai nuk ka ra plotësisht, sepse është rikthyer në Rezolutën 1244. Pra, suksesi nuk ka qenë dokumenti i Rambujesë që e keni nënshkruar ju, por mos nënshkrimi i Milosheviqit, përkatësisht dështimi i konferencës dhe fillimi i bombardimeve në NATO-s.

Ne nuk kemi thënë që Kosova nuk do të bëhet e pavarur, por me pazaret në Vjenë ajo pavarësi nuk do të jetë as e plotë as e vërtetë. Pavarësia matet me integritet territorial dhe të kufijve, me sovranitet, me ushtri, me ulëse në OKB e kështu me radhë. Pra nuk kemi thënë që s'do të jetë pavarësia, por do të jetë vetëm në emër, do të jetë vetëm në letër e jo në përmbajtjen, në substancën e saj dhe pikërisht ashtu ka dalë. Pra, jo që ia kemi qëlluar, por na e kemi ditur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdo edhe një minutë, por të lutem, përmbajuni!

ALBIN KURTI: Ne nuk ia kemi qëlluar, sepse e kemi ditur, ndërkaq ju po provoni t'ia qëlloni, por ju po ia huqni vazhdimisht, se nga kjo parajsa që po thoni që e keni krijuar në Kosovë, veç në muajt e fundit, kanë ikur 200 mijë qytetarë të Republikës.

Thatë që ne duhet të llobojmë. Unë nuk kam qenë në Qeveri asnjëherë, po edhe nuk jam njeri i lobimeve. Njerëzit e lobimeve janë njerëz të korridoreve. Fjala lobim rrjedh prej fjalës lobi, që do me thënë hol, paradhomë, kthinë, unë nuk jam i të tillave. Ashtu jeni ju. Njerëzit që llobojnë pëshpëritin në vesh te njerëzit tjerë dhe mundohen t'i impresionojnë të tjerët për të nxjerrë ndonjë favor në rastin tuaj personal, prandaj unë nuk jam njeri i lobimeve. Ju, dhe Pacolli, ai është tjetër regjistër.

Po, ju keni keqpërdorur dhe a e din çka më vjen keq, se jo vetëm që keni keqpërdorur vetë, po edhe familjarët tuaj i keni bërë si vetja e juaj. Gani Thaçi ka mundur të jetë një qytetar shumë i mirë i Republikës, për shkak se të ka ty kryeministër, u bë hajn edhe ai.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Albin, t'u ndal për shkak se të kaloi ai një minutë dhe e vazhduam. Mos ia nis fort të flasësh për familjarë të askujt! Zafir, urdhëro!

ZAFIR BERISHA: Unë desha të them se ishte e tepërt maltretimi që zoti Hashim Thaçi na e bëri në fund, veçanërisht kur u thirr si kryetar i partisë e jo në emër të Qeverisë. Në fakt si kryetar i partisë mund të flasë në konventa të partisë, ka folur sot nja dy-tri orë dhe deputetëve u ka bërë presion, por kjo që e bëri në fund ishte kulmi. Përfundimisht unë pajtohem me atë që e ke bërë, por veç një gjë dua ta them se historia njih shumë patriotë të cilët kanë përfunduar bashkëpunëtorë të kralit të Serbisë, për dy qypa lira. Dhe ju, zoti Hashim Thaçi, jeni ai që keni bërë marrëveshje me Serbinë, në dëm të Kosovës, rezultat i asaj marrëveshjeje keni legalizuar banda kriminale që janë në SHPK sot dhe qytetarët e Mitrovicës së veriut nuk i lënë të kthehen andej. Thuaja edhe këtë.

Thuaj se brenda kohëve të fundit 200 mijë qytetarë e kanë lëshuar Kosovën, sepse ju nuk keni krijuar shtet stabil me perspektivë evropiane dhe ekonomi të zhvilluar.

Edhe kjo është meritë e juaja. Ju zotëri keni formuar Gjykatë etnike në një pjesë të vendit që quhet veri i Kosovës që është në kundërshtim me Kushtetutën. Ju keni legalizuar forca ekstremiste serbe të cilat zënë urat e ndërlidhjes midis qytetit dhe qytetarëve. Prandaj edhe këto janë meritat e juaja dhe unë po besoj se kur të flisni këtu, flisni në emër të institucionit, përndryshe maltretimet janë të tepërta dhe në fund me shumë përgjegjësi si një ish- kolegj i yti po them, në këtë gropë që duash t'ia bësh shokëve të luftës, po të bindi se ke me ra vetë në fund. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, Ramush i ke 2 minuta, kurse zëvendëskryeministri në fund flet. Veç më dëgjoni, jeni duke e tepruar, jeni duke e keqpërdorur në aspektin familjar se s'keni burrëri të ballafaqoheni me gjykata. Urdhëro, Ramush.

RAMUSH HARADINAJ: Unë ju propozova më herët edhe kolegëve të grupeve tjera parlamentare që ndoshta të ndalim diskutimin në këtë etapë. Dhe disa prej nesh, që ishim në pritje, realisht e ndalëm duke shpresuar se kështu të paktën një klimë më korrekt do të mbizotërojë në ato momente kur duhet të vendosim.

Propozoj që në fund ta marrim këtë vendim, pra së bashku, të mos vazhdojmë më tutje me diskutime. Mendoj se mosvotimi i kësaj gjykate sot, s'e besoj që është vullneti i deputetëve ashtu, është një vendim i këtij Parlamenti, ne i marrim përgjegjësitë, jemi deputetë dhe na presin detyra tjera, që nga e nesërmja. Faleminderit!

KRYETARI: S'ka më diskutues. Hashim Thaçi, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, le të përgatiten grupet parlamentare për një emocion, i cili është nga Nait Hasani dhe të deklarohen.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Përsëri, i nderuar kryetar Veseli,
Kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë qëndroj fuqishëm pas të gjitha atyre vendimeve që kam pasur nderin t'i marr për vendin tim dhe për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës.

Askush nuk më ka iniciuar apo nuk më ka propozuar themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me përjashtim të atyre bashkëluftëtarëve që e kemi filluar. S'më ka imponuar as Amerika, as Bashkimi Evropian, as NATO. Rugës jemi bashkuar, është sukses, mrekulli është.

(Ndërhyrje)

Po mirë de, edhe se jam shitur, pasi i ka bombarduar, ndjehu mirë!

KRYETARI: Po, a e ke blerë ti Albin? Po meqë po thua çdoherë - e ke shitur! Po lëre të flasë, të lutem tash, se çdoherë po i ndërbyn.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ato vendime që janë marrë për Kosovën dhe në emër të Kosovës, të gjitha janë transparente, janë publike, kanë firma të njerëzve përgjegjës që kanë qenë në periudha të ndryshme historike të vendit tonë.

Këtu u theksua se UÇK-ja i ka humbur të gjitha betejat. Mendoj se kjo është fyerja më e rëndë që u bëhet luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare, komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dëshmorëve të lirisë, invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe gjithë popullit të Kosovës.

Ka ndodhur që s'jemi ndarë mirë në ndonjë betejë, por mos e harro zotni, Kosova e fitoi luftën dhe kjo i përmbylli të gjitha. Ti i ke humbur edhe betejat edhe luftërat, personalisht, por ndihem mirë që i gëzon të gjitha.

Përmendët çarmatosjen e UÇK-së. E theksova, kemi marrë vendim, krejt komandantët e zonave kanë qenë edhe gjeneral Çeku, në konsultim me ta është nënshkruar ajo marrëveshje dhe i qëndroj plotësisht asaj marrëveshje për transformimin e UÇK-së në Trupa Mbrojtëse të Kosovës, pastaj në një shpërbërje të lehtë dhe themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Edhe aty është nënshkrimi im, e gjen, këqyre, por nuk e gjen nënshkrimin dhe votimin tuaj vitin e kaluar.

Thatë që ju në një formë a formën tjetër e bëtë meritë Slobodan Milosheviqin për lirinë e Kosovës, që s'e paska nënshkruar Marrëveshjen në Rambuje. Meritë për lirinë e Kosovës është populli i Kosovës, është NATO, është SHBA, është Bashkimi Evropian.

Thatë që keni bërë gabime të ndryshme dhe u drejtuar në adresën time se keni bërë gabime të ndryshme politike. Se a kemi bërë gabime politike apo nuk kemi bërë, unë jam i vetëdijshëm, se kam bërë gabime plot, e ti je i pagabueshëm se je kështu i madhërishtëm. Mirëpo se kush ka bërë gabime dhe kush nuk ka bërë gabime e vlerësojnë vetë qytetarët. Unë theksova se që nga 5-6 zgjedhje i fitoj një pas një, e ti që nga 15 vjet je dhe veç ke humbur e ke për të shkuar teposhtë hala me këto mend.

E përmendët bashkimin kombëtar. Edhe dje të kam thënë, po të them edhe sot, më së paku ju jeni të përkushtuar në këtë angazhim, me përjashtim të ndonjë deklarimi verbal politik për ndonjë poen politik.

Thatë që nuk kam bërë lobim. Shumë mirë që u tregove këtu i sinqertë, mirëpo nuk u tregove i sinqertë që nuk u the të gjithëve, kam bërë dëm. E tash unë ju them, se edhe ka bërë dëm. Zafir,

me ju, ti e di, ne e bëjmë politikën ndryshe, ti edhe unë dhe qysh të kanë përjashtuar prej partisë Nisma, kështu që s'kam ndonjë koment. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi një propozim të deputetit Nait Hasani dhe grupet parlamentare duhet të deklarohen paraprakisht për të mos shkuar te interpretuesi i im i Rregullores, Arbeni. Arbeni e di se duhet edhe 2/3 e komuniteteve të përcaktohen që të jetë votimi valid. Edhe ju pra duhet të dini, por urdhëroni, deklarohuni. Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe pastaj secili grup parlamentar.

ADEM GRABOVCI: Zoti kryetar!

Grupin Parlamentar të PDK-së nuk e pengon as votimi i fshehtë, as votimi publik. Ne e kemi qëndrimin tonë të qartë, të jemi në shërbim të qytetarëve dhe të fuqizimit të shtetit të Kosovës. Por, ju e thatë atë që desha ta them unë, le të urdhërojnë propozuesi, le të na e sqaroj se si do t'i ndajmë votat e minoriteteve që kërkohen 2/3 e tyre.

Prandaj, nëse mundemi ta bëjmë këtë zgjidhje, edhe votimit të fshehtë, ne nuk i ikim, por ne e kemi deklarin tonë dhe s'na pengon votimi i hapur.

KRYETARI: Faleminderit! Më lejoni ta lexoj një këshillë juridike.

Duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim, Kushtetutës i referohet, do të kërkojë miratimin e 2/3 të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë 2/3 të gjithë deputetëve që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës. Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Rregullorja e Kuvendit na e përcakton punën tonë këtu dhe në bazë të kërkesës për mocion të nenit 50 të Rregullores së Kuvendit, mundësia e votimit është në tri forma, e hapur, elektronike dhe e fshehtë.

Për votimin e pakicave kemi mundësinë e votimit me letër me ngjyrë. Dhe kjo e jep mundësinë, ose kuti të veçantë. Prandaj, mundësia e votimit ekziston dhe kërkoj votim të fshehtë. Pra, për derisa po kemi mundësi për një Avokat të Popullit të kemi votim të fshehtë, apo për një anëtar të Gjykatës Kushtetuese për votim të fshehtë, ky është një referendum që tregohet që Kuvendi merr një vendim. Prandaj, kërkoj votën e deputetëve për votim të fshehtë.

KRYETARI: Faleminderit! Tash Ismet Beqiri e ka fjalën, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Ne e kemi thënë publikisht qëndrimin tonë dhe s'kemi pse të fshihemi, dhe ne nuk jemi që të shkojë në votim të fshehtë dhe të respektohet Rregullorja, çdoherë amendamentet janë votua me elektronikë, prandaj ne nuk shohim asnjë arsye sepse s'kemi për çka të fshihemi. Ata që donë të fshihen, po e lypin kësisoj. Ne nuk kemi çka të fshihim, e kemi qëndrimin tonë dhe posaçërisht kjo që ka të bëjë edhe me minoritetet na e fuqizon edhe më shumë këtë që ne të shkojmë ashtu si është me Rregullore, me votim me elektronikë.

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Të them të drejtën, nuk pajtohem fare me interpretimin e zotit Beqiri, për arsye se ky tha ashtu siç thotë Rregullorja duhet të votojmë me elektronikë. Neni 51 i Rregullores nuk thotë që duhet të votohet patjetër me elektronikë. Janë tri forma të votimit dhe e kemi një mocion procedural se si të votohet, prej një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili duhet të hedhet në votim. Kjo është e para.

E dyta. Mendoj që votimi i fshehtë do të shkonte në funksion të një lirie më të madhe të deputetit të Kuvendit të Kosovës për votim lidhur me këtë çështje. Pse? Jemi dëshmitarë të një trysnie të hatashme për deputetët e Republikës së Kosovës që të votojnë për një opsion të caktuar dhe kjo çka po bën zoti Beqiri është në funksion të asaj trysnie, se ky frikësohet që nëse votimi do të ishte i fshehtë ndonjëri prej deputetëve të tij do të mund të votonte edhe kundër. Kështu, duke i shantazhuar me votim të hapur, ai dëshiron që t'i kontrollojë ata më shumë.

Unë mendoj se nuk është e ndershme në këtë rast të hedhet me kaq lehtësi mocioni procedural i deputetit Nait Hasani. Unë mendoj që e meriton vëmendjen e tij, dhe kërkoj nga subjektet tjera parlamentare që ta mbështesin këtë lloj të votimit, sepse edhe shumë deputetë me të cilët jam takuar kanë kërkuar një liri më të madhe të shprehjes së vullnetit të tyre të lirë dhe pa presion.

KRYETARI: Ismeti e ka prapë fjalën.

ISMET BEQIRI: Pa dashur, nuk do të zgjas më, sepse t'ju them sinqerisht, shpesh njeriu mendohet a të flas dhe për t'ua kthyer këtyre që vërtet s'meritojnë as për t'ua komentuar çfarë komentojnë shpeshherë. Pikërisht të shkohet me votim të fshehtë është ajo që po e thua ti, për t'ua fshehur. Dhe, deputeti e ka lirinë të votojë dhe ju mos më mësoni as mua e as Grupin tonë parlamentar se si vendosim. Do të hidhet në votim kjo dhe tash po e them edhe në mend po ta kishim kur të flitni ju e bëjmë të kundërtën, këtë po ju tregoj.

KRYETARI: Donikë e ke fjalën. Të kemi parasysh se secili do të flas. Nuk do të ndalemi, krejt do të shkojmë në debat deri në fund e pastaj shkojmë në procedura, e ju e vendosni vet në fund. Donika, urdhëro!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Realisht ne konsiderojmë që kjo Gjykatë s'është dashur të votohet fare, as me elektronikë, as me votë të fshehtë dhe hiq, por pasi kemi mbërrirë këtu ku jemi dhe duke marrë parasysh se prej mëngjesit ato masat represive janë ndërmarrë ndaj deputetëve përmes Njësisë speciale dhe veprimeve tjera, edhe ne konsiderojmë se liria e deputetëve dhe e drejta e tyre në këtë moment për t'ua përcaktuar drejt duhet të bëhet përmes një votimi të fshehtë dhe jemi për votim të fshehtë.

KRYETARI: Lista serbe! Urdhëroni zotëri Sasha!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

S obzirom da je komplikovano da nevećinske zajednice glasaju tajno, ja sam u razgovoru sa mojom Grupom, tojest mi smo doneli stav da treba da se ovo glasanje obavi elektronski.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Myfera, nga Grupi “6+”, pastaj “Nisma”!

MÜFERA ŞİNİK: Sayın Başkan, aynı şekilde “6+” Parlamenter Grubu da elektronik oylamadan yanadır. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Myfera, të kemi marrë vesh. Ishit për mënyrë elektronike a? Atëherë për “Nismën”, Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Qëndrimi që e kemi pasur gjatë ditës, vazhdon për neve, a hapur, a mbyllur, a fshehtë, nuk ka peshë, sepse ne nuk marrim pjesë në këtë votim, sepse ne vlerësojmë se jeni dalë jashtë mandatit dhe jeni duke e bërë një shkelje të madhe të Kushtetutës së këtij vendi, me vetëdije, prandaj dhe nuk marrim pjesë.

Po unë do të doja t’i them nja dy fjalë proceduralisht. Asnjë pengesë procedurale nuk ka që mocioni i deputetit Hasani të shkojë, për atë që u mundua për 2/3 e serbëve qysh për t’i llogaritur komunitetet, sepse mënyra e votimit dihet me Kushtetutë dhe krijohen kushtet kur është e nevojshme dhe është me interes për Parlamentin, krijohen kushte që të shkohet edhe me votime të fshehta. Prandaj, proceduralisht nuk ka pengesa.

Ndërsa, vullneti se kur e qysh duhet votuar, është vullneti i deputetëve, ata vendosin si do të votojnë.

KRYETARI: Tash grupet parlamentare të gjitha janë shprehur. Nait ty të lëmë të fundit. Emilija e ka fjalën. Sasha, ke folur, dhe po më duket prapë je duke e kërkuar fjalë, e nëse s’do të flasësh, e tërheq. Urdhëroni Emilija! Nait ti pastaj, në fund.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala gospodine predsjedniče!

Ja bih želela samo kratko. Predlog gospodina Hasanija je uvredljiv i ponižavajući za manjinske zajednice. Mi ćemo glasati javno i transparentno i svi smo odgovorni za svoju odluku i odgovornosti tokom procesa glasanja. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Nait të lutem, merre fjalën, për arsye se realisht ka mundësi të shkojmë në votim.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Dua t’i tregoj kolegut Ismet Beqiri që votën time nuk e fsheh, e kam deklaruar që sa muaj publikisht se jam kundër. Dhe si publikisht si e fshehtë është e njëjtë vota ime.

Mirëpo problemi qëndron, Kuvendi i Kosovës e ka një Rregullore dhe Rregullorja na e jep të drejtën e votimit të fshehtë, neni 51. Prandaj, kërkoj mocion për votim të fshehtë. Kalon apo nuk kalon, le të mbetet përgjegjësi e Kuvendit. Mundësia është me ngjyrë, me kuti të veçantë dhe forma tjera. Pakicat kanë të drejtë të votojnë. Nuk është çështje e pakicave që ato duhet të na kushtëzojnë neve domosdo votën elektronike.

E tash deri sa folëm për demokraci deri më tash, tash në fund do ta shkelim demokracinë, prandaj kërkoj në mënyrë demokratike votimin e fshehtë ta bëni.

KRYETARI: Atëherë, të shkojmë shpejt. E kemi një mocion procedural, të propozuar nga deputeti i nderuar Nait Hasani, për votim të hapur apo të fshehtë. Ne po shkojmë po e votojmë në mënyrë elektronike, dhe kush është për votim të fshehtë dhe kush është për votim të fshehtë e kur është kundër, bie propozimi.

Do të thotë, votojmë për mocionin e deputetit Nait Hasani, për votim të fshehtë. Nëse jeni për, shkojmë në votim të fshehtë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë janë 116 deputetë.

I kemi gjithsej 108 vota të hedhura, 60 janë kundër propozimit të nderuarit Nait Hasani, 46 janë për dhe 2 abstenime.

Tash edhe një herë të shkojmë te këshilla juridike, e kemi qartësuar mënyrën e votimit.

Pra, duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim i Kushtetutës, do të kërkojë miratimin e 2/3 të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë 2/3 e gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Pra, nevojiten të paktën 80 vota për, përfshirë këtu edhe 14 vota të komuniteteve tjera.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, kërkoj nga deputetët që në votim elektronik të konfirmojnë praninë e tyre në seancë plenare. Armend, e ke kërkuar fjalën, por kërkoj falje, ta kemi konfirmimin e votimit.

Pra, në mënyrë elektronike të konfirmojnë praninë, ju lutem!

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim për prezencën e deputetëve në sallë.

Atëherë, derisa prezenca fizike ishte 116, në mënyrë elektronike i kemi 91. Ju lutem kartelat elektronike i vendosni nëse dëshironi të konfirmoni prezencën tuaj si deputetë.

Regjia votojmë tash për praninë.

I kemi 82 deputetë të pranishëm në sallë, 81 janë për, dhe 1 ka abstenuar.

Atëherë, urdhëro Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, para se të kalojmë në procedurë të votimit, paragrafi 14, me paragrafin 13 duhet të korrigjohet, sepse paragrafi 14 thirret sipas paragrafit 12 dhe duhet të jetë sipas paragrafit 13. Ka të bëjë me përfundimin e mandatit të dhomave të specializuara.

KRYETARI: Po flasim për një gabim teknik të cilin deputeti e ka shprehur. E keni parasysh, amendamentet kushtetuese, paragrafi 14 ndërlihet me paragrafin 13, jo me paragrafin 12, siç është, për arsye që ka shqetësim për një gabim teknik.

ARMEND ZEMAJ: Mos u bëni nervozë, se bëhet mirë.

KRYETARI: Kjo është, nuk ka tjetër. Atëherë, me propozimin e Armend Zemajt, shkojmë e votojmë amendamentin numër 24.

Të nderuar deputetë,
Rezultatin e votimit do ta deklaroj pasi ta konfirmoj votimin në pajtim me nenin 144, paragrafi 2 të Kushtetutës.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim amendamentin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se me 75 vota për, 7 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi amendamentin numër 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Me këtë i mbyll punimet e seancës plenare.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*